



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



**RRETH RELATIVIZMIT GJUHËSOR NË FORMIMET
PARASHTESORE NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE**

**Punim për gradën shkencore “Doktor”
në fushën e gjuhësisë**

Disertante
M.A. Olsa XHINA

Udhëheqës shkencor
Prof. Dr. Valter MEMISHA

Tiranë, 2016

FALENDERIME

Do të doja të shprehja mirënjohjen time për të gjithë ata të cilët më ndihmuan në realizimin dhe finalizimin e këtij punimi.

Falenderimi i pare shkon për udhëheqësin tim shkencor Prof.Dr Valter MEMISHA. Pa gatishmërinë dhe mbështetjen e tij, gjithçka do kishte qenë shumë më e vështirë. Këshillat e vyera, udhëzimet e duhura dhe kritikrat e tij profesionale ishin thelbësore në realizimin e këtij punimi.

Gjithashtu një falenderim shkon dhe për departamentin e gjuhes angleze, te Fakultetit të Gjuheve të Huaja, për besimin dhe këshillat e vyera në mbështetje të realizimit të këtij punimi.

Së fundmi, dua të shpreh mirënjohen e thellë për FAMILJEN time të mrekullueshme për ndihmën e pamasë, nxitjen dhe mbështetjen e plotë që më kanë dhe në gjatë gjithë kohës së realizimit të punimit deri në përfundimin e tij. Ky punim i dedikohet atyre e veçanërisht djalit tim KLINTIT, për të gjithë momentet e munguara, dhe për faktin që janë njerëzit më të shtrenjtë për mua.

PASQYRA E LËNDËS

HYRJE

0.1 Përligjia e punimit.....	i
0.2 Objekti dhe hipoteza e punimit.....	iii
0.3 Metodologjia dhe struktura e punimit.....	iv

KREU I RELATIVIZMI GJUHËSOR NË FORMIMET PARASHTESORE NË GJUHËN ANGLEZE DHE ATË SHQIPE.....

1.1 Bota materiale dhe shpirtërore e anglishtfolësve.....	4
1.2 Bota materiale dheshpirtërore shqipfolëse.....	5
1.3 Rrethanat jashtë gjuhësore të kontakteve të shqipes me anglishten.....	6
1.4 Teza e relativizmit gjuhësor sipas Sepir dhe Uorf.....	7
1.5 Zhvillimet historike të hipotezës së relativitetit gjuhësor.....	8
1.6 Variantet e hipotezës së relativizmit gjuhësor.....	13
1.7 Relativizmi gjuhësor në grupin paradigmatic të formimeve parashtesore në gjuhën angleze dhe shqipe	15

KREU II VËSHTRIM PANORAMIK NË LEKSIKUN E GJUHËS

ANGLEZE.....	18
2.1 Veçori të leksikut të anglishtes së vjetër.....	20
2.1.1 Fjalëformimi.....	20
2.1.2 Parashtesat e anglishtes së vjetër.....	21
2.3 Veçori të leksikut të anglishtes së mesme.....	24
2.3.1 Fjalëformimi në anglishten e mesme.....	25
2.4 Asimilimi i huazimeve në gjuhën angleze.....	26
2.5 Zhvillimi i anglishtes bashkëkohore.....	28
2.5.1 Huazime të anglishtes bashkëkohore	29
2.5.2 Burimet e fjalëve të reja.....	30

KREU III VËSHTRIM PANORAMIK NË LEKSIKUN E GJUHËS SHQIPE ...

3.1 Veçori të leksikut të shqipes.....	32
3.1.1 Shtresa e leksikut të gjuhës shqipe.....	32
3.1.2 Karakteri sistemor i gjuhës shqipe.....	34
3.2 Veçori të strukturës fjalëformuese të shqipes.....	35

3.3 Veçori të strukturës leksikore të shqipes.....	35
3.4 Huazime të shqipes bashkëkohore	37

KREU IV RRUGËT KRYESORE TË PASURIMIT TË LEKSIKUT NË SHQIP

DHE NË ANGLISHT.....	39
4.1 Gjuha dhe ndryshimi gjuhësor.....	39
4.1.2 Fjalëformimi dhe mënyrat fjalëformuese.....	40
4.2 Prejardhja dhe nëndarjet e saj.....	43
4.2.1Prejardhja parashtesore.....	44
4.2.2Prejardhja prapashtesore.....	47
4.2.3.Përngjitja.....	50
4.2.4Konversioni.....	50
4.3Mënyrat e përziera.....	51
4.4Fjalëformimi në gjuhën angleze.....	51
4.4.1Ndajshtesimi.....	53
4.4.2Kompozimi.....	53
4.4.3Huazimet.....	53

KREU V PARASHTESIMI NË GJUHËN ANGLEZE DHE SHQIPE

59	59
5.1Parashtesimi në gjuhën angleze.....	59
5.2Veçori dhe klasifikime të parashtesave angleze.....	65
5.3 Veçoritë morfologjike të parashtesave angleze.....	67
5.4 Zhvillimi i parashtesave angleze.....	71
5.5 Mbizotërimi i parashtesave të huaja.....	72
5.6. Parashtesimi në gjuhën shqipe.....	80
5.7 Parashtesat e shqipes.....	83
5.7.1 Tiparet e parashtesave të gjuhës shqipe.....	84

KREU VI DUKURI DHE PROBLEME TË PËRKTHIMIT TË FJALËVE ME PARASHTESA.....

89	89
6.1 Përkthimi dhe kuptimi i fjalëve.....	89
6.2 Kuptimi konotativ i fjalës.....	91
6.2.1Problemi i mungesës së ekuivalencës.....	91
6.3 Dallimet kulturore ndërmjet gjuhëve	91
6.4 Përkthimi, strategjitë dhe metodat e përkthimit.....	91

6.5 Fjalë të prejardhura me parashtesim nga anglishtja ne romanin “Saga e Forsajteve” përkthyer në shqip nga përkthyesi Vedat Kokona.....	95
KREU VII PASQYRIMI LEKSIKOGRAFIK I FORMIMEVE ME PARASHTESA NË FJALORIN DYGJUHËSH ANGLISHT-SHQIP.....	155
7.1 Fjalët e ndajshtesuara me parashtesim në Fjalorin anglisht-shqip me 120000 fjalë të autorit P.Qesku.....	155
7.2 Përfundime e probleme.....	164
7.3 Fjalorth anglisht-shqip i njësive me parashtesa (anglisht-shqip).....	171
BIBLIOGRAFIA.....	378

SHKURTESAT

Parash.- parashtesë

p.sh.-për shembull

paraf.-parafjalë

pasth.-pasthirmë

pj.-pjesëz

Khrs.-krahaso

em.-emër

f.-folje

fem.-femërore

I.E.-Indo-europiane

shek. shekull

mb.-mbiemër

ad-lib-ad libitum (në mënyrë të rastësishme)

asnj.-asnjanëse

BrE-British English(anglishte britanike)

d.m.th.-domethënë

ndajf.-ndajfolje

num.-numëror

OED-Oxford English Dictionary (Fjalor i gjuhës angleze)

OE-Old English-Anglishte e vjetër

Hyrje

0.1 Përligjia e punimit

Punimi me temë “Rreth relativizmit gjuhësor në formimet parashtesore në gjuhën shqipe dhe angleze”, është një studim gjuhësor me karakter krahasues, i cili vë përballë njëra-tjetrës gjuhën angleze dhe atë shqipe me qëllim gjetjen e ndikimit të relativizmit gjuhësor në proceset fjalëformuese e sidomos në atë ndajshesor parashtesor.

Në shumë aspekte, gjuha angleze konsiderohet si një gjuhë botërore, e përdorur ndërkombëtarisht nga miliona e miliona njerëz sot në botë. Në këtë zhvillim tejte të madh të anglishtes, ngrihet natyrshëm pyetja se cili është ndikimi i saj në gjuhët e tjera të botës dhe ajo çka është dhe objekt i studimit tonë, cili është ndikimi i saj mbi gjuhën shqipe.

Gjuha shqipe, si një gjuhë e hapur, ka mirëpritur në leksikon e saj terma e fjalë të anglishtes nga të gjitha fushat, në teknologji, shkencë, publicistikë, politikë, kinematografi etj., duke e konsideruar këtë prurje si një ndihmesë drejt pasurimit leksikor të shqipes.

Duhet pranuar se ndikimi i anglishtes mbi gjuhën shqipe është shumë i ndryshëm me atë mbi gjuhët e tjera europiane. Kjo vjen për shkak se ndikimi në planin gjuhësor për gjuhë të tjera ka nisur disa shekuj më para, ndërsa për Shqipërinë ky ndikim ka qenë përmes gjuhëve të tjera, me të cilat gjuha shqipe ka patur më shumë kontakte.

Ndikimi intensiv i gjuhës angleze mbi atë shqipe ka ardhur në periudhën paskomuniste, nga vitet 90 duke vazhduar deri në ditët e sotme. Ndryshimet politike e sociale që ndodhën duhet të gjenin përgjigje të menjëhershme emërtuese ndaj zhvillimeve të shumanshme të botës materiale dhe të asaj shpirtërore, intelektuale dhe estetike. Gjuha shqipe pas viteve 90, pësoi zhvillime jo vetëm në pasurimin e vazhdueshëm të saj por edhe në përballjen sidomos me leksikon e gjuhëve me të cilat ajo ka rritur kontaktet në mënyrë të ndjeshme, përballje që shumë shpesh u ka rënë sirenave alarmuese të kërcënimit.

Kështu, ajo çka vihet re gjatë procesit të përvetësimit të gjuhës angleze si gjuhë e huaj apo dhe në përkthime të ndryshme nga anglishtja në shqipe është fakti se të dyja këto gjuhë kanë veçantitë e tyre, çka duket sidomos edhe në vëllimin e pabarabartë të pasurisë leksikore, të pasurisë semantike dhe asaj frazeologjike.

Ky punim, duke u lidhur ngushtësisht me relativizmin gjuhësor, sistemin fjalëformues ndajshesor parashtesor të fjalëve në të dyja gjuhët, mendojmë se do të jetë një ndihmesë shumë e madhe në procesin e mësimdhënies së anglishtes gjatë studimit të lëndëve të tilla si Analiza e tekstit, Semantika e Leksikologjia, të cilat unë i zhvilloj me studentët e mi.

0.2 Objekti dhe hipoteza e punimit

Fakti se gjuha shqipe dhe ajo angleze bëjnë pjesë në familjen e gjuhëve indo-europiane, bën të vërejmë midis tyre afri dhe të përbashkëta gjuhësore në strukturën morfologjike, në sistemin fjalëformues, atë të ndajshesimit e sidomos parashtesimit, që është edhe objekt i studimit tonë. Megjithatë, vëllimi i pabarabartë i pasurisë leksikore, pasurisë semantike, dhe asaj frazeologjike flet për veçanti të dallueshme në stukturat morfo-semantike midis gjuhës angleze si gjuhë analitiko-sintetike dhe shqipes si një gjuhë sintetiko-analitike.

Nëse i referohemi hipotezës së relativizmit gjuhësor në formimet parashtesore në të dyja gjuhët angleze dhe atë shqipe, i cili është edhe objekt i punimit tonë, dallimet leksikore dhe gramatikore mundësojnë shpesh faktin e mos përcjelljes së të tërë tekstit që mund të shkruhet apo thuhet nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, ose mbetja e një pjese të tij pa u përkthyer. Kjo ka të bëjë me variantin e fortë të teorisë së relativizmit gjuhësor, i cili përmban një sërë rrjedhimesh negative jo vetëm teorikisht, por edhe praktikisht. Per me teper, hipoteza e relativizmit gjuhësor bie në kundërshtim edhe me faktet e dygjuhësisë, pasi po t'i referohesh kësaj teorie, zbehet krejtësisht mundësia e përkthimit nga një gjuhë në tjetrën, ashtu si mohohen edhe huazimet kulturore midis popujve me gjuhë të ndryshme, kur dihet që kulturat, ashtu si popujt ndërveprojnë më njëri-tjetrin duke dhënë e marrë midis tyre.

Për më tepër, hipoteza e relativizmit gjuhësor përmban dy parime kryesore: determinizmin gjuhësor dhe relativitetin gjuhësor. Determinizmi gjuhësor thekson se procesi i të menduarit përcaktohet nga gjuha, ndërsa relativiteti gjuhësor thekson faktin që individët të cilët flasin gjuhë të ndryshme e perceptojmë botën e jashtme në mënyra të ndryshme.

Kjo teori na dha shtysë për t'iu drejtuar sistemit të fjalëformimit në të dy gjuhët, veçanërisht tipit të ndajshesimit parashtesor. Në punim u jepet përparësi formimeve me parashtesa të të gjitha klasifikimeve në gjuhën angleze dhe shqipe, duke bërë

përqasje në të dyja gjuhët, për të gjetur përbashkësitë dhe dallimet në këtë fushë. Fokusi i punimit tonë dhe pyetja kryesore që ngrihet në punim është të tregojmë se si parashtesat e shqipes u përgjigjen shumësisë së parashtesave angleze, duke iu referuar të dyja varianteve të hipotezës së relativizmit gjuhësor.

Gjithashtu, përmes pasqyrimin leksikografik të njësive parashtesore nga anglishtja në gjuhën shqipe synojmë të mbështesim punimin tonë nga ana praktike me hartimin e një fjalorthi duke shpresuar në dhënien e një kontributi për të tërë nxënësit e anglishtes, përvetësuesit e gjuhës angleze, pse jo edhe mësuesit e anglishtes në shkolla nëntëvjeçare, apo të mesme.

Në këtë punim është përdorur metoda induktive, d.m.th analiza e përimtuar e lëndës leksikografike të nxjerrë, duke kaluar në konkluzione dhe rrjedhime llogjike, e ndërthurur kjo shpesh me rrugën deduktive, me karakter analitik, në përpjekje për të zbërthyer rregullat e përgjithshme në rregullsi të veçanta.

Për më tepër, është ndjekur metoda përshkruese dhe krahasuese, duke vënë të dy gjuhët përballë njëra-tjetrës përmes ballafaqimit të fjalëve të prejardhura me parashtesim. Kjo përballje është bërë në aspektin e ndryshimit formal, semantik, aspektin etimologjik e atë historik të fjalëve.

Jemi bazuar në një literaturë të pasur sidomos në gjuhën angleze dhe atë shqipe, në punime, artikuj dhe autorë që janë përfaqësues të studimeve gjuhësore morfologjike, semantike, leksikologjike etj. Kështu, për realizimin me sukses të punimit jemi mbështetur mbi konceptet e teorisë dhe të praktikës leksikologjike, morfologjike, semantike dhe leksikografike, të përpunuara nga gjuhëtarë e veçanërisht leksikologë shqiptarë, anglo-amerikanë etj., Xhuvani-Çabej, Kostallari, A., Thomai, J., Hysa E.,, Sharra Th, I., Stefanllari, Plag, I, J. Lyons, Leech G.N.; Palmer, Marchand, H. Bauer L etj.

0.3 Metodologjia dhe struktura e punimit

Punimi “Rreth relativizmit gjuhësor në formimet parashtesore në gjuhën shqipe dhe angleze”, në kuadrin e hipotezës së relativitetit gjuhësor vë përballë njëra-tjerës anglishten dhe shqipen, përsa i përket sistemit ndajshesor parashtesor.

Së pari, kemi nxjerrë lëndë leksikore nga fjalorët e anglishtes dhe të shqipes përmes një vjelje të drejtpërdrejtë. Për të bërë analiza të sakta e të plota sidomos semantike dhe fjalëformues kemi trajtuar lëndën leksikografike që gjendet në fjalorët njëgjuhësh dhe dygjuhësh të të dyja gjuhëve, kryesisht në Fjalorin anglisht-shqip me 120000 fjalë të autorit Pavli Qesku, i cili ka rezultuar mjaft prodhimtar në fjalët e prejardhura me parashtesa. Kjo vjelje ka sjellë edhe një fjalor specifik, fjalorin e fjalëve të prejardhura me parashtesa anglisht-shqip.

Së dyti, është zbatuar metoda e analizës semike për të bërë analiza të thukëta e njëkohësisht shteruese, që nënkupton analiza përmes fushave konceptore e leksiko-semantike. Kështu, në një koncept të gjerë, kemi përdorur edhe metodën e përqsjes gjuhësore të përballjes dhe të krahasimit të njësive leksikore e semantike.

Krahas njësive leksikore të vjela nga fjalorët dygjuhësh, për anglishten e shqipen, për të ilustruar probleme të përkthimit të fjalëve të prejardhura me parashtesim nga anglishtja në shqipe si korpus gjuhësor kemi përzgjedhur romanin “Saga e Forsajteve” e klasikut anglez Xhon Gollsuorth, i përkthyer në gjuhën shqipe nga perkthyesi i mirenjohur Vedat Kokona; fjalët e prejardhura me parashtesim janë parë krahasimisht duke i analizuar në të dy gjuhët.

Punimi monografik “Rreth relativizmit gjuhësor në formimet parashtesore në gjuhën shqipe e angleze” përbëhet nga shtatë kapituj, të paraprirë nga një hyrje si dhe të ndjekur nga një fjalorth anglisht – shqip me të gjitha fjalët e prejardhura me parashtesa.

Në kreun e parë kemi trajtuar çështjen e relativizmit gjuhësor ku trajtojmë probleme që kanë të bëjnë me: a. Bota materiale dhe shpirtërore e anglishtfolësve dhe e shqipfolësve; b. Teza e relativizmit gjuhësor e Sepir dhe Uorfit; c. Rrethanat jashtëgjuhësore të kontakteve të shqipes me anglishten; d. Variantet e hipotezës së relativitetit gjuhësor. Relativizmi gjuhësor në grupin paradigmatic të formimeve parashtesore në gjuhën angleze dhe shqipe; Afri dhe dallime në grupin paradigmatic të formimeve parashtesore në të dy gjuhët.

Në kreun e dytë trajtojmë çështjen “Vështrim panoramik në leksikun e gjuhës angleze”, ku trajtohen probleme që kanë të bëjnë me: a. Veçori të leksikut të anglishtes së vjetër, mesme dhe

anglishtes moderne; b. Zhvillimi i Anglishtes Bashkëkohore; c. Kontakti i anglishtes së vjetër me gjuhë të tjera, huazimet e gjuhës angleze, si dhe burimet e fjalëve të reja.

Në kreun e tretë të punimit trajtojmë probleme si: a. Veçori të leksikut të shqipes b. Veçori të shqipes nga pikëpamja fjaleformuese c. Veçori të strukturës leksikore të shqipes, d. Karakteri sistemor i gjuhës shqipe, e. Huazime të shqipes bashkëkohore.

Në kreun e katërt trajtojmë çështjen "Rrugët kryesore të pasurimit të leksikut në shqip dhe në anglisht", ku trajtojmë probleme si: Gjuha dhe ndryshimi gjuhësor; Fjalëformimi dhe mënyrat kryesore të fjalëformimit në anglishte dhe në shqipe, e tipat dhe mënyrat kryesore të formimit të fjalëve në anglishte dhe në shqipe ku trajtohen në përgjithësi prejardhja, kompozimi e konversioni. Formimi parashtesor në anglisht dhe në shqip trajtohet në kreun e katërt. Gjithashtu, këtu trajtohen edhe nëncështje si veçori dhe klasifikime të parashtesave angleze; veçori dhe klasifikime të parashtesave shqipe; zhvillimi i parashtesave angleze, etj.

Në kreun e pestë kemi trajtuar çështjen "Parashtesimi në gjuhën angleze dhe shqipe", ku trajtojmë çështje si: Veçori dhe klasifikime të parashtesave angleze, Veçoritë morfologjike të gjuhës angleze, Zhvillimi i parashtesave angleze, Mbizotërimi i parashtesave të huaja, Parashtesimi në gjuhën shqipe, Parashtesat e gjuhës shqipe, Veçoritë e parashtesave të shqipes.

Në kreun e gjashtë punimi ndalet në dukuri dhe probleme të përkthimit të fjalëve me parashtesanga anglishtja në shqipe, ku duke u mbështetur në teori botërore mbi përkthimin trajtojmë probleme të përgjithshme me të cilat përballet përkthyesi Vedat Kokona gjatë këtij procesi. Si korpus gjuhësor ilustrues kemi zgjedhur veprën "Saga e Forsajtëve" të John Gollsworth, duke e vënë përballë versionit të përkthyer në shqipe nga përkthyesi Vedat Kokona, nga ku kemi vjelë lëndë të mjaftueshme gjuhësore me fjalë të parashtesuara.

Kreu i shtatë është edhe kreu i përfundimeve, i dukurive e problemeve të rrafshit të fjalëformimit ndajshesor parashtesor. Në këtë kre kemi përmbledhur konkluzionet për çdo kre tjetër si dhe përbashkësitë dhe dallimet që këto dy gjuhë ndajnë me njëra-tjetrën; trajtimin e problemeve të përkthimit që vijnë si rezultat i dallimeve në përgjithësi e në veçanti probleme të përkthimit të fjalëve të prejardhura me parashtesa. Së fundmi, i jepet përgjigje pyetjes së ngritur si dhe sa mirë shqipja i përgjigjet shumësisë së prefikseve angleze, nën trysninë e parimeve të relativitetit gjuhësor, duke e studiuar atë krahasimisht.

Punimi është pajisur edhe me një fjalorth, ku renditen alfabetikisht të gjitha fjalët e prejardhura me parashtesa, për të cilin mendojmë se mund t'ju vijë në ndihmë studentëve të gjuhës angleze. Përvoja ime si mësimdhënëse në universitet, pranë departamentit të gjuhëve të huaja, në lëndët që lidhen drejtpërdrejt me leksikologjinë e semantikën e gjuhës angleze, bazat e gjuhës e formimit gjuhësor, analiza e tekstit e kanë mbështetur shumë punimin tonë.

KREU I RELATIVIZMI GJUHËSOR

1.1 Bota materiale dhe shpirtërore e anglishtfolësve

Një nga tiparet e gjuhës angleze është karakteri i saj i përzier. Shumë gjuhëtarë konsiderojnë praninë e fjalëve të huaja sidomos ato frëngë e latinë si faktorin më të rëndësishëm në historinë e gjuhës angleze. Por, nuk duhet harruar edhe ndikimi i gjuhëve të tjera si ajo italianë, grekë, ruse, skandinavë etj të cilat kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në pasurimin e lëksikut të huazuar të gjuhës angleze. Pra, natyra e përbërë e fjalorit të gjuhës angleze nuk mund të mohohet. Për të kuptuar natyrën e këtij fjalori dhe historinë e zhvillimit të tij, është e nevojshme të studiohet etimologjia e tij, shkaqet historike, vëllimi, roli dhe rëndësia e krahasimit të elementëve të gjuhës angleze dhe atyre të huazuara në reformimin e kësaj gjuhe.

Elementi vendas dhe i huaj janë të pandashëm në gjuhë. Një pjesë e fjalorit të anglishtes së vjetër është ruajtur, por shumë fjalë kanë dalë jashtë përdorimit. Kur flitet rreth rolit të elementit vendas në gjuhën angleze, gjuhëtarët kufizohen në pak fjalë me origjinë anglo-saksone që zënë 25-30% të fjalorit anglez¹. Pothuajse të gjitha fjalët me origjinë anglo-saksone i përkasin një grupi semantik shumë të rëndësishëm. Ato përfshijnë të shumtën e foljeve ndihmëse dhe modale (shall, will, should, would, must, can, may), përemrat (I, me, his, her, who, etj), parafjalët, (on, under, out, etj), numërorët (one, tëo, etj) dhe lidhëzat (and, but, like, till, as, etj). Në historinë e saj të gjatë zhvillimore, anglishtes i është dashur të përballet me një fluks masiv fjalësh nga gjuhë të ndryshme burimore². Kjo ka shkaktuar paqëndrueshmëri në sistemin e fjalëformimit, dhe jo rrallë herë konfuzion tek përdoruesit e studiuesit e saj. Kështu, paqartësitë për parashtesimin mohues e keqësues kanë qenë një karakteristikë e gjuhës në të gjithë historinë e saj. Në shekullin e 18-të, gramaticienët dhe leksikografët propozuan “korrigjimin e përmirësimin” e gjuhës angleze në mënyrë që të parandalonin “çoroditjen” e shkaktuar në gjuhë nga lëvizjet gjuhësore³.

Në historinë e saj të gjatë 15 shekujore, të ruajtur në dorëshkrime, gjuha angleze lidhi kontakte të gjata dhe të ngushta me disa gjuhë të tjera kryesisht latinishten, frëngjishten dhe skandinavishten. Fluksi i madh i huazimeve nga këto burimë muns të shpjegohet me anë të disa shkaqeve historike: ndikimi i madh i qytetërimit romak bëri që latinishtja të përdorej për një kohë të gjatë në Angli si gjuha e studimit dhe besimit.

Ndikimi i Shteteve të Bashkuara, ushtruar nga faktorët ekonomikë e politikë, përforcohet akoma më shumë edhe nga numri i madh i popullsisë, ku SHBA ka 70% të të gjithë folësve amtarë të anglishtes nëpër botë, me përjashtim të kreolëve.⁴

¹ “The origins and development of the English language”, 7th edition, John Algeo, Carmen Acevedo Butcher, f 78.

² Negative prefixation from 1300 to 1800: A case study in *in-/un-* variation* Heok-Seung Këon 1997. ICAME Journal no = 21. f 21.

³ Swift, Jonathan. 1712. A Proposal For Correcting, Improving and Ascertaining The English Tongue. London: Benjamin Tooke, f.65.

⁴ Konkludime nga punimi i I. Pata në lidhje me ndikimin e anglishtes mbi gjuhën shqipe, Ndikimi i anglishtes në shtypin shqiptar ish komunisht”.

Kështu mund të themi se është në kulturën e historisë së anglofonëve fakti që ata kanë adoptuar fjalë të huaja nga gjuhët e kulturave me të cilat ata kanë qenë në kontakt. Huazimi i fjalëve të huaja nga gjuhë të tjera asnjëherë nuk është konsideruar si demode apo e tepruar, dhe nuk kanë ekzistuar asnjëherë rregulla apo udhëzime nga akademi kombëtare britanike, amerikane apo të ndonjë vëndi tjetër anglishtfolës të kufizojnë apo të ndalin prurjet e reja në leksik përmes huazimeve nga gjuhë të tjera, ashtu sikundër ka ndodhur në shumë vende të tjera Europiane.

Duhet theksuar këtu një tipar tjetër i përbashkët i të gjitha gjuhëve: përshkueshmëria. Elementët e huaj hedhin rrënjë thellë sa që sot nuk arrijmë t'i dallojmë. Huazimet në gjuhën angleze nga shumë gjuhë të tjera, por veçanërisht nga gjuha frenge, e sidomos pas pushtimit Norman, dëshmojnë se sa të fuqishëm janë faktorët jashtëgjuhësorë: lufrat, pushtimet, tregtia. Ato janë aq të fuqishme sa në mos e shfarofshin një gjuhë, ta ndryshojë aq shumë, sa ajo të mos njihet më. Në shekullin e XXI-të, në shoqërinë e hapur ku jetojmë, në ethet e globalizmit, në teknologjinë marramendëse, në industrinë e argëtimit, duket se gjuha angleze po u kthen haraçin të gjitha gjuhëve të tjera. Ndikimi i anglishtes po ndryshon sot fjalorin pse jo dhe kulturën e shumë gjuhëve. Ashtu si të gjitha gjuhët e botës, edhe shqipja nuk mund të mos prekej dhe pasurohej prej gjuhës dhe kulturës angleze.

Kjo rritje e statusit të gjuhës angleze është ngushtësisht e lidhur me zhvillimin e madh ekonomik, teknologjik e kulturor të Shteteve të Bashkuara por edhe të Mbretërisë së Madhe, të cilët duke patur një epërsi ekonomike e kulturore si p.sh në kinema, muzikë, television; biznes, teknologjinë e informacionit, kanë bërë të mundur konsolidimin e pozicionit të anglishtes që vazhdon të ruhet edhe sot. Dominimi dhe ndikimi amerikan në mbarë botën e bën anglishtes gjuhën më të rëndësishme për zhvillimin e tregjeve ndërkombëtare, veçanërisht në fushat e turizmit dhe reklamave. Gjithashtu, zotërimi i gjuhës angleze ofron qasje në kërkimet shkencore, teknologjike dhe akademike për të gjithë botën.

Gjuhëtarë botërorë kanë shkruar në lidhje me disa karakteristika të brendshme të anglishtes dhe fakte të cilat e bëjnë atë një zgjedhje të përshtatshme si gjuhë globale:

Së pari, vetë pasuria dhe thellësia e leksikut të gjuhës angleze e bën këtë gjuhë si më prestigjozen dhe më të rëndësishmen. Fjalori rishikuar i Oxfordit i vitit 1989⁵ liston 615.000 fjalë në 20 vëllime, duke u bërë zyrtarisht fjalori më i madh në botë; nëse do të përfshiheshin këtu edhe fjalët teknike e shkencore me siguri fjalori i Oksfordit do të shënonte mbi më shumë se një milion fjalë.

Përafërsisht leksiku i anglishtes rritet çdo vit me mbi 8,500 fjalë në vit; ndërkohë që statistika të tjera e rrisin këtë numër deri në 15,000 apo 20,000 fjalë. Gjithashtu, është për tu theksuar fakti se rreth 200,000 fjalë angleze janë në përdorim të gjerë sot, krahasuar me 184,000 fjalë të gjermanishtes dhe rreth 100,000 të frengjishtes. Për më tepër, zotërimi i një numri tejet të madh sinonimesh lejon krijimin e nuancave të ndryshme kuptimore të cilat në krahasim me gjuhë të tjera është shumë herë më i zgjeruar⁶.

⁵ The 1989 revised "Oxford English Dictionary"; <http://www.oed.com/>

⁶ "The origins and development of the English language", 7th edition, John Algeo, Carmen Acevedo Butcher, f101.

Numri shumë i madh edhe i idiomave dhe shprehjeve frazeologjike gjithashtu ja vlen të përmendet si pasuri tepër e madhe e fondit të fjalëve angleze⁷. Së dyti, gjuha angleze shquhet për fleksibilitetin e saj që vihet re jo vetëm në sintaksë, morfologji etj. Kështu, përmes konversionit, e cila është një nga mënyrat më prodhimtare fjalëformuese në gjuhën angleze, e njejta fjalë mund të përdoret edhe si emër, edhe si folje si p.sh. *drink, fight, silence*, etj. Së treti, gramatika e gjuhës angleze shquhet për thjeshtësinë e saj, gjë që e bën më praktike e lehtësisht të kapshme në të mësuar krahasimisht me gjuhë të tjera. Gjuha angleze shquhet për praktikitetin e saj edhe në lidhje me mungesën e kategorisë së gjinisë në shumë fjalë. Kështu, përvec disa emra frymorësh ku përkatësia gjinore dallon natyralisht, emra objektesh apo nocionesh nuk kanë përkatësi gjinore në gjuhën angleze si p.sh.: *desk-bankë, table-tavolina, market-tregu, computer-kompjuteri*.

Ndërkohë që gjuha shqipe i kategorizon këto objekte në gjini të përcaktuara mirë sipas një rregullsie të gjuhës shqipe, gjuha angleze në të kundërt nuk i dallon ato në gjini femërore apo mashkullore; nyjet e emrave në shumë raste mungojnë si p.sh.: 'It is time to go to bed'- është koha për të shkuar në shtrat, është koha për të fjetur. Këtu nuk ka asnjë nyje që i pranëvitet emrave *time* apo *bed*. Në gjuhën shqipe apo dhe të tjera kjo gjë nuk ndodh shpesh; Mënyrat e të adresuarit miqësore apo zyrtare, (ti dhe ju, tu e lei në italisht psh) që në gjuhë të tjera janë të ruajtura mirë, gjuha angleze i ka abandonuar që shekuj më parë; format rasore të emrave në anglisht gjithashtu nuk ekzistojnë, me përjashtim të disa përemrave si p.sh.: *I (me/min) une, mua, i imi)e, he/him/his(ai, atij, i tij)*.

Gjuha angleze është gjithashtu një gjuhë relativisht e thjeshtë në aspektin e drejtshkrimit dhe shqiptimit, edhe pse ky pretendim është ndoshta më i diskutueshëm. Është për tu theksuar fakti që rreth 84 % e drejtshkrimit anglez i përshtaten rregullsisë dhe modeleve të përgjithëshme, ndërsa vetëm 3 % do të përbëjë rastet e paparashikuara jashtë rregullit të përgjithshëm, përfshihen fjalë të tilla të rralla si *colonel(kënël)-kolonel, ache-(eik)dhibje, eight (eit) tetë*, etj.

Karakterit kosmopolitan, i hapur i anglishtes si rezultat i depërtimeve të huazimeve të mijëra fjalëve nga gjuhë të tjera me të cilat anglishtja ka patur kontakte si p.sh. huazimet frënge, skandinave, italiane greke e latine, i jep anglishtes një ndjenjë familiariteti e mikëpritjeje, krahasuar me gjuhë të tjera të botës si p.sh. frengjishtja e cila mbrohet me shumë fanatizëm ndaj prurjeve të huaja.

Shtrirja dhe cilësia e letërsisë angleze gjatë gjithë historisë botërore e ka lartësuar atë si gjuha e kulturës e cila mbart me vete legjimitetin dhe krenarinë që shumë pak gjuhë të botës mund të përjasen.

Kështu, duhet pranuar që në shumë aspekte, gjuha angleze duhet konsideruar si një gjuhë botërore, e përdorur ndërkombëtarisht nga miliona e miliona njerëz sot në botë. Në këtë zhvillim tejet të madh të anglishtes, ngrihet natyrshëm pyetja se cili është ndikimi i saj në gjuhët e tjera të botës dhe ajo çka është dhe objekt i studimit tonë, cili është ndikimi i saj mbi gjuhën shqipe. Vënde të ndryshme kanë politika të ndryshme gjuhësore në këtë drejtim dhe në varësi të shkallës së fanatizmit me të cilën këto vënde e ruajnë gjuhën e tyre, ky ndikim varion. Gjuha shqipe, si një gjuhë e hapur, ka pranuar në leksikon e saj terma e fjalë të anglishtes nga të gjitha fushat, në

⁷ http://www.thehistoryofenglish.com/issues_global.html

teknologji, shkencë, publicistikë, kinema etj, duke e konsideruar këtë prurje si një ndihmesë drejt pasurimit leksikor të shqipës.

Vetë gjuha angleze është një gjuhë e përzierë, e cila përgjatë shekujsh ka huazuar nga gjuhë të tjera duke ndryshuar në këtë mënyrë karakterin e saj. Kështu, anglishtja e sotme nuk mund të krahasohet me anglishten e periudhës anglo-saksone pasi nën ndikimin e pothuaj 350⁸ gjuhëve përgjatë shekujsh ajo patjetër që ka pësuar ndryshime të mëdha. Duhet theksuar fakti që 4/5 e leksikut të anglishtes nuk është autokton, por me përzierje latine, greke, etj. Kështu, për të njejtën fjalë, në fjalorin e anglishtes mund të gjenden dy ose tre fjalë të tjera të huazuara nga gjuhë të ndryshme si p.sh. për fjala *kingly*-mbretëror, gjenden edhe *royal* apo *regal* si fjalë të huazuara ndër kohë, njëra me origjinë gjermanike, franceze, latine. Tre fjalë të ndryshme për të njejtin koncept vetëm e pasurojmë gjuhën duke i dhënë asaj nuanca të tjera stilistike⁹. Huazimet në gjuhë vetëm se i shtojnë vlera semantike gjuhës ku ato depërtojnë duke pasuruar në këtë mënyrë leksikun e saj.

Ndikimi i anglishtes, për shkak të influencës së fuqishme të SHBA-së, po ndryshon sot fjalorin dhe pse jo kulturën e shumë gjuhëve, ku përfshihet edhe shqipja. Me sa duket, pushtimi më i fuqishëm nuk vjen nga lufta e hapur, por nga “infiltrimi” i heshtur e këmbëngulës në shumë fusha të jetës, për më tepër kur ky pushtim i pëlqen popullatës, e cila mirëpret çdo fjalë e çdo gjest që vjen nga një gjuhë “superiore”.

1.2. Bota materiale dhe shpirtërore shqipfolëse

Në proceset e globalizimit gjuha angleze si një gjuhë me prestigj dhe aftësi shumë të mëdha shprehëse, ushtron ndikim mbi gjuhë të tjera më pak të zhvilluara, ku përfshihet dhe gjuha shqipe. Ky globalizëm, qoftë formal ose joformal, tashmë ka përfshirë në përmasë të gjerë gjuhën shqipe. Ky fenomen po ndodh edhe sot kur në shqipen si asnjëherë tjetër në jetën e saj hyjnë ide, koncepte, dukuri e terma nga kultura e gjuha angleze. Sidomos këto dy dekadat e fundit ka ndodhur një hapje e madhe e ekonomisë, kulturës, jetës shoqërore ndaj fenomeneve globale. Duke qenë se jetojmë në kohën e globalizimit, dhe një gjë e tillë pasqyrohet edhe në gjuhë, e sidomos në leksik. Pasurimi i leksikut përbën aktualisht një ndër problemet më madhore. Sigurisht që shqipja standarde duhet të modernizohet sepse edhe vete jeta e vendit po pëson ndryshime në kete drejtim. E si pasojë, edhe vete gjuha duhet të pasqyrojë këto ndryshime¹⁰.

Modernizimi i gjuhës shqipe duhet parë, përveç të tjerave, edhe përmes pranimit të fjalëve të huaja, për të cilat ka nevojë shqipja standarde dhe për të cilat duhet të ketë një planifikim a një politikë gjuhësore. Përdorimi pa kriter e masë i fjalëve të huaja shkon në kundërshtim me standardizimin e mëtejshëm të gjuhës. Gjuha shqipe duhet të gjejë mënyrat se si të pasurohet e modernizohet duke ruajtur njëkohësisht edhe identitetin e saj. Ajo duhet të përpiqet të gjejë apo krijojë fjalë të përshtatshme nga burimet e veta dhe me mjetet e saj leksikore.

⁸ David Christal “The past, the present and the future of world English”, f.42.

⁹ David Christal “The past, the present and the future of world English”, f.42

¹⁰ D. Tamo “Anglicizmat në gjuhën e dokumenteve zyrtare” Revista shkencore Alb-shkenca; vol.3, nr.4.

D. Tamo është e mendimit se përderisa popujt dhe gjuhët që ata flasin janë në marrëdhënie me njëri-tjetrin, huazimet duhen parë si një dukuri e natyrshme. Huazimi i fjalëve nga gjuha angleze duhet të konsiderohet si mjet për pasurimin e gjuhës, sepse në këtë mënyrë zgjerohen mundësitë e saj shprehëse. Është e qartë dhe e vërtetë se kërkesat e gjuhës nuk mund të plotësohen vetëm nga burimet e brendshme. Nevoja për shprehje me anë të leksikut të dukurive, ideve, koncepteve, marrëdhënieve etj. të reja të shoqërisë shqiptare nuk mund të plotësohen vetëm nga burimet e shqipes standarde dhe nga dialektet e saj. Këto nevoja bëjnë të domosdoshme edhe huazimin në vazhdimësi të fjalëve nga gjuhë të tjera. Fjalët e huaja duhet të përjetohen si përbërës të natyrshëm të gjuhës, sidomos fjalët që kanë veçori terminologjike. Nuk është e mundur të përkthejmë çdo fjalë a shprehje të huaj dhe as nuk mund të zëvendësohet cdo fjalë e huaj me përgjegjësen në gjuhën shqipe.

Në lidhje me këtë çështje, gjuhëtari Xh. Lloshi shkruan se “historiku i përballjes së shqipes me anglishten është shumë i shkurtër në krahasim me gjuhët e vendeve të tjera, saqë ne na duhet kohë e punë akoma për të formuar orientimin tonë kulturor, në kontekstin e zhvillimeve më të fundit.”¹¹ Lloshi vëzhgon huazimet në shqip nga anglishtja në kontekstin e globalizmit duke i identifikuar si pasojë të drejtpërdrejtë të tij, bilingualizmin. Disa nga shkaqe që ai përmend në lidhje me këtë janë si: numri i madh i të emigruarve nga Shqipëria në vende të tjera; fakti që elementi ndërkombëtar në komunikimin public është gjithmonë në rritje; aspirate dhe përpjekjet e Shqipërisë për t’u integruar në bashkësinë europiane; një pjesë e mirë e ligjeve që miratohen në Parlamentin shqiptar, fillimisht përkthehen nga anglishtja apo hartohen në anglisht, shpesh me një cilësi të dobët përkthimi dhe me një numër të madh fjalësh anglisht etj. Gjithashtu, ky gjuhëtar thekson si edhe ilustron përmes shembujsh ndikimin e anglishtes në ortografinë dhe fjalorin e shqipes, por pa lënë mënjanë dhe ndikimin e saj nga pikëpamja morfologjike dhe sintaksore. Lloshi sugjeron rishikimin e të gjithë fjalorëve terminologjikë nga anglishtja në shqip dhe nga shqipja në anglishte, për shkak të mungesës së përkthimeve të sakta e sistematike. Sipas tij, prania e shumë fjalëve angleze në shqipe ka rezultuar në rritjen e numrit të atyre çifteve fjalësh, ekuivalente nga kuptimi, por që janë të përdorshme si huazimi, ashtu edhe fjala shqipe.

Ndërsa H. Shehu, në shkrimin e tij “Rreth anglicismave në mjetet e sotme të informimit masiv”¹², i konsideron anglicizmat “si fjalë a shprehje angleze të cilat ndihen tërësisht si të huaja në mjedisin e shqipes e përdoren subjektivisht, pa vend e pa nevojë.” Sipas tij, mungesa e motivimit të brendshëm për të gjetur fjalë a formime shqipe për të arritur shprehësinë dhe për të evituar përdorimin e fjalës së huaj, është një shqetësim tjetër që Shehu ngre në artikullin e cituar.

1.3. Rrethanat jashtëgjuhësore të kontakteve të shqipes me anglishten

Ndikimi që ka patur gjuha angleze mbi gjuhën shqipe është tejet i ndryshëm me atë mbi gjuhët e tjera europiane, për shkak se ndikimi në planin gjuhësor për gjuhë të tjera ka nisur disa shekuj për para. Ndërkohe për Shqipërinë ky ndikim ka qenë përmes gjuhëve të tjera, me të cilat gjuha shqipe ka patur më shumë kontakte. Nese flasim për një ndikim domethenes të gjuhës angleze

¹¹ Xh. Lloshi “Shqipja përballë rrjedhave të globalizmit”, Studia albanica, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2005, f.32.

¹² H. Shehu, “Rreth anglicismave në mjetet e sotme të informimit masiv”, Studime filologjike, 3-4, 2002, f.91.

mbi ate shqipe atehere duhet ti referohemi periudhës paskomuniste, nga vitet 90 duke vazhduar deri në ditët e sotme.

Sipas Gorlach, gjuha frënge, ajo gjermane dhe ajo italiane huazimet e tyre të para nga anglishtja i patën përmes leksikut politik anglez. Më pas ishin letërsia angleze, praktikat shoqërore, shkrimet filozofike, historike angleze, ndikimi kulturor në arkitekturë, kopshtari, zejtari, shkence dhe teknologji, të cilat shtuan ndikimin e kulturës dhe gjuhës angleze mbi gjuhët europiane¹³.

Nga fundi i shekullit të XIX një valë e re huazimesh prej anglishtes përfshiu një pjesë të mirë të vendeve europiane, kryesisht në fushën e jetës shoqërore. Mund të sjellim shembullin e emrave të sporteve të importuara nga Anglia si hipizmi, tenisi; emërtime të racave të qenëve, gjedhëve, veshjeve, pijeve, etj, ku shqipja nuk arriti të ndikohej në të njëjtën mënyrë.

Përsa i përket ndikimit më të hershëm të anglishtes mbi gjuhën shqipe, gjuhëtari Xh. Lloshi ¹⁴ pohon se Kristoforidhi ka qënë i pari i cili ka bërë një përkthim prej anglishtes. Në vepren e tij në gegërisht “Abetaria” ai paraqet për nxënësit e abetares edhe disa fjalë angleze si dog, spider, cat, butterfly, eagle, goat etj.

1.4. Teza e relativizmit gjuhësor sipas Sepir dhe Uorf

Teoria e njohur “Sapir-Whorf”, e dy linguistëve amerikan, Eduard Sapir dhe nxënësit të tij Benjamin Lee Uorf, që bashkon dy parimet e saj determinizmin dhe relativizmin gjuhësor, thekson se njerëzit që flasin gjuhët me ndryshime të mëdha fonologjike, gramatikore dhe semantike, perceptojnë dhe vështojnë botën krejtësisht ndryshe nga njëri tjetri pikërisht prej gjuhës që flasin. Rrjedhimisht, gjuha nuk është vetëm mjet përshkrues apo shprehës i ideve dhe emocioneve, por ajo gjithashtu ndihmon në krijimin e botës dhe vizioneve tona. Edhe pse kjo teori është sulmuar nga shumë kritikë të gjuhësisë dhe semiotikës, ideja qëndrore mbetet e shëndoshë.

Lidhja e ngushtë ndërmjet gjuhës dhe mendimit u ka interesuar shumë antropologëve, psikologëve, studiuesve të shkencave sociale e humane këtë shekullin e fundit, por teoria sipas së cilës gjuha ndikon proceset e të menduarit vetëm kohët e fundit ka qënë hulumtuar në mënyrë të ripërtërirë.

Në studimet e fundit neo-uorfiane, debati në lidhje me konceptet e "gjuhës" dhe "mendimin", ka përfshirë një element të tretë: kulturën. Kjo tezë ka të bëjë me të dy idetë origjinale të Sapir dhe Uorf, si dhe të Boas, ashtu si edhe shpjegimet neo-Uorfiane.

Hipoteza e relativitetit gjuhësor ka gjeneruar një sasi të madhe interesi dhe polemikash që prej krijimit të saj¹⁵. Duke propozuar që gjuha që ne flasim ndikon në mënyrën se si ne e perceptojnë realitetin, nëse teoria provohet të jetë e vërtetë, atëherë implikimet në mbarë botën do të ndikojnë në aspekte të shumta nga të kuptuarit e jetës kulturore në formulimin e politikave qeveritare. Interesi në hipotezën e relativitetit gjuhësor nuk ka rezultuar në një numër të madh të studimeve

¹³ M. Gorlac, “English in Europe”, Oxford University Press, f.14

¹⁴ Xh. Lloshi “Raste ndërhyrjesh të huazimeve nga anglishtja”, Studime filologjike, nr.1-2, 2011, f.70.

¹⁵ Lucy, J.A. (1997) Linguistic relativity. Annual Review of Anthropology 26, f. 291–312.: Annual Reviews Inc.

empirike kërkimore, por entuziazmi studimor në lidhje me të rinovohet nga fundi i viteve 1990-të. Sipas *Advanced Learner's Dictionary* (2010), gjuha përkufizohet si "sistemi i tingujve dhe fjalëve të përdorura nga njerëzit për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tyre".

Hipoteza e relativitetit gjuhësor ka në fokus të saj pyetjen se si gjuha ndikon mbi mendimin, për të cilën Lusi pohon se ka tre nivele: niveli semiotik (të folurit është një kod me një përmbajtje simbolike që ndikon të menduarit), niveli strukturor, (të folurit e një ose më shumë gjuhësh natyrore mund të ndikojë të menduarit), dhe niveli funksional (nëse përdorimi i gjuhës në një mënyrë të caktuar, si p.sh.. të mësuarit në shkollë ndikon mbi mendimin).¹⁶ Niveli i tretë është tejet i lidhur me të folurit dhe ka ngjallur interes këto gjashtëdhjetë vitet e fundit.

1.5. Zhvillimet historike të hipotezës së relativitetit gjuhësor

Hipoteza e relativitetit gjuhësor, sic njihet ndryshe edhe si "parimi i moderuar" i hipotezës Sapir-Uorf, ka tre elemente kyçe: tiparet gjuhësore, modelet e të menduarit, dhe mënyrën se si përjetimet personale ndikojnë perceptimin e realitetit. Këto tre elemente kryesore janë të lidhura ndërmjet tyre në dy mënyra: gjuha ndikon mbi mendimin për realitetin, dhe gjuha përbën një interpretim të realitetit. Teoria fillimisht përbëhej nga dy pjesë që përshkruanin se si gjuha ndikon mendimin. Versioni më i fortë, i quajtur "determinizmi gjuhësor", u vendos nga gjuhëtari Eduard Sapir. Sipas këtij versioni mendimi është përcaktuar nga kategoritë e vëna në dispozicion të individëve nga gjuha e tyre.

Kësisoj, determinizmi gjuhësor është një version ekstrem i relativizmit gjuhësor. Ne thelb te tij qendron ideja se si gjuha përcakton mënyrën si ne e perceptojmë botën. Për fat të keq, ky version i hipotezës së Sapir-Uorfit nuk është i provuar dhe pengon njohjen e dukurive të tilla si bilingualizmi dhe përkthimi. Pinker (2007) pohon se ndikimi i kësaj teorie është tepër i rëndësishëm sikundër kategoritë themelore të realitetit imponohen nga kultura e një vendi¹⁷.

Dy gjuhëtarë amerikan Eduard Sapir dhe student i tij Benjamin Lee Whorf kryen studime mbi determinizmin gjuhësor aty rreth vitet 30-të. Kërkimi i tyre çoi në ngritjen e një pyetjeje të qenësishme: A formëson gjuha mënyrën se si ne mendojmë? Teoria e tyre, e njohur gjerësisht si hipoteza e Sapir Uorfit përfshin parimin e teorisë së relativitetit gjuhësor që ka në themel të saj dy versione: a. Versionin e fortë i hipotezës– ka të bëjë me faktin si gjuha përcakton mënyrën si ne mendojmë pasi gjuhë të ndryshme e emërtojnë botën në mënyra të ndryshme. Sipas këtij version ne e perceptojmë botën vetëm përmes gjuhës që përdorim. b. Versioni i dobët i hipotezës– Gjuha nuk përcakton në mënyrë absolute mënyrën se si ne mendojmë, por strukturat e ndryshme gjuhësore ndikojnë duke na drejtuar të perceptojmë dhe interpretojmë botën në mënyra të ndryshme, në mënyrën se si i qasemi problemeve dhe mbajmë mend faktet.

Versioni i fortë i relativizmit, determinizmit gjuhësor, deri më tani nuk është provuar, si dhe nuk njeh dukuritë e bilingualizmit, multilingualizmit dhe përkthimin. Rrjedhimisht, pjesa dërrmuese e gjuhëtarëve kundërshtojnë fort versionin e fortë të hipotezës së relativizmit, që gjithashtu hedh

¹⁶ Lucy, J.A. (1997) Linguistic relativity. *Annual Review of Anthropology* 26, f. 291–312.: Annual Reviews Inc.

¹⁷ Pinker, S. (2007). *The Language Instinct: How the Mind Creates Language*. New York: HarperCollins.

pretendimin sipas të cilit në mendojmë vetëm në kuadrin e strukturave gramatikore të gjuhës sonë kombëtare¹⁸.

Franc Boas aplikoi metodën shkencore në studimin e kulturave dhe shoqërive njerëzore. Gjatë studimit që ai bëri në lidhje me fiset inuite, Boas u përball me vështirësitë teorike në klasifikimin e gjuhëve dhe ndërtoi teorinë e relativizmit kulturor. Programi kërkimor i relativizmit kulturor ka të bëjë me studimin e marrëdhënieve gjuhë-kulturë, ndikimi i gjuhës mbi kulturën. Ajo që kishte më shumë rëndësi për Boan nuk ishin ndryshimet në shqiptimin e fjalëve të njëjta midis fjalëve, por interpretimi i shqiptimeve nga kërkuesit anglisht folës. Çështja përfshinte dy faktorë: Fonetika e gjuhës angleze nuk mund të strehojë tingujt e perceptuar që burojnë nga banorët e fisit, dhe se variacionet lokale nuk nënkuptonin dialekte të ndryshme. Kështu, relativizimi kulturor ndikon në mënyrën se si individët perceptojnë një gjuhë tjetër.

Një shembull i përdorimit të relativitetit kulturor në kërkimet e tij, ishte në 1911 kur Boas deklaroi që eskimezët përdorin katër emërtime të ndryshme në lidhje me konceptin e borës në varësi të cilësisë së saj, ndryshe nga gjuha angleze për të cilën ai shprehej se ka vetëm një fjalë pa marrë parasysh formën e dëborës. Ky numër u rrit më vonë në shtatë nga Benjamin Whorf (1940). Në fakt, gjuha eskimeze ka vetëm dy rrënjë për lloje të ndryshme të borës: qanik për "borës në ajër" (për shembull flok dëbore) dhe aput për "dëborë në tokë". Megjithatë, ky propozim gjuhësor ka qenë kundërshtuar nga studiues të ndryshëm sipas të cilëve në fjalorin e anglishtes gjenden disa fjalë të cilat emërtojnë lloje të veçanta të dëborës, si p.sh.: llucë e shkrirë, stuhi dëbore, vjeshtë, stuhi, dhe vibrim¹⁹.

Koncepti i Boas në lidhje me relativizmin gjuhësor është koncepti i relativizmit i aplikuar në shoqëritë dhe kulturat të cilat përdorin gjuhën si mjet komunikimi²⁰. Pas transkriptimit dhe përkthimit të teksteve indiano-amerikane, Boas konstatoi se kulturat duhen kuptuar të ndara më vete, e jo si pjesë e një gjuhe dominuese europiane si p.sh. anglishtja. Kjo teori rrjedh prej një ndërgjegje kulturore mënyrash të ndryshme të klasifikimit të përvojës së botës dhe njerezve.

Gjuhëtari dhe antropologu amerikan Eduard Sapir riformuloi teorinë duke ardhur në përfundimin se gjuhët i klasifikojnë përvojat në mënyra të ndryshme dhe se fiset jo-industriale nuk duheshin përcaktuar si kafshë të egra, por ato kishin një system të komplikuar të përbërë nga tre elemente: gjuha, njohuria dhe kultura. Sapir i konsideronte secilin nga të tre elementet ishin si kompleks dhe të vlefshëm si koncepte të pavarura²¹. Sapir argumentonte se "Qeniet njerëzore nuk jetojnë në botën objektive të izoluar, sikundër nuk jetojnë në mënyrë të izoluar as në jetën sociale siç rëndom perceptohet, por janë më së shumti në mëshirën e gjuhës e cila është bërë mjeti shprehës në shoqërinë e tyre. Është pothuajse një iluzion të besosh se ndonjëri i përshtatet realitetit ku jeton pa përdorimin e gjuhës së shoqërisë të cilës ai përket dhe se gjuha është thjeshtë një mjet i rastësishëm i zgjidhjes së problemve specifike të komunikimit dhe reflektimit. Duhet theksuar fakti që dy gjuhë nuk janë asnjëherë mjaftueshmërisht të ngjashme sa të mund të konsiderohen si përfaqësuese e të njëjtit realitet social. Shoqëri të ndryshme jetojnë në botë të ndryshme, të mire

¹⁸ January, D., & Kako, E. (2007). Re-evaluating evidence for the linguistic relativity hypothesis: Response to Boroditsky (2001). *Cognition*, 104(2), f. 417–426.

¹⁹ Pullum, Geoffrey K, *The Great Eskimo Vocabulary Hoax*, Chicago, University of Chicago Press, 1991, 159-171.

²⁰ Yamamoto, M, *Agency and Impersonality: "Their Linguistic and Cultural Manifestations"*, Amsterdam: John Benjamin's Publishing Company, 2006, f 6.


²¹ Sapir, E. "Language", New York: Harcourt, Brace, & World, 1921, f.34.

dalluara nga njëra-tjetra²². Fokusi i Sapirit nuk ishte në strukturat gramatikore, semantike apo pragmatike, por në organizimin formal të kuptimit dhe mënyrën si ai ndërtohej. Sipas tij mendimi përcaktohej nga përfaqësitë mendore.

Studimi i Sapir-it për gjuhën dhe mendimin u përpunuar nga Uorf i cili shprehej se “Gjuha nuk është thjesht një instrument i riprodhimit të shprehjeve të ideve por më tepër është një formuese e ideve. Ne analizojmë natyrën në përputhje të plotë me çka na lejojnë gjuhët tona amtare”²³.

Ndryshe nga Boa dhe Sapiri, Uorf ishte i interesuar në një faktor të tretë përveç gjuhës dhe mendimit, që ishte kultura. Uorf ishte i interesuar në lidhjen e mundshme midis gjuhës dhe modele kulturore. Ai u përpoq të bënte lidhjen se si gjuha ndikon kulturën përmes efektit të proceseve mendore të folësve në mënyrë jo të drejtpërdrejtë.

Lucy është përpjekur të japë përmes një skeme argumentin e Uorfit sipas të cilit modelet specifike gjuhësore ndikojnë mendimet e një folësi të një shoqërie të caktuar, modelet të cilat përcaktojnë norma të sjelljes dhe të kulturës²⁴.



- Strukturat e argumentit të Uorfit i cili lidhte gjuhën, individin dhe kulturën

Gjithashtu, Uorfi pohonte se gjuhët i referohen një shumëllojshmëri përvojash që formalisht mund të kategorizohen për të formuar grupet leksikore dhe gramatikore. Më pas këto kategori

²² Sapir, E. "Culture, Language and Personality", Berkeley, 1958, CA: University of California Press, f 69.

²³ Whorf, B. L. 1940. "Language, thought, and reality", artikuj të perzgjedhur nga Benjamin Lee Whorf, botuar nga J. B. Carroll, 207-19. Cambridge, MA: The Technology Press of MIT/New York: Wiley. 1956., f213.

²⁴ Lucy, J.A. (1992b). Language Diversity and Thought: A Reformulation of the Linguistic Relativity Hypothesis. Cambridge, MA: Cambridge University Press, f 64.

mund të grupohen në sisteme koherente referimi të cilat janë specifike për çdo gjuhë. Kategoritë gjuhësore luajnë rolin e udhërrëfyesit në proceset e të menduarit.

Kundërshtime të forta hipoteza e relativizmit gjuhësor pati nga gjuhëtarë të mëvonshëm siç ishin psikologët Erik Lenneberg and Roger Brown. Ata sollën argumentat e tyre kundër metodologjisë së Sapirit dhe Uorfit për sa i përket pohimeve psikologjike të bazuara në gramatikë dhe përdorimin e teknikave të drejtpërdrejta të përkthimit.²⁵

Në mbështetje të ideve të tyre Braun dhe Lenneberg kryen studime të cilat në fokus të tyre kishin qasjen drejt sjelljes së individit dhe argumentat e ngritura nga Uorf. Përjasja e tyre nis me përballjen e një ndryshimi në modelet gjuhë sore të sjelljeve të cilat besoheshin më parë se buronin nga modelet e të menduarit të individit²⁶.

Kultura luan një rol vital që nga lindja e individit në formë simin e orientimit tonë në lidhje me botën dhe objektet që ne hasim në atë çka na rrethon. Kështu, Deutscher pohon se për shkak të rasteve të vendim marrjes bazuar në intuitë, impulse, apo emocione, folësit e të tëra gjuhë ve nuk janë të burgosur nga logjika deduktive e gjuhës së përcaktuar²⁷.

Në vend të kësaj, ai propozon që konceptet e ndryshme, ideologjitë dhe vlerat duhet të vlerësohen eksperimentalisht me qëllim që të reduktojë keqkuptimet kulturore dhe politike, dhe hapi i parë është të ndalim së pretenduari se ne të gjithë mendojnë njësoj edhe pse gjuhët tona amtare janë tejet të ndryshme.

Sipas gjuhëtarëve Gentner and Goldin-Meadow, konceptet bazë që përbëjnë një gjuhë po bllokojnë konceptet dhe idetë e reja, dhe është pikërisht shpejtësia me të cilën gjuhët paraqesin dhe ndërtojnë konceptet e cila mund të ndikojnë ndryshimet në aftësitë e të menduarit kreativ në fusha të veçanta krahasimisht me gjuhët e tjera.²⁸

Gjuhëtarët pohojnë se efektet e gjuhës mbi memorien dhe njohjen mund të ndodhin vazhdimisht duke qenë se një pjesë e mirë e ndërgjegjës sonë përfshin aktivitetin mendor si për infomacionin verbal të jashtëm ashtu edhe të brendshëm. Gentner and Goldin-Meadow përputhen në idenë se edhe pse studimi mbi hipotezën e relativizmit gjuhë sor përfshin klasifikimin e ngjyrave, hapësirës, kohës, gjinisë, objekteve të kulturës, shumë fusha (nëse jo të gjitha) mbeten të paeksploruara²⁹.

Nëse ndikimet kryesore të gjuhës janë të lidhura kulturalisht, ky fakt do të përputhej me teorinë e kulturalizmit gjuhësor të Levinsonit³⁰.

²⁵ Roger Brown, Eric H. Lenneberg, "A study in language and cognition", Indianapolis, Bobbs-Merrill, 1954.

²⁶ Paul Kay und Willett Kempton (1984): What is the Sapir-Whorf hypothesis? American Anthropologist 86, f 65-79.

²⁷ Deutscher, G. (2010). Does Language Shape how you Think? The New York Times, August, 26, 2010.

(<http://www.nytimes.com/2010/08/29/magazine/29language.t.html>)

²⁸ Gentner, D., & Goldin-Meadow, S. (ed.). (2003). Language in Mind: Advances in the Study of Language and Thought. Cambridge, MA: MIT Press, f.67.

²⁹ Gentner, D., & Goldin-Meadow, S. (ed.). (2003). Language in Mind: Advances in the Study of Language and Thought. Cambridge, MA: MIT Press. F 67.

³⁰ Levinson, S.C Space in Language and Cognition – Explorations in Cognitive Diversity. West Nyack: Cambridge University Press, 2003, f 56.

Phipps thekson se, edhe pse ka mbështetës të relativizmit gjuhësor në lidhje me faktin se gjuha ndikon fort mbi mendimin, ekzistojnë dëshmi të përshtatshme nga literature e disponueshme që tregojnë se gjuha ndikon mendimin dhe perceptimin për jetën, por nuk e kontrollojnë mendimin apo mënyrën se si ne e perceptojnë realitetin³¹.

Çajka e konsideron mundësinë që marrëdhënia midis gjuhës dhe mendimit jo vetëm formëson perceptimet tona në lidhje me realitetin, por që e kundërta mund të ndodhë edhe në faktin që realiteti mund ta formësojë gjuhën e përdorur nga individët në idiolektet dhe sociolektet e tyre. "Gjuha dhe shoqëria janë aq shumë të ndërlidhura sa që është e pamundur të kuptosh njërin pa tjetrën. Nuk ka asnjë shoqëri njerëzore që nuk varet, nuk është formuar dhe nuk e formëson vetë gjuhën³²."

Keshtu, çka duhet patur parasysh në lidhje me teorinë e relativizmit gjuhësor në mënyrë që të mund ta mirë përdorim analizimin e teksteve, sidomos në përkthime, është fakti që relativizmi gjuhësor karakterizohet nga dy parime kryesore: determinizmi gjuhësor dhe relativiteti gjuhësor. Sipas determinizmit gjuhësor procesin e të menduarit e përcakton vete gjuha, ndërsa sipas relativitetit gjuhësor individët të cilët flasin gjuhë të ndryshme e perceptojmë botën e jashtme në mënyra të ndryshme.

Dhjetëvjeçarët e fundit nuk janë kryer shumë studime kërkimore për të arritur në perfundime në lidhje me rëndësinë e hipotezës së relativizmit gjuhësor sidomos në procesin e të mësuarit dhe të përkthimit. Megjithatë, llogjikshëm mund të hipotizohet se në qoftë se determinizmi gjuhësor do të ishte i vërtetë, këto procese do të ishin tepër problematike, ose praktikisht të pamundura, pasi studentëve do tu duhej të ndryshonin plotësisht proceset e tyre të menduarit. Nëse përmbajtja dhe konteksti janë të lidhur dhe të kufizuar në një formë të gjuhësisë, kjo do të ndihmonte në krijimin e kuptimit verbal duke përdorur gjuhën.

1.6. Variantet e hipotezës së relativitetit gjuhësor

Gjuhëtari Rami Memushaj është i mendimit se gjuhët duke qenë edhe të shumta në numër, kanë dallime, por me gjithë dallimet, kanë dhe përbashkësi. Në radhe të parë ngjashmëritë burojnë nga pjesa e trashëguar e gjuhës, e në radhe të dytë prej huazimeve gjuhësore. R. Memushaj nuk është dakord e madje e kundërshton variantin e fortë të hipotezës së relativizmit gjuhësor pasi nëse i përmbahesh kësaj hipoteze, atëherë nuk do të kishte përkthime nga një gjuhë në tjetrën e anasjelltas, sikunder nuk do të kishte huazime as kulturore, as fakte të dygjuhësisë³³. Është e vërtetë që gjuhët mund të mos kenë struktura morfo-sintaksore e leksiko-semantike të njëjta, por kjo nuk do të thotë se nuk kanë asgjë të ngjashme midis tyre.

Mairal dhe Gil janë të mendimit se gjuhët e botës ndryshojnë më tepër në strukturën sintaksore, kryesisht në rendin e vendosjes së fjalëve e morfemave, në semantikë, në morfologji e fonologji³⁴. Sipas tyre, ka pak universale gjuhësore potenciale që lidhen me formën e fjalës. Për ta tendenca mbarë-gjuhësore lidhet me morfologjinë e shprehur nga afikset më shumë sesa nga

³¹ Phipps, S. (2001). Language and Thought: Examining Linguistic Relativity. (www.ttt.org/linglinks/StacyPhipps.htm accessed 20/3/12)

³² Chaika, E. (1989). Language the Social Mirror. New York: Newbury House Publishers. f.2.

³³ Memushaj R. Hyrje në Gjuhësi Botimet Toena Tiranë 2008 f 317-318

³⁴ Linguistic Universals. Ricardo Marial e Huana Gil Cambridge University Press 2006 f115-116

ndryshimet në formën e rrënjës (alomorfi i rrënjës) ose ndryshimet në theks, ton, dhe kështu me rradhë. Sipas Cutler, Hawkins dhe Gilligan, edhe mënyra e fjalëformimit me ndajshitesim (parashtesim, prapashtesim) përbën një universale gjuhësore, veçori të cilën e ndajnë shumica e gjuhëve natyrore³⁵. Këtë përbashkësi e gjejmë sigurisht mes gjuhës angleze dhe asaj shqipe, ku prapashtesimi ka prioritetin në të dyja gjuhët për shkak të numrit më të madh të prapashtesave.

Megjithatë, duhet theksuar fakti që dukuria e universaleve gjuhësore nuk pajtohet me dukurinë e relativizimit gjuhësor e cila shfaqet në leksikologjinë e morfologjinë e fjalëformimit. Variantin e fortë të kësaj hipoteze, sipas së cilës shumë nga ndryshimet gramatikore e leksikore janë të tilla që ato që mund të thuhet në një gjuhë, nuk mund të thuhet në një tjetër, bart një varg rrjedhimesh negative teorikisht e praktikisht.

Ne mendojmë se sistemi parashtesor i fjalëformimit lidhet me tezën e relativizimit gjuhësor, jo me variantin e fortë të saj. Sipas Hudson “një aspekt i relativitetit vërehet në disa gjuhë të cilat individualizojnë disa njësi që shprehin kuptime që në gjuhë të tjera nuk shprehin. Kjo ka të bëjë me pengesat që hasen sidomos gjatë përkthimit kulturor, letrar etj³⁶. Sipas Sepirit “Botët ku shoqëri të ndryshme jetojnë dallojnë midis tyre, nuk janë thjesht botë të njëjta të cilat dallohen vetëm prej etiketimeve të ndryshme.³⁷

Gjuhëtarët përcjellin dy supozime të hipotezës se relativizimit gjuhësor: a) gjuhët ndryshojnë në mënyrë kuptimplote në interpretimin e përvojës së secilës si në përzgjedhjen e informacionit ashtu edhe në radhitjen e tij ; b) këto interpretime të informacionit ndikojnë në mendim kur ata përdoren për ta mbështetur këtë informacion.

Të dy këto supozime të relativitetit gjuhësor të çojnë në idenë se anglishtfolësit mendojnë dhe e interpretojnë në mënyra më të ndryshme botën që na rrethon krahasuar me shqipfolësit duke e nxjerrë tezën e diversitetit linguistik si të padiskutueshme. Gjuha angleze dhe ajo shqipe kanë vërtet të përbashkëta gjuhësore, por shpesh shfaqin diferenca të mëdha në strukturat e tyre sintaksore, në leksik, në gramatikë, në semantikë, në letërsi, në pragmatikë, në kuptimin figurativ.

Deklarata e dytë sipas së cilës interpretimet e përvojave të secilit ndikojnë në mendim kur ato përdoren për ta mbështetur këtë informacion, është më i diskutueshëm. Megjithatë, kjo deklaratë shfaqet tepër bindëse duke qenë se forcat gjuhësore i japin formë mendimit në shkallë të ndryshme.

Krahas tipareve të përbashkëta që anglishtja e shqipja ndajnë, ato kanë gjithashtu edhe ndryshime, të cilat lidhen me faktorët jashtëgjuhësorë. Kështu, anglishtja duke qenë një gjuhë me shumë influencë në botë ka ndikim në pikepamjet e një anglishtfolësi mbi botën, ndërsa shqipja është gjuhë e një populli të vogël e ndryshme me anglishten që ne origjine. Rrjedhimisht, këto dy gjuhë përfaqësojnë dy realitete të ndryshme edhe kur përkthejmë nga gjuha angleze në shqipe e anasjelltas. Probleme përkthimore krijohen si rezultat i dallimeve gramatikore,

³⁵ Cutler, A., Hawkins, J. A., & Gilligan, G. (1985). The Suffixing Preference: A Processing Explanation. *Linguistics*, 23, 723-758.

³⁶ Hudson, R., *Socilinguistka*, Tiranë 2002, f. 94.

³⁷ Edward Saphir, *The Status of Linguistics as a Science*. University of California Press, 1985. page 209-210.

sintaksore, e leksikore. Hipoteza e relativitetit gjuhësor është universale dhe duhet përdorur në analiza e studime krahasuese ndërmjet gjuhëve.³⁸ Kesisoj, dukuria e relativitetit gjuhësor nuk mund të shmanget sidomos kohet e sotme, pasi komunikimi mes nesh është në rritje të vazhdueshme. Ndërmjet anglishtes dhe shqipes ka dallime që së pari lidhen me ndryshimet në botën materiale e shpirtërore të popujve që i flasin këto gjuhë, ndryshimet në kulturat e tyre.

Në jemi bazuar pikërisht në këtë teori gjuhësore për të analizuar ndikimin e kësaj hipoteze në formimet me parashtesa, në përpjekje për të zbuluar se sa relativizmi gjuhësor ndikon në përkthimin e ekuivalentimit të fjalëve të ndajshesura me parashtesa nga anglishtja në shqipë. Me fjalë të tjera fokusi ynë është të trajtojmë çështjen se si dhe sa mirë shqipja i përgjigjet shumësisë së prefikseve angleze, nën trysinë e parimeve të relativitetit gjuhësor, duke e studiuar atë krahasimisht.

³⁸ Shahini, M. Memisha, V. linguistic relativity occurrences between English and Albanian Vlore 2011 f

KREU II VËSHTRIM PANORAMIK NË LEKSIKUN E GJUHËS ANGLEZE

Gjuha angleze ka pësuar ndryshime të konsiderueshme gjatë tre periudhave kryesore historike të zhvillimit të saj, duke filluar që nga Anglishtja e Vjetër e deri në anglishten që dëgjojmë e shkruajmë sot, pra anglishten moderne apo bashkëkohore. Megjithatë, zhvillimin si dhe karakterin leksikor të gjuhës angleze e studiojmë më mirë duke hulumtuar që në rrënjët dhe origjinën e saj.

Gjuha angleze është një gjuhë minimalisht flektive krahasuar me shumë gjuhë të tjera indoeuropiane e aq më tepër me shqipen. Në gjuhën angleze mungon kategoria gramatikore e gjinisë dhe përshtatjen e mbiemrave me emrat. Kategoria e rasës pothuaj është zhdukur fare duke u kufizuar më shumë tek përemrat dhe shenjuesit e shumësit janë bërë më të rregullt. Si rrjedhim, gjuha është mbështetur më shumë në karakteristikat të tilla si foljet modale dhe rendi i fjalëve për të dhënë veçori gramatikore.

Gjuha angleze është pjesë përbërëse e degës së gjuhëve gjermanike të familjes së madhe indoeuropiane, pikërisht pjesë e nëndegës së Gjermanishtes së Perëndimit të “Protogjermanishtes”. Studiuesit e njohin Protogjermanishten si familja e gjuhëve gjermanike, e cila diferencohet në tri nëndegë të saj: Gjermanishtja e Veriut që sot dëshmohet nga gjuha daneze, suedeze, norvegjeze, islandishtja dhe gjuhët e ishujve Faroe; Gjermanishtja e Perëndimit që dëshmohet sot prej Gjermanishtes së Sipërme, Gjermanishtes së Poshtme, hollandishtes, flamandishtes, frizishtes, saksonishtes së vjetër dhe anglishte. Dega e tretë e saj është Gjermanishtja Lindore, të dhënat për të cilën gjenden në gjuhën tashmë të vdekur, Gotishten.³⁹

Të gjitha gjuhët gjermanike kanë shumë veçori të ngjashme, të njëjta me anglishten, p.sh ka mbiemra dhe folje, të cilat sipas lakimit e zgjedhimit ndahen në “të forta” e “të buta”. Gjithashtu, në gjuhën angleze theksi i fjalëve bie në rrokjen e parë a të dytë, një tipar karakteristik i gjuhëve gjermanike. Dy karakteristikat e lartpërmendura flasin për ngjashmërinë e gjuhës angleze me grupin gjermano-perëndimor.

E parë nga ana historike, historia e gjuhës angleze është ngushtësisht e lidhur me historinë e ishujve britanikë që 1500 vjet më parë. Fillesat e saj gjuha angleze i ka me pushtimin dhe vendosjen e fiseve gjermanike në një pjesë të madhe të Britanisë në shekullin e pestë. Këto fise vinin më së shumti nga Danimarka dhe brigjet veri-perëndimore të Gjermanisë e Hollandës së sotme. Vetë fjalët *English* dhe *England* rrjedhin nga emri i njërit prej këtyre fiseve gjermanike, *the Angles*. Gjuha angleze i ka rrënjët në gjuhën që flisnin këto fise gjermanike, e cila në dokumente njihet si gjuha anglo-saksone. Këputja e lidhjeve me gjuhët dhe dialektet e vjetra gjermanike bënë që të zhvillohej një gjuhë e veçantë gjermanike, anglishtja⁴⁰.

Gjuha angleze në rreth 15 shekuj të ekzistencës së saj në territorin e Anglisë sigurisht që ka pësuar ndryshime dhe zhvillime të shumta e të pandërprera në kohë. Ndaj do të ishte pothuajse e pamundur ta studioje historinë e saj pa e ndarë në periudha të cilat mbartin edhe ndryshimet apo zhvillimet më kryesore të gjuhës angleze në kohë. Kështu historia e gjuhës angleze kalon në këto periudha kryesore:

³⁹ A History of the English Language”, Baugh, Albert C; Cab,Thomas, f.30

⁴⁰ Baugh, A. C. “A History of the English Language” London: Routledge and Kegan Paul, 1978.

- 1) **Anglishtja e Vjetër** (shek V-të – shek XI-të, 449 – 1066)
- 2) **Anglishtja e Mesme** (shek XI-të – shek XV-të, 1066 – 1500);
- 3) **Anglishtja Modernë** (shek XV-të – deri në ditët tona).



Anglishtja e Vjetër nis me pushtimin anglo-sakson në shekullin e pestë dhe perfundon në shekullin e XI me pushtimin Norman. Fiset gjermanike që vinin nga Gjermania, Danimarka dhe Holanda, përkatësisht: Anglët, Saksonët dhe Jutët migruan drejt ishujve britanikë në shekujt V-VI pas Krishtit. Ata pushtuan ishujt britanikë dhe sollën një gjuhë të përbashkët, e cila në dokumente emërtohet gjuha anglo-saksone. Gjurmë të së folurës së këtyre fiseve gjenden vetëm nga shekulli VII e deri në shekullin e XI ose pak më vonë. Këputja e lidhjeve me gjuhët dhe dialektet e vjetra gjermanike bënë që të zhvillohej një gjuhë e veçantë gjermanike, anglishtja. Kështu, në vitin 750 anglishtja e vjetër u zhvillua si një gjuhë e veçantë gjermanike, e ndryshme nga e folmja origjinale e Anglëve dhe Saksonëve. Nga një mijë fjalët më të përdorura sot, 83 % e tyre janë me origjinë nga e vjetër. Sot anglishtja bashkëkohore përmban vetëm 30 % të fjalëve anglo-saksone.

Anglishtja e vjetër ishte një gjuhë sintetike e cila zotëronte të gjitha mbaresat që kishin edhe gjuhët e tjera gjermanike. Ajo huazoi shumë nga latinishtja (rreth 450 fjalë) dhe nga Skandinavishtja e Vjetër.⁴¹ Forma e shkruar e Anglishtes së Vjetër lindi në pjesën veri-lindore dhe perëndimore të mbretërisë saksone të Elfredit, në gjysmën e dytë të shekullit IX. Mendohet se alfabeti runik është alfabeti gjermanik (ndoshta me origjinë nga mbishkrimet greke), i përdorur nga popujt skandinavë dhe gjermanikë aty rreth shekullit III. Alfabeti i saj ishte ai runik. Gjuha angleze ka ndryshuar kaq shumë gjate rrjedhës së kohës sa që Anglishtja e Vjetër ngjan me një faqe libri frëngjisht dhe italisht, për shkak të disa grafemave që nuk ekzistojnë sot në gjuhën angleze. Gërmëzimi dhe shqiptimi, fjalori dhe gramatika janë fushat kryesore ku hasen dallime mes Anglishtes së Vjetër dhe asaj moderne.

⁴¹“Huazimet italiane në leksikonin e gjuhës angleze”. F.31,32, O.Xhina

2.1 Veçori të leksikut të anglishtes së vjetër

1. Tiparet gramatikore

Duhet theksuar fakti që gjuhët inflektive bëjnë pjesë në dy klasa: gjuhët sintetike të cilat paraqesin lidhjen mes fjalëve nëpërmjet mbaresave dhe gjuhët analitike ku përdoren në masë parafjalët, foljet ndihmëse dhe rendin e fjalëve brenda fjalisë për të përcjellë mesazhin e sakë. Më poshtë po rendisim disa nga karakteristikat gramatikore të Anglishtes së Vjetër:

Sipas studiuesve të gjuhësisë dhe historisë së gjuhës angleze, Anglishtja e Vjetër ishte një gjuhë më tepër sintetike se sa analitike.⁴²

Së dyti, emri, folja, mbiemri, nyjet, dhe përemri kishin mbaresa. Dhe për rrjedhojë rendi i fjalëve në fjali nuk ishte aq strikt sa ai i anglishtes së sotme.

Së treti, Anglishtja e Mesme karakterizohej nga një lakim i theksuar emrash dhe zgjedhim të foljeve.

Ndikimi dhe kontributi i elementit të huaj ndodh që të jetë vërtetë aq i madh sa të mund të konsiderohet akoma më domethënëse në prurje fjalësh se sa ai autokton. Më pas janë pikërisht rregullat dhe ligjësitë fonetike dhe gramatikore të gjuhës pritëse ato të cilat i përpunojnë dhe i përshtasin në gjuhë. Në ditët tona kanë mbërritur shumë pak fjalë kelte, pra fjalë që përbëjnë grupin e njësive leksikore që lidhen me leksikun amtari (autokton). Në gjuhën angleze burimi më i furishëm i pasurimit të fjalorit ka qënë grupi i njësive leksikore të huazuara nga gjuhët e tjera, sidomos atë, latine, frënge, greke, skandinave, italiane etj.

Me teprinë e fjalëve me origjinë nga latinshtja dhe greqishtja përmes gjuhës latine, një vëshgues i thjeshtë do ta konsideronte gjuhën angleze si një gjuhë romane (neolatine) ashtu si edhe frëngjishtja, spanjishtja dhe italishtja, e folur nga romakët e vjetër. Por, pavarësisht kësaj gjuha angleze bën pjesë në grupin gjermanik të gjuhëve e për rrjedhojë konsiderohet motër e gjuhëve të zhdukura si gjuha e vjetër norse (old Norse) dhe gotike (Gothic) apo motër e gjuhëve të tjera moderne si suedishtja, hollandishtja dhe gjermanishtja.

2.1.1 Fjalëformimi

Përsa i takon fjalëformimit, formimi i fjalëve mundësohej përmes menyrës së kompozimit, parashtesimit dhe prapashtesimit. Ka fjalë të përbëra kuptimi i të cilave del nga shuma e kuptimeve të fjaëve autoktone që janë lidhur në këtë formim. Fjalë të kësaj natyre gjenden në shumë gjuhë, por ato janë karakteristië e anglishtes së vjetër, sikurse edhe të gjermanishtes modern. Për hidrogjenin gjermanishtja përdor fjalën *äasserstoff* (ëater stuff), për telefonin *fernsprecher* (far speaker). Në anglishten e vjetër shumë fjalë janë formuar sipas këtij modeli: *leohtfeat* (light vessel/ abazhur); *earhring* (ear ring/ vath); *degred* (day red/agim). Aftësia që ka anglishtja e sotme për të krijuar fjalë të ngjashme, edhe pse me numër të kufizuar, vjen si rrjedhojë e një trashëgimie nga tradita e anglishtes së vjetër.

⁴² An introduction to English lexicology”, Wuhan University Press, Lin Chenzhang, 1997, f 2, 3

2.1.2 Parashtesat e anglishtes së vjetër

Me ndihmën e parashtesave si: **a-, be-, for-, fore-, ge-, mis-,of-, ofer-, on-, to-, un-, under-**dhe **wib-**, anglishtja e vjetër mund të krijonte fjalë të shumta nga fjalët e thjeshta si p.sh. nga *settan* (*set*) vendos u krijuan *asettan* (*place*), *besettan* (*appoint*), *forsettan* (*obstract*), *gesettan* (*people*). Parashtesa **wib-** përfshihet në më tepër se pesëdhjetë folje të Anglishtes së vjetër ku shpreh kundërshti. Kështu për *shembull*, *wibceosan* (*reject*), *wibcewpan* (*deny*) etj.

Parashtesa **ofer-** haset në mbi njëqind folje të Anglishtes së vjetër.

2.1.3 Prapashtesat e anglishtes së vjetër

Prapashtesat me tipike e të përdorura të periudhës janë **-ig, -full, -leas, -lice, -nes, dhe -ug**. Të tjera që patën gjetur përdorim të gjerë përfshijnë prapashtesat e mbiemrave **-sum, dhe -wis**, prapashtesat e emrave: **-dom, -end, -dhe -ere, -had, -ing, -ung, -scipe** dhe shumë të tjera.⁴³

2.1.4 Tiparet e fjalorit

85 % të fjalorit të Anglishtes së Vjetër e përbënte leksiku me karakter gjermanik, i cili tashmë është jashtë përdorimi në gjuhën angleze. Fjalët që kanë mbijetuar përbëjnë elementin bazë të leksikut të gjuhës angleze ashtu si edhe shumë fjalë të klasave të mbyllura si: *parafjalë*, folje ndihmëse, *përemra*, etj. Ato shprehin koncepte bazë **mann** –*man*, **wif** –*wife*, **cild** –*child*, **wis** –*house*. Elementët që ndikuan në formimin e fjalorit të kësaj periudhe ishin fjalët e burimit autokton kelt, huazimet romake dhe skandinave.

Huazimi i fjalëve ndodhte fare pak në Anglishten e Vjetër. 85 % të fjalorit të Anglishtes së Vjetër e përbënte leksiku me karakter gjermanik, i cili tashmë është jashtë përdorimi në gjuhë.

2.2 Ndikimi kelt

Gjatë 700 viteve të para të jetës së saj si gjuhë, anglishtja ka qenë në kontakt me të paktën tre gjuhë të tjera, gjuhën kelte, atë romane dhe skandinave. Nga secila prej tyre anglishtja e vjetër pati ndikime të ndjeshme sidomos në leksikun e saj.

Emrat kelte të vendeve dhe huazime të tjera.

Veç toponimeve, ndikimi i gjuhës kelte në anglishten e sotme është i pakonsiderueshëm. Fjalët që mësuhan pushtuesit anglo-saksonë ishin fjalë të përdorimit të përditshëm të cilat sot nuk ekzistojnë më. Ndikimin kelt në leksikun e gjuhës angleze e dëshmojnë kryesisht emrat e vendeve. Kështu Mbretëria Kent e ka origjinën në fjalën kelte *Canti* apo *Cantion*. Vende të tjera veçanërisht në pjesën perëndimore dhe jug-perëndimore, ruajnë edhe sot emërtime të gjuhës kelte. *Devonshire* përmban në elementin e saj të parë emrin e fisit *Dumnonii, Cornwall*.

⁴³ Bardhyli, A “Çështje të huazimeve frënge në fjalorin e gjuhës angleze” f 13

- Për më tepër, elementin kelt e gjejmë të mishëruar edhe në emërtimet e një sërë qendrash të rëndësishme të periudhës romake. Vetë emri **London**, mendohet të rrjedhë prej ndikimit kelt. Gjithashtu, rrokjet e para tek emrat **Winchester, Salisbury, Exeter, Gloucester, Worcester, Lichfield**, si dhe bërthama e shumë emrave të tjera vijnë nga po i njëjti burim, ai kelt.
- Burimi kelt dëshmohet edhe përmes emrave të lumenjve si p.sh **Thames, Avon, Exe, Esk, Usk, Dover**, dhe **Wye**.
- Emrat e disa prej kodrave dhe zonave kodrinore gjithashtu mbajnë emra të burimit kelt si p.sh **Barr, Bredon, Bryn Mawr, Creech, Pendle** dhe të tjerë.
- Emrat e luginave në Angli gjithashtu dëshmojnë për ndikimin kelt si p.sh: rrënjën **cumb** (luginë e thellë) në emrat si **Duncombe, Holcombe, Winchcombe; torr** (shkëmb i lartë) në **Torr, Torcross, Torhill; pill** në **Pylle, Huntspill**; dhe **brocc** në **Brockholes, Brockhall**, etj.

Gjithashtu, në anglishten e vjetër hasen disa fjalë me origjinë kelte që kanë mbërritur deri më sot të modifikuara nga ndikimi latin si p.sh: camp (L campus); cheap (OE ceap < = L caupo); kettle (OE cytel < = L catillus); kitchen (OE cycene < = L coquina); pound (OE pund < = L pondo); wall (OE weall < = L vallum); wine (OE win < = L vinum) Përveç emrave të vendeve (emra qytetesh, lumejsh, kodrash), ndikimi kelt është i pa konsiderueshëm.⁴⁴

2.2.1 Ndikimi romak

Ndikimet latine në Anglishten e Vjetër

Ndryshe nga gjuha kelte, ajo latine nuk ishte gjuha e një populli të pushtuar. Gjuha latine i përkiste një kulture dhe civilizimi të admirueshëm dhe nga i cili anglo-saksonët donin shumë të mësonin. Kontaktet me këtë kulturë në fillim tregëtare dhe ushtarake, më vonë fetare dhe intelektuale, u shtuan me kalimin e shekujve dhe u vendosën në mënyrë të qëndrueshme. Kontakti misdis dy kulturave nisi që me ardhjen e anglo-saksonëve në Angli dhe vazhdoi gjatë tërë periudhës së Anglishtes së Vjetër. Për rreth qindra vjet ndërsa fiset gjermanike, të cilët më vonë u quajtën Anglezë, ishin ende duke kërkuar terren në continent, filluan të krijonin marrëdhënie të mira me romakët dhe si rrjedhojë përfituan shumë prej gjuhës së tyre, atë latine. Më vonë, pasi ata u ngulën në Angli, u njohën me atë cka kishin lënë romakët në ishull ashtu si edhe mësuan prej keltëve fjalë latine të huazuara nga ata. Një shekull e gjysëm më vonë, kur misionarët romakë risollën në ishull kristianizmin, ky ndikim i ri kulturor bëri të mundur futjen e një sërë fjalësh të huaja, latine, në leksikon e Anglishtes së Vjetër. Ndikimi i gjuhës latine vërehet në dy periudha të Anglishtes së Vjetër.⁴⁵

⁴⁴ Dillon, Myles. "Linguistic Borrowing and Historical Evidence." *Language* (1945): 12-17.

⁴⁵ Haugen, Einar. "The Analysis of Linguistic Borrowing." *The Ecology of Language: Essays by Haugen*. Ed. Anëar S. Dil. Stanford: Stanford UP, 1972. 79-109.

Periudha e parë

Pas pushtimit romak (43-449 pas Krishtit) latinishtja u bë gjuha zyrtare e administratës. Gjuha latine duhej të përdorej edhe nga banorët e thjeshtë dhe në ushtri gjithashtu. Si rrjedhim gjuha kelte adoptoi shume fjale latine. Kur ishulli britanik u pushtua nga anglo-saksonët.⁴⁶ Këta të fundit huazuan disa fjale latine qe tashme ishin bërë pjesë e fjalorit kelt, ndër të cilat më tipiket ishin ato të krijuara me prapashtesat – **chester(-cester ose- caster)** (nga latinishtja castra – kamp ushtarak) dhe – **wick(-wich)** (nga latinishtja vicus – fshat) në:

- Toponimet: Manchester, Gloucester, Lancaster, Wareick, Greenwich etj.
- Tregti: cēap (bargain; cf. Eng., cheap, chapman) dhe mangian (to trade) prej nga vjen mangere (monger), mangung (trade, commerce); mangunghūs (shop), pund (pound); mydd (bushel); sēam (burden, loan); dhe mynet (coin). Nga fjala e fundit anglishtja e vjetër formoi fjalët mynetian (to mint or coin) and mynetere (money-changer).
- Artikuj shtëpiake dhe veshje: cytel – catillus (kettle), scamol – scamellum, teped-tapetum (curtain), sigel – sigillum (brooch) pyle - pulvimus (pilloë). cytel (kettle; L. catillus, catinus), mēse (table), scamol (L. scamellum, bench, stool; cf. modern shambles), teped (carpet, curtain; L. tapētum), pyle (L. pulvinus, pillow), pilece (L. pellicia, robe of skin), and sigel (brooch, necklace; L. sigillum). cycene (kitchen; L. coquina), cuppe (L. cuppa, cup), disc (dish; L. discus), cucler (spoon; L. cocleārium), mortere (L. mortārium, a mortar, a vessel of hard material), līnen (cognate with or from L. līnum, flax), līne (rope, line; L. līnea), si dhe gimm (L. gemma, gem).
- Ushqime: ciese-caseus (cheese), senep-sinapi (mustard), minte-mentha (mint). cīese (L. cāseus, cheese), spelt (wheat), pipor (pepper), senep (mustard; L. sināpi), cisten (chestnut free; L. castanea), cires {bēam} (cherry tree- L. cerasus), ëhile to this period are probably to be assigned butere (butter; L. bütȳrum), ynne (lëac) (L. ūnio, onion), plūme (plum), pise (L. pisum, oea).
- Ndërtim: cealc (chalk), copor (cooper), tigele (tile)
- Të tjera: mul (mule), draca (dragon). Pipe (pipe), cirice (church), biscop (bishop), Saternesdag (Saturday), pic (pitch).

Periudha e dytë

Periudha e dytë (597 -1066) ka të bëjë me kristianizimin e popullsisë anglo-saksone pas misionit të Shën Agustinit në vitin 597. Gjatë periudhës së dytë të Anglishtes së Vjetër, depërtuan fjale kryesisht me **tematikë fetare** si p.sh. pope, abbot, alms, minster, angel, altar, deacon, disciple, epistle, litany, hymn, martyr, rule, temple, tunic etj; **tematike arsimore** si p.sh.: school, master, grammatic, verse, meter, gloss, cathedra, bibliotheca, prologus literacy, literate, literature.

⁴⁶ Coleman, Julie. "The Chronology of French and Latin Loanwords in English." *Transactions of the Philological Society*. 93.2 (1995): 95-124

Gjithashtu u huazuan edhe fjalë nga **artikuj shtëpiake dhe veshje** si: cap, plant, chest, mat, sack, silk, purple; **ushqime** si: beat, caul, lentil, pear, radish, does, oyster, mussle, cook.

2.2.2 Ndikimi skandinav

Pushtimi skandinav u zhvillua ne tri faza. Faza e pare (787-850) shënon sulmet ndaj manastireve dhe qyteteve bregdetare kryesisht nga banda të vogla pushtuesish. Faza e dytë (850-878) nis me mbërritjen e një flote daneze prej 350 anijesh dhe kapitullimin e saj pas 38 vjet qëndrese të popullsisë vendase. Faza e tretë perfshin periudhën (901-1014). Sundimi i ri nuk mund të mos linte gjurmë edhe në fjalor. Ndikimet tipike në skandinavishte vërehen në:

Toponimet: Ka më shumë se 600 vende që ngjajnë me emrat e Grimsby, Derby, Rugby, Therosby, pra me parapashtesen –by, që në gjuhën daneze do të thoshte “ fermë”, “qytet”. Gati 300 vende kane emra të ngjashem me althorp, bishopsthorpe, gawthorpe, pra me prapashtesen – Thorpe, fshat. Gati 100 vende kane emra qe mbarojne me –toft “cope toke”: Bimstoft, Eastoft, Langtoft, Nortoft.

- Emrat e perveçëm qe mbarojne me –son: stevenson, Johnson
- Emrat që lidhen me lundrimin: orrest (battle), dreng(warrier), ran(robbery)
- Fjalë legjislativë: mal (action at law), hold (freehold) wapentake(district), hosting(assembly)
- Fjalë të përdorimit të përditshëm që kanë mbërritur deri në ditët tona: tree, bank, boon, brink, bull, guess, kill, leg, link, eff, reef, race, stack, weak, rooten, get, give, flit, rooten, take, thrive, muggy, meek, etj.

Gjuha i përvetësoi shpejt elementet e huazuara skandinave dhe ndikimi i tyre është nga me interesantet. Fatkeqësisht, dorëshkrimet datojnë shumë më vonë nga fillimet e huazimeve dhe përdorimit te tyre. Në veprën “Ormulum”, në fillim të shekullit të XII-të gjejmë pjesën më të madhe të tyre.

2.3 Veçori të leksikut të anglishtes së mesme

Zhvillimi i anglishtes së mesme nis që nga shekulli i XI-të dhe përfundon në – shek XV-të (1066 – 1500). Nga fundi i periudhës së anglishtes së vjetër ndodhi pushtimi Norman, një ngjarje historike e cila pati një ndikim të konsiderueshëm në gjuhën angleze. Në vitin 1066, pas një mbretërimi 24-vjecar, mbreti Eduard ndërroi jetë pa lënë asnjë trashëgimtar. Kushëriri i tij i dytë, Uilliam, në atë periudhë ishte duka i Normandisë. Në vitin 1066, në betejën vendimtare në Hasting, Uilliam arriti ta marrë kurorën angleze. Sigurisht kjo ngjarje ushtroi një ndikim tepër të madh edhe në vetë gjuhën angleze. Me pushtimin norman përdorimi i frëngjishtes nga klasa sunduese ishte më se i pranueshëm. Në shekullin e XIII gjuha frënge gëzonte popullaritet në mbarë Europën. Franca konsiderohej si shoqëria kalorsiake në formën e saj më të pastër dhe kultivimi i frëngjishtes ishte përhapur në të gjitha oborret, duke u bërë gjuha tepër e njohur nga të gjithë. Pra, faktet historike dëshmojnë se gjuha frënge ishte ajo e cila në krahasim me gjuhë të tjera dha një kontribut shumë të madh në leksikun e Anglishtes së Mesme. Në Anglishten e kësaj periudhe pas asimilimit fonetik, afro 10,000 fjalë frënge të huazuara u bënë pjesë e fjalorit anglez

dhe sot 75% e tyre përdoren ende. Huazimet frënge i gjejmë pothuaj në të tëra fushat e jetës angleze. Më poshtë rendisim disa prej tyre.

Huazimet ne gjuhen administrative: crown, royal, state, authority, sovereign, empire, realm, prerogative, authority, adjourn, tax, revenue, exchequer etj. Fjalë që lidheshin me sistemin e qeverisjes si allegiance, subject, rebel, traitor, treason, exile, public, liberty; titujt si marshal, governor, mayor, warden, constable, minister, viscount etj.

Huazimet ne gjuhen fetare: ne anglisht gjejmë fjale frënge, ose latine e greke qe kane hyre ndermjet frengjishtes si religion, theology, sermon, homily, sacrament, baptism, communion, confession, penance, prayer, orison, lesson, passion, psalmody, sacrilege, divine, temptation, salvation, heresy, creator, incense, faith, image, surplice, vicar, sexton, virgin, saint etj.

Huazimet ne gjuhen juridike: plea, suit, judge, bill, petition, advocate, pledge, verdict, fraud, adultery, property, estate, prison, punishment, seize, implead, fraud, judge, estate, property, assail, slander, prison, goal, defendant, fine, forfeit, adultery, ransom, complaint, arrest, depose, blame, legacy, heritage, heir, patrimony, innocent, culpable etj.

Huazimet ne gjuhen e artit: painting, music, color, image, sculpture, beauty, cathedral, palace, mansion, etj. Në fushën e letërsisë hynë fjalë të reja si: poet, prose, romance, paper, pen, volume, chapter, study, logic, geometry, grammar, noun, gender, genre.

Huazimet ne gjuhen e mjekesise: physician, pain, pulse, remedy, ointment, sulphur, chirurgy.

Huazimet ne gjuhen e modes: Apparel, veil. Collar, scarlet, garter, mitten, malady, pain, poison, chirurgy, anatomy, stomach, remedy, ointment, sulphur, etj.

1.3.1 Fjalëformimi në anglishten e mesme

Anglishtja e vjetër, sikurse gjuhët e tjera indo-europiane e zgjeroi fjalorin duke përdorur parashtesat, prapashtesat dhe fjalët e përbëra, kuptimi i të cilave dilte lehtësisht. Në shekujt pas pushtimit Norman, vihet re një rënie e këtyre metodave të vjetra të fjalëformimit.

1.3.2 Parashtesimi

Shumë parashtesa të anglishtes së vjetër e humbën fuqinë e fjalëformimit.

Parashtesa **for-**, e cila i korrespondon parashtesës gjermane **ver-** përdorej për të intensifikuar kuptimin e foljes. Gjatë periudhës së anglishtes së mesme, ajo u përdor ndonjëherë në formimet e fjalëve të reja. Nga viti 1300 gjejmë fjalët **forhang** (dënoj me varje), **forcleave** (pres ne copa), **foreshake** (shkund). Ajo iu bashkangjiti edhe fjalëve franceze: forcover, forbar, forgab. Këta shembuj tregojnë se kjo parashtesë nuk ishte eliminuar, por nuk kishte as rëndësinë e dikurshme. Asnjëri prej këtyre formimeve nuk jetoi gjatë dhe sot for- konsiderohet një parashtesë e vjetëruar. Foljet që kanë mbërritur e ruhen në Anglishten Moderne janë forbear, forbid, fordo, forsake, forget, forgive.

Parashtesa **to-**, e cila i korrespondonte gjermanishtes zer- është zhdukur më shpejt. Në Biblën e vitit 1611 thuhet shkruhet: “all tobrake his skull”. Edhe për disa vjet u përdorën fjalët tomelt, toburst, por sot nuk ka gjurmë të përdorimit të kësaj parashtese.

Parashtesa **with-** u dha kuptime të reja fjalëve si: withdraw, withgo, withsake, etj. Më pas **withsay** u zëvendësua me fjalën frënge *renounce*, **withspeak** me *contradict*, **ëithset** me *resist*.

Disa parashtesa të cilat janë produktive sot si p.sh. **over-** dhe **under-**, pas pushtimit norman nuk u përdorën shumë. Shumë fjalë të përbëra me over- u krijuan në Periudhën e Rilindjes.

Në periudhën e Rilindjes, parashtesa **on-** sot **un-** vazhdoi të ishte produktive. Gjatë kësaj kohe u krijuan fjalët unfasten, uncover, unërap. Në disa raste, kjo parashtesë u zëvendësua me parashtesat latine **dis-**, **counter-**, **trans-**.

Parashtesat e reja që hynë nga frengjishtja nisën të kenë një fuqi të madhe fjalëformuese: en-, em-, mis-, sur-, de-, dhe pre-: endow, empower, mischief, surveil. Humbja e aftësitë fjalëformuese të parashtesave dëshmon se fjalët e reja e të gatshme frënge kishin dobësuar traditën fjalëformuese.

1.3.3 Prapashtesimi

E njejta dukuri vërehet edhe me prapashtesat që ishin shumë të përdorura në Anglishten e Vjetër. Humbja e tyre mund të mos ndihet aq shumë, pasi një pjesë e mirë vazhdojnë të përdoren ende. Të tilla janë prapashtesa për formimin e emrave: -ful, -less, -some, -ish, -dom si në fjalën freedom (liri).

Ka prapashtesa që kanë humbur si ato të formimit të emrave abstraktë – lock, sot gjendet vetëm në fjalën wedlock: -red si në kindred, hatred.

-dom sot përdoret në disa formime të pazakonta si stardom, fandom.

-hood si në fjalët manhood, likelihood. Këto janë sot formime të reja të Anglishtes së Mesme që tregojnë se kjo prapashtesë u ruajt për ca kohë. Boyhood dhe girlhood e kanë origjinën nga shekulli XVIII.

-ship përdoret për formimin e emrave abstraktë, por shumë fjalë të krijuara në periudhën e anglishtes së mesme nuk kanë mbërritur në ditët tona. Sot kemi vetëm fjalët friendship, ëorship, hardship, kinship, etj. Për të gjitha rastet e formimit të emrave prej mbiemrave është preferuar prapashtesa -ness.

-Al, (at)ion, -(at)or, -er, -ment, -ure, -ic, -ive, -ize janë prapashtesa latine. Ato hynë me fjalët që shënonin terma në drejtësi, mjekësi, teologji, shkencë e letërsi. Fjalët që u huazuan nga latinishtja u huazuan nëpërmjet frengjishtes. Kësisoj, adoptimi i fjalës në gjuhën angleze mund të ketë ardhur si pasojë e ndikimit të të dyja gjuhëve.

-Prapashtesat e emrave -son, -age, -ment si tek emrat: reason, prison, season, voyage, commitment.

-Prapashtesat -or, (-our), -ty, -ure, -ance/ence, -ant/-ent, -ity, -tion, i gjejmë tek fjalët: color, dolor, terror, cruelty, safety, creature, nature.

-Prapashtesat e mbiemrave: -ous, -ve, etj si në hideous, brave.

-Prapashtesat e foljeve -ish: establish, finish, furnish, punish janë elementët e rinj fjalëformues.

1.4 Asimilimi i huazimeve në gjuhën angleze

Efektet e pushtimit norman u ndjenë shumë shpejt në fjalorin e gjuhës angleze. Këtë fakt e njohin të gjithë, por vetëm gjatë shekullit XX u arrit të përpilohen të dhëna që na mundësojnë të flasim me siguri të plotë mbi periudhat e sakta të huazimeve. Këto të dhëna gjenden të cituara në fjalorin Oxford English Dictionary.⁴⁷ Në vitin 1905, studiuesi Otto Jespersen kreu një studim statistikor lidhur me 1000 fjalë të huazuara nga frëngjishtja duke i klasifikuar ato sipas datave kur ishin regjistruar në gjuhën angleze dhe i grupoi në gjysmë-shekuj⁴⁸. Profesori Jespersen mori 100 fjalët e para sipas gërmave A-H dhe 50 të parat sipas gërmave I-J.⁴⁹

Table 1 - Huazimi i fjaleve nga frëngjishtja sipas studjuesit O. Jespersen

- 1050	2	1301 – 1350	108	1601 - 1650	61
1051-1100	0	1351 – 1400	198	1651 - 1700	37
1101-1150	2	1401 – 1450	74	1701 – 1750	33
1151-1200	7	1451 – 1500	90	1751 - 1800	26
1201-1250	35	1501 – 1550	62	1801 - 1850	46
1251-1300	99	1551 – 1600	95	1851 - 1900	25

Për një periudhë 100-vjeçare pas pushtimit norman, nuk vërehen ndonjë numër i madh huazimesh. Numri i tyre nis të rritet nga fundi i shekullit XII dhe ritmet e tij shpejtohen mes viteve 1200 – 1250. Piku i përdorimit vërehet nga fundi i shekullit XIV. Pas vitit 1400, kjo lëvizje e ka humbur ritmin dhe vazhdon të bjerë gjithnjë e më shumë.

Shpejtësinë e asimilimit të fjalëve frënge e dëshmon fakti se sa shpejt ato u bënë baza e fjalëve të prejardhura. Për shembull, mbiemri *gentle*, i huazuar më 1225, gjendet në një formë të përbërë në fjalën angleze, *gentleman*, në vitin 1230. Më vonë u krijuan fjalët *gentleman*, 1275, *gentleness* 1300, *gently* 1330.

E njëjta gjë ndodhi me fjalën *faith* 1250 me të cilën u krijuan fjalët *faithful*, *faithless* 1300, *faithfully* 1362, *faithfulness* 1338, si edhe forma tashmë e vjetëruar e *faithly*, 1325.

Prapashtesa ndajfoljore *-ly* iu shtua mbiemrave sapo ata hyne në gjuhë. Ndajfoljet *commonly*, *eagerly*, *feebly*, *fiercly*, etj shfaqen në atë periudhë kur u huazuan edhe mbiemrat përkatës.

Format hibride (me rrënjë franceze dhe ndajshitesa angleze) si *chasthed*, *poorness*, *becatch*, *ungracious*, *overpraising*, *forscald* dalin shumë herët, që në vitin 1250. Duket qartë se fjalët e reja frënge u asimiluan shpejt dhe u shkrinë me elementin anglez në mënyrën më të natyrshme.

⁴⁷ The Oxford Advanced Learner's Dictionary, Oxford University Press, 2000. (Për të dhënat mbi gërmën A).

⁴⁸ Jespersen, O "Growth and structure of the English language, (4th edition, 1828), fq.94

⁴⁹ On the chronology of the French loan-words in English", English studies, 25, 1943, fq 33-40.

1.5 Zhvillimi i Anglishtes Bashkëkohore

Vitet 1500 dhe 1650 shënojnë fillimin e fundin e etapës së Rilindjes. Kjo periudhë shënon fillimin e asaj që njihet si “Anglishtja Moderne”. Gjatë kësaj periudhe sikurse nga vetë emri “Rilindje” iu theksi rritjes së ndjenjës kombëtare e sidomos të gjuhës kombëtare. U bënë shumë përpjekje për të zgjeruar fjalorin me fjalë të gurrës vendase për të kufizuar ndikimin e fuqishëm francez të shekujve më parë. U bënë shumë përpjekje për zgjerimin e leksikut të anglishtes me fjalë autoktone, për kufizimin e ndikimit të fuqishëm të gjuhëve të huaja sidomos ajo frënge të shëkujve më parë. Megjithatë pati shumë shkrimtarë, ndër të tjerë edhe Shekspiri, të cilët futën shumë fjalë në leksikun e anglishtes, si p.sh italianizmat. Pra fundi i periudhës së Anglishtes së Mesme dallon dy fenomene të cilët ja vlen që ti përmendim: 1.Kufizimi i huazimeve frënge dhe 2.Vendosja e Gjuhës Letrare Kombëtare.

Shekulli i XVI-të ishte shekulli i zgjerimit të horizonteve dhe rënia e kufijve apo barrierave të ngritura deri në ato kohë si rrjedhojë e mungesës së informacionit dhe paditurisë. Ishte shekulli i zbulimit të kontinenteve të reja, vendeve të reja, kulturave të reja të panjohura deri më atëherë. Nga pikëpamja gjuhësore për shkak të udhëtimeve të shumta drejt vendeve të ndryshme, njerëzit kishin munësi të njiheshin me gjuhë të kombësive të tjera. Në këtë mënyrë gjuha angleze huazoi jo vetëm nga gjuha italiane, por edhe fjalë të gjuhëve të tjera europiane.

2.5.1 Huazime te Anglishtes Bashkëkohore (1500 – deri ne ditet e sotme)

Kështu, një nga tiparet e gjuhës angleze që përdoret sot nga miliona e miliona njerëz në botë është karakteri i saj i përzierë. Shumë gjuhëtarë e konsiderojnë praninë e fjalëve të huaja sidomos atë frëngë si faktorin më të rëndësishëm në historinë e gjuhës angleze. Kjo pikë vështrimi mbështetet gjerësisht në provat e prejardhjes së fjalorit të gjuhës angleze, gramatikës dhe sistemit të saj fonetik. Elementi vendas dhe i huaj janë të pandashëm në gjuhë. Një pjesë e fjalorit të anglishtes së vjetër është ruajtur, por shumë fjalë kanë dalë jashtë përdorimit. Kur flitet rreth rolit të elementit vendas në gjuhën angleze, gjuhëtarët kufizohen në pak fjalë me origjinë Anglo-saksone, të cilat zënë 25-30% të fjalorit anglez. Pothuajse të gjitha fjalët me origjinë anglo-saksone i përkasin një grupi semantik shumë të rëndësishëm. Ato përfshijnë të shumtën e foljeve ndihmëse dhe modale (shall, will, should, would, must, can, may), përemrat (I, you, his, her, who, etj), parafjalët (on, under, out, etj), numërorët (one, two, three, etj), dhe lidhëzat (and, but, like, till, as etj). Fjalët me origjinë anglo-saksone përfshijnë grupe fjalësh që tregojnë pjesët e trupit, anëtarët e familjes, fenomenet natyrore dhe planetet, kafshët, cilësitë dhe vetitë. Megjithatë mes syresh ka fjalë të cilat sot janë të vjetëruara (lore, methinks, quoth, hight), poetike ose terma historike (thane, yeoman, stocks).

Në historinë e saj 15 shekujsh, të ruajtur në dorëshkrime, gjuha angleze lidhi kontakte të gjata dhe të ngushta me disa gjuhë të tjera kryesisht latinishten, frengjishten dhe skandinavishten. Fluksi i madh i huazimeve nga këto burime mund të shpjegohet me anë të disa shkaqeve historike: ndikimi i madh i qytetërimit romak bëri që latinishtja të përdorej për një kohë të gjatë në Angli si gjuha e besimit dhe e studimeve. Gjuha norvegjeze ishte e pushtuesve të cilët kishin të njejtin nivel zhvillimi social dhe kulturor dhe që u shkruanë lehtësisht me popullsinë vendase në shekullin e IX-të, X-të dhe gjysmën e parë të shekullit të XI-të.

Përhapja e ndikimit frëng nisi ngadalë dhe vazhdoi për shekuj me rradhë duke u shtrirë gjatë gjithë periudhës së Anglishtes së Mesme. Gjatë këtij procesi huazimi, dallohen dy faza, të ndara prej vitit 1250. Ndryshe nga huazimet e këtij viti, ato të dy shekujve janë më të paktë në numër, përqëndrohen në dallimet fonologjike ndërmjet anglishtes dhe normandishtes si edhe ndryshojnë rrethanat e huazimit. 900 huazimet që hynë para vitit 1250 janë fjalë që mund të mësonte shtresa e ulët e popullsisë si baron, noble, dame, servant, mistrel, messenger. Fjalë të tjera si story, rime, lay depërtuan përmes letërsisë. Fjalë që hynë më shpejt kishin lidhje me fenë dhe kishën si priest, deacon, pray.

Pas vitit 1250, po shkonte drejt përdorimit të gjuhës angleze në vend të asaj frënge. Fjalët frënge nisën të përdoren kur mungonte fjala në gjuhën angleze, ose kur përdoruesi e kishte më lehtë të përdorte një fjalë me të cilën ishte mësuar. Klasa e lartë futi në gjuhën angleze një numër të madh fjalësh frënge të fjalorit administrative, fetar, ligjor, ushtarak, si edhe fjalorit të modës, ushqimit, aktivitetit shoqëror, artit dhe mjekësisë. Pas asimilimit fonetik, afro 10 000 fjalët frënge të huazuara në anglishten e periudhës së Rilindjes u bënë pjesë e fjalorit anglez dhe sot 75 % e tyre përdoren ende.

Kur fjala huazohet në një gjuhë tjetër, struktura semantike u nënshtrohet ndryshimeve. Një karakteristikë e përbashkët e të gjitha gjuhëve është përkueshmëria. Elementët e huaj hedhin rrënjë aq thellë sa që nuk arrijmë t'i dallojmë. Huazimet në gjuhën angleze nga shumë gjuhë të tjera e veçanërisht nga gjuha frënge, dëshmojnë se sa të fuqishëm janë faktorët jashtëgjuhësorë si kontaktet kulturore, ekonomike, tregëtare, luftrat e pushtimet ndërmjet vendeve. Në shekullin e XXI, në shoqërinë e hapur ku jetojmë, në "ethet" e globalizimit, në teknologjinë marramendëse, në industrinë e argëtimit, duket se gjuha angleze po u kthen haraçin të gjitha gjuhëve të tjera. Ndikimi i anglishtes po ndryshon sot fjalorin pse jo dhe kulturën e shumë gjuhëve. Ashtu si të gjitha gjuhët e botës, edhe ajo shqipe nuk mund të mos prekej dhe pasurohej prej gjuhës dhe kulturës angleze.

Ndikimi dhe kontributi i elementit të huaj ndodh që të jetë vërtetë aq i madh sa të mund të konsiderohet akoma më domethënës në prurje fjalësh se sa ai autokton. Më pas janë pikërisht rregullat dhe ligjësitë fonetike dhe gramatikore të gjuhës pritëse ato të cilat i përpunojnë dhe i përshtasin në gjuhë. Në ditët tona kanë mbërritur shumë pak fjalë kelte, pra fjalë që përbëjnë grupin e njërive leksikore që lidhen me leksikun amtar (autokton). Në gjuhën angleze burimi më i furishëm i pasurimit të fjalorit ka qënë grupi i njesive leksikore të huazuara nga gjuhët e tjera, sidomos atë, latine, frënge, greke, skandinave, italiane etj.

Sipas Stefanllari I. (2011) fjalët e prejardhura përbëjnë grupin më të madh të fjalëve në gjuhën angleze, përkatësisht emrat e prejardhur 67%, mbiemrat 86 %, emrat e përbërë 15 % dhe mbiemrat 4% Fjalët rrënjë zënë 18% në emrat dhe 12% në mbiemrat. Fjalët rrënjë përbëjnë themelin e fjalorit dhe të fjalëve të prejardhura e të përbëra si edhe kanë rëndësi të madhe në të folur⁵⁰. Karakteristikë tjetër e fjalorit të anglishtes është edhe polisemia, për shkak të karakterit monosilabik të anglishtes si dhe predominimit të fjalëve rrënjë (Stefanllari I.:55). Sa më e madhe të jetë frekuenca e fjalës, aq më i madh është numri i elementëve që e përbëjnë strukturën e saj semantike, që do të thotë aq më shumë polisemantike është

⁵⁰ Stefanllari, I. a Course in english lexicology, geer, Tiranë 2011 F20-21 e 79-90

Leksiku i anglishtes eshte i përbëre nga fjalë me origjinë vendase (Anglo-Saksone), fjalë me origjinë Indo-Europiane, fjalë me origjinë gjermane, fjalë angleze. Si burim për fjalorin e saj të ditëve të sotme shërbejnë mbi 120 gjuhë, kryesisht latine, skandinave, franceze, si edhe kelte, hollandeze, italiane, spanjolle, gjermane, orientale, ruse etj. Asimilimi i huazimeve nga gjuha përfshin, asimilimin fonetik, gramatikor, leksikor duke ju përshtatur rregullave të gjuhës së synuar ose pritëse. (Stefanllari I.) & Barber Ch. (2009)⁵¹. Sipas Barber sistemi leksikor bën pjesë në mbretërinë e kuptimit. Fjalët kanë tendencën të formojnë vargje ku kuptimi i një fjale varet nga fjalët në të gjithë vargun. Pra morfologjia fjalëformuese nuk mund të studiohet me vete dhe ne menyre te ndare nga semantika. Barber liston nje numer kriteresh sic janë: varësia semantike, kufizimet në përdorim, vargu semantik, modeli semantik , trajta fonetike, tipi morfologjik, dhe theksi.

2.5.2 Burimet e fjaleve te reja

Nga greqishtja: academia, academy, acoustics, aesthetics, amnesia, analog, analysis, analytic, anatomy, angel, anonymous, antagonis, antarctica, anthropology, Armageddon, atmosphere, atom, autocracy, autograph, barbarian, bible, biology, butter, calligraphy, cannabis, catapult, catastrophe, category, catharsis, chamomile, character, chord, Christ, chronology, clergy, cleric, clerk, climate, climax, comedy, philology, philosophy, phobia, phonograph, phonology, photograph, photography etj.

Nga rusishtja: Bolshevik, apparatchik, borscht, czar, icon, vodka, duma, troika, caracul, pereistroika, glasnost,

Nga gjuha arabe: Bedouin, emir, jakir, gazelle, harem, lute, hashish, minaret, mosque, myrrh, salaam, sirocco, sultan, bazaar, caravan.

Nga gjermanishtja: Rucksack, zeppelin, zither bum, feldspar, quartz, hex, lager, loafer, beer, stein, poodle, schuss, spritz, kindergarten, U-boat, delicatessen, hamburger, wiener, Oktoberfest, pinochle, pumpernickel, strudel, hausfrau, noodle etj.

Nga gjuha italiane: Bastion, caprice, charlatan, design, frigate, grotto, piazza, portico, stanza, violin, volcano, vendeta, cappuccino, espresso, linguini, mafioso, pasta, pizza, ravioli, spaghetti, spumante, zabaglione, zucchini.

Nga gjuha spanjolle: tornado, apricot, cannibal, embargo, desperado, alligator, armada, alpaca, guitar, mesa, mosquito, corral, mustang, marijuana, enchilada, bravado, ranch etj.

Nga gjuhet afrikane: banana, banjo, boogie-woogie, chigger, myrrh, gorilla, jitters, juke, voodoo, yam, zebra, zombie, goober, jazz etj.

Nga gjuha daneze: avast, boom, bow, commodore, dock, cruise, keel, leak, skipper, sloop, sketch, holster, cookie, booze, etching, spool, yach, bale, cambric, landscape, mart, nap, stripe, easel, beleaguer, selvage, stripe, furlough, crullers, cranberry, coleslaw, pump, onslaught etj.

Nga gjuha izraelite: Bagel, dreidel, lox, oy vey, schnook, schlep, gefilte, fish, goy, kosher, lox, pastrami, matzoh, spiel, klutz, kibitzer.

⁵¹ Charles Barber, Joan C. Beal & Philip A. Show The English Language a historical Introduction © Cambridge University Press 2009 f f 35-37

KREU III VËSHTRIM PANORAMIK NË LEKSIKUN E GJUHËS SHQIPE

3.1 Veçori të leksikut të shqipes

Gjuha shqipe ka tërhequr prej kohësh vëmendjen e gjuhëtarëve dhe të studiuesve të ndryshëm. I pari që vërtetoi bindshëm përkatësinë e saj në familjen e gjuhëve indoevropiane, ishte gjuhëtari gjerman F. Bopp, që arriti në përfundimin se shqipja i përket familjes indoevropiane, duke qenë se “në elementet e saj themelore nuk ka ndonjë lidhje më të ngushtë ose, aq më pak, ndonjë lidhje derivacioni me asnjërën nga gjuhët motra sanskrite (indoevropiane) të kontinentit tonë”.⁵²

Karakteri indoeuropian i gjuhës shqipe shfaqet në të gjitha nënsistemet e saj: në fjalor, në sistemin fonetik dhe në strukturën gramatikore. Por këtu është rasti të bëhet një vërejtje paraprake. Kur flasim për karakterin indoeuropian të gjuhës shqipe, kemi parasysh tiparet thelbësore, që ajo ka trashëguar nga një fazë e hershme indoevropiane. Natyrisht, këto tipare nuk kanë mbetur krejt të pandryshuara, ashtu siç kanë qenë mijëra vjet më parë. Ato i janë nënshtruar një ndryshimi e zhvillimi të ngadalshëm e shkallë-shkallë, gjersa kanë arritur në gjendjen e tyre të sotme. Gjuha shqipe, ashtu si të gjithë gjuhët e tjera simotra, gjatë këtij ndryshimi e zhvillimi historik ka ruajtur disa tipare thelbësore të trashëguara nga një fazë e hershme indoevropiane, ka humbur disa të tilla, dhe ka zhvilluar disa tipare e elemente të reja. Elementet e trashëguara dhe risitë në të gjitha nënsistemet janë shkrirë duke plotësuar njëri-tjetrin dhe duke formuar kështu një të tërë organike.

3.1.1 Shtresa e leksikut të gjuhës shqipe

Në shtresën vetjake të leksikut të një gjuhe, për rrjedhojë dhe në atë të gjuhës shqipe dallojmë dy nëngrupe të qenësishme fjalësh:

a. **Fjalë të burimit të hershëm indoeuropian:** atë, bir, i butë, çel, dal, darkë, dem, derr, djathë, djeg, dorë, drekë, dhjamë, elb, emër, ëndërr, gjarpër, gji, hudhër, kohë, i lig, lopë, mal, mbush, mjegull, mjekër, mot, motër, natë, pelë, punë, qaj, shteg, veri, i vogël, zë-ri, zog e shumë të tjera. Këto fjalë janë shumë më të lashta se huazimet që kanë hyrë nga greqishtja e nga latinishtja.

Në “Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe” (1891) Gustav Majeri, nga 5140 fjalë, 400 i nxori si të burimit të vjetër indoeuropian, 730 fjalë i la të pazbërthya, kurse të tjerat i cilësoi si huazime nga greqishtja, nga latinishtja, nga turqishtja etj. Gustav Majeri prej këtej doli në një përfundim të gabuar: e quajti gjuhën shqipe “të përzier, gjysmëromane”. Ai u mbështet në një krahasim numrash, duke lënë mënjanë cilësinë e fjalëve. Veç kësaj, nuk shqyrtoi vetëm elementin leksikor të përbashkët të shqipes, por u mbështet edhe në të folme me ndikime të theksuara nga gjuhë të tjera. Pastaj, nga 730 fjalë që Gustav Majeri i la pa shpjegim, më pas u vërtetua se shumë prej tyre janë të shtresës së trashëguar indoevropiane.⁵³

⁵² E. Çabej, «Hyrje në historinë e gjuhës shqipe», në Studime gjuhësore, III, Prishtinë, 1976, f. 13

⁵³ Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2008, f 321

Shtresa e lashtë indoeuropiane përbën bërthamën e leksikut të shqipes. Fjalët e kësaj shtrese kanë disa tipare: janë më të qëndrueshmet; kanë struktura të gjera kuptimore; kanë mundësi të mëdha fjalëformuese; janë shtrirje e denduri të madhe përdorimi.

b. Në grupin e dytë të madh të shtresës vetiake e përbëjnë fjalët parme të vetë gjuhës si dhe fjalët e formuara me prejardhje, me përbërje, me përngjitje, me parnyjëzim si dhe me konversion, duke përdorur brumin vëndës, si: *atëror, bërje, dimarak, dimëror, gardhoj, keqbërës, mirësi, nëpunës, i papunë, punëdhënës, punëtor, punishte, punoj, ujkonjë, zemërmirë* etj.

Për të dalluar fjalët e vjetra indoeuropiane nga formimet më të vona, përsëri na ndihmon krahasimi me gjuhë të tjera. Më të reja janë në radhë të parë fjalët e formuara nga pasthirrmat ose nga onomatopetë: *belbëzoj, bubullin, çangë, çuçurit, çukit, çurkë, dërdëllit, fërfëllon, fëshfërit, gllënkë, guguçe, gurgullon, hingëllin, hukat, kakarit, mjaullit, rruftit, rraketake, rrapëllin, shushurin, taketuke, tringëllin, turfullon, vringëllin, zukat, zhuzhin* etj.

Gjuha shqipe e shkruar tashmë ka hyrë në shekullin e gjashtë të jetës së saj të dokumentuar. Sipas gjuhëtarit A.Kostallari në qoftë se këtë proces të pandërprerë zhvillimi do ta vështronim si “histori e gjuhës letrare shqipe”, atëherë atë do ta ndanim në dy periudha të mëdha – në periudhën parakombëtare, e cila përfshin shekujt XVI-XVIII dhe fillimin e shekullit XIX, dhe në atë kombëtare që nis në gjysmën e parë të shekullit të XIX e arrin deri në ditët tona. Secila nga këto dy periudha dallohet nga një varg veçorish që janë përcaktuar nga faktorë jashtëgjuhësorë dhe gjuhësorë.

Një nga tiparet themelore të shqipes së periudhës parakombëtare është copëzimi i madh i bazës dialektore të gjuhës së shkrimit dhe funksionimi paralel i disa varianteve letrare të tipit njëkrahinor a disakrahinor; shkalla e ulët e normalizimit, për të mos thënë gati përputhja e strukturës fonetiko-gramatikore e leksikore të varianteve letrare me strukturën e të folmeve e nëndialekteve përkatëse; realizimi shumë i kufizuar i mundësive potenciale të gjuhës shqipe në strukturën dhe funksionet e gjuhës letrare, sidomos në është për tu theksuar shkalla e ulët e realizimit të mundësive potenciale në lëmin e formimit të fjalëve dhe largesa e theksuar midis pasurisë së madhe leksikore-frazeologjike të gjuhës popullore dhe fondit leksikor-frazeologjik të kufizuar të asaj të shkrimit; mospërdorimi i shqipes së shkruar si gjuhë shtetërore zyrtare si dhe zhvillimi i saj në kushtet e përndjekjeve të egra politike e fetare; mungesa e diferencimit të stileve funksionale; diferenca e madhe midis nivelit të përpunimit të gjuhës sonë letrare dhe nivelit të gjuhëve letrare më tradita shumë të lashta; kontaktet dhe marrëdhëniet sporadike të njëanshme e shpeshherë të pazhvilluara midis shqipes e gjuhëve të tjera me të cilat shqipja kishte kontakt. Këto tipare i gjejmë të pasqyruara në vepra të asaj periudhe si në veprat e Nezim Beratit, Sulejman Naibit, Hasan Zyko Kamberit, Muhamet Kyçyikut, në veprën “Cuneus Prophetarum” të P. Bogdanit, dhe të “Dhiata e re” e V. Meksit.⁵⁴

Periudha kombëtare e shqipes karakterizohet nga një varg tiparesh të rëndësishme, tek të cilat gjejmë shprehjen e vet ndyshimet thelbësore të saj në dallim nga gjuha e periudhës parakombëtare dhe zhvillimi i madh i saj me vlera historike. Së pari, një tipar i rëndësishëm për tu theksuar është përqëndrimi i bazës dialektore rreth dy boshteve kryesore, duke thyer kufinj të ngushtë

⁵⁴ Kostallari, A. Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë, f.8, Tiranë.

njëkrahinor, dhe thjeshtimi i varianteve letrare; së dyti, shkalla gjithnjë e më e lartë e normalizimit e ritmet gjithmonë e më të shpejta të tij, që janë përcaktuar nga kushtet e tjera ekonomiko-shoqërore, politike e kulturore të periudhës kombëtare; vendosja e një simetrie gjithnjë e më të plotë në gjithë sistemin e gjuhës letrare e në nënsistemet e tij; realizimi i gjerë, i thellë e i shpejtë i të gjitha mundësive potenciale të gjuhës shqipe në strukturën dhe në funksionet e gjuhës letrare kombëtare; gjallërimi i jashtëzakonshëm i produktivitetit fjalëformues, zgjerimi i vargjeve të fjalëformimit, si dhe rritja cilësore e pasurisë leksikore-frazeologjike; diferencimi dhe përvijimi gjithnjë e më i qartë i stileve funksionale. Këto tipare filluan të dallohen që në gjysmën e dytë të shekullit të XIX kur mund të thuhet se ndodhi dhe kapërcimi cilësor i shqipes nga periudha parakombëtare në atë kombëtare⁵⁵.

3.1.2 Karakteri sistemor i gjuhës shqipe

Sipas gjuhëtarit J. Thomai, shqipja standarte ka fituar tipare të dallueshme edhe në fushën e leksikut, të frazologjisë e të formimit të fjalëve.

1. Tipar themelor është veprimi pasurues i barabartë i të dy dialekteve në leksikun e saj⁵⁶. Ky veprim pasurues i pakufizuar mbështetet në përbashkësinë a afrinë leksikore që kanë të dy dialektet e gjuhës shqipe. Megjithatë, leksiku i shqipes standarte nuk mund të konsiderohet si përfetëse e bashkëveprimit dialektor, as leksik i krijuar në dhjetëvjeçarët e fundit a në shekullin tonë. Ai përmban si elemente nga më të lashtat e shqipes, ashtu elemente nga më të rejat, si fjalë të gjuhës së përbashkët, ashtu edhe fjalë me burim dialektor a krahinor. Studiuesi J. Thomai bën një shtresim të leksikut nga pikëpamja e formimit të normës dhe e përgjithësimin në përdorim. Kështu, shtresa kryesore e leksikut të shqipes bashkëkohore e përbëjnë fjalët dhe shprehjet që i takojnë gjithë truallit gjuhësor të shqipes, të cilat nuk mund të konsiderohen më si të këtij apo atij dialekti. Të tilla janë fjalë e shprehje që emërtojnë sendet që na rrethojnë, cilësitë, veprimet, lidhjet, të cilat janë të përbashkëta për të dy dialektet: diell, dorë, njeri, njoh, një etj. Shtresa e dytë përbëhet nga fjalë e shprehje të formuara brenda për brenda shqipes ose janë huazuar nga gjuhë të tjera. Shtresën e tretë të leksikut të shqipes standarte e përbëjnë ato fjalë e shprehje që i kapërcejnë kufijtë e dialekteve e të folmeve dhe ngrihen në normë. Kjo është shtresa që formohet nga veprimi pasurues i dialekteve në leksikun e gjuhës standarte.

2. Një tjetër tipar i leksikut të shqipes bashkëkohore është prirja për pastrimin nga fjalët e huaja. Kjo gjë nuk çon në ngushtimin e vëllimit të leksikut por në të kundërt, kjo prirje çon në zgjerimin e leksikut të shqipes standarte. Kështu, kjo prirje ka bërë të mundur lënien jashtë të shumë fjalëve të burimit turk, grek e sllav, të cilat para disa pesë apo gjashtë dekadash ishin të zakonata, si p.sh: birinxhi, derdimen, dynja, vatan, katran, duke kryer një pastrim të gjerë në terminologjinë e fushave të ndryshme.

Gjuhëtari J. Thomai thekson edhe faktin se leksiku i shqipes standarte shquhet edhe për begatinë e mjeteve shprehëse dhe emocionuese, të cilat i japin ligjërimin shkathtësi e force të veçantë dhe zhvillojnë më tej sistemin e stileve funksionale. Shprehje e kësaj begatie janë letërsia artistike origjinale dhe e përkthyer, publicistika e folur dhe e shkruar, ligjërimi bisedor letrar në situatë të ndryshme etj.

⁵⁵ Kostallari, A. Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë, f 9, Tiranë.

⁵⁶ Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f 280-281.

3.2 Veçori të strukturës fjalëformuese të shqipes

Nga pikëpamja e strukturës fjalëformuese gjuhëtari Androkli Kostallari, mendon se veçoria themelore apo që mund të quhet “normë fjalëformuese” e përgjithshme e shqipes së sotme letrare është mbizotërimi i theksuar i sufiksimit dhe i kompozimit⁵⁷; këto mënyra fjalëformuese me krijimin e njësisve leksikore-semanticke kompakte ndikojnë për forcimin e prirjeve sintetike dhe në strukturën gramatikore⁵⁸. Gjithashtu, sipas Kostallarit, edhe formimi i tipit parashtesor e sidomos ai parashteso-prapashtesor mbi bazën e lidhjeve të qëndrueshme të tipit parafjalë + emër është gjallëruar shumë. Duket qartazi prirja e gjuhës shqipe për të vetplotësuar kërkesat gjithmonë e në rritje që ushtron zhvillimi i shpejtë i shoqërisë përmes proceseve të ndryshme fjalëformuese të shqipes së sotme letrare. Vihen re ritmet e shpejta të pasurimit të leksikut të shqipes nëpërmjet prejardhjes e kompozimit.

Një tjetër veçori themelore e sistemit fjalëformues të shqipes së sotme letrare është zgjerimi i dukshëm i prirjes për një veprim të ndërlidhur e të ndërvarur të mënyrave e të tipave të ndryshme, ps.sh.gjallërimin e njëkohshëm të formimeve të emrave të vepruesit e të mbiemrave foljorë me temën e pjesores –ue (-lexues dhe i lexueshëm), rritjen e njëkohshme të produktivitetit të mbiemrave të përbërë pronësorë e të emrave abstraktë që formohen mbi bazën e tyre me prapashtesa (shpirtngushtë-si etj.).⁵⁹

Veçori të tilla janë tregues të qëndrueshmërisë gjithmonë në rritje të karakterit sistemor të fjalëformimit të shqipes së sotme letrare.

3.3 Veçori të strukturës leksikore të shqipes

Nga pikëpamja e strukturës leksikore, gjuha e sotme shqipe ndërtohet mbi një bazë tepër të gjerë leksikore, bërthamën e së cilës e përbëjnë fjalët e truallit gjuhësor të shqipes, sidomos fjalët e fondit themelor të saj si p.sh. fjalë që shprehin nocione themelore si: ata, ato, ky, kjo, atdhe, i atillë, e atillë, e këtillë, bagëti, blej, bar, baltë, bark, barrë, brinjë, brisk, buall, burrë, dëm dëboj, dëshirë, dal, dallandyshe, dasmë, dardhë, dhallë, gjel, gjedhë, përralë, i vogël, z bath i varfër, i verdhë, zbërthej, zog etj. Struktura leksikore e shqipes është e hapur për të gjitha ato njësi qe i sjellin asaj mundësi të reja të shprehjes së nocioneve e të ngjyrimeve më të holla semanticke e stilistikore-shprehëse. Madje kjo strukturë priret të pasurohet jo vetëm përmes dialekteve që përfshihen në truallin e shtetit të sotëm shqiptar, por edhe nëndialekteve jashtë këtij trualli, të cilat ruajnë vlera kulturore-gjuhësore që i shërbejnë së sotmes, si psh fjalë të arbëreshëve të Italisë dhe Greqisë të pranuara në fjalorin gjuhës shqipe. Keshtu në fjalorin e gjuhës shqipe janë përfshirë mjaft fjalë të përdorura nga shkrimtarët arbëreshë⁶⁰. Kjo veçori i ka dhënë e po i jep

⁵⁷ Kostallari, A. Mbi disa vecori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë, f 38, Tiranë.

⁵⁸ Kostallari, A. Mbi disa vecori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë, f 38, Tiranë.

⁵⁹ Kostallari, A. Mbi disa vecori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë, f 38-39, Tiranë.

⁶⁰ Kostallari, A. “Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit te gjuhës së sotme shqipe”, “Studime filologjike”, 1986, 2 f 61-62.

leksikut të gjuhës së sotme shqipe tiparet e një koineje leksikore gjithëshqiptare, në të cilën njësitë leksikore, pavarësisht nga burimi i tyre, kanë hyrë në marrëdhënie sistemore semantike e stilistikore.

Për më tepër, në leksikun dhe fjalëformimin e gjuhës shqipe, duket qartë prirja për pastërtinë e gjuhës, për një bashkërendim të harmonishën ndërmjet ruajtjes së tabanit kombëtar dhe pasurimit të leksikut si gjuhë e një kulture të lartë, të letërsisë artistike, të shkencës e të teknikës, që si e tillë është në marrëdhënie të zhvilluara me gjuhët më të përpunuara të botës.

Deri më tani rrugën e formimit të gjuhës letrare shqipe mund ta paraqesim me tri etapa themelore duke u nisur nga dialektet dhe trashëgimi gjuhësor letrar i së kaluarës parakombëtare. Së dyti, zhvillimet e reja letrare të varianteve letrare dialektore përbëjnë atë që quhet linjë e dytë e formimit të gjuhës letrare. Linja e tretë përfaqëson prerjen e sotme të shqipes letrare në fazën e kristalizimit përfundimtar.

Edhe pse shqipja është gjuhë indoeuropiane, nuk duhet kuptuar që gjithë pasuria e saj leksikore është trashëgimi e fondit të vjetër indoeuropian. Në rrjedhën e kohës marrëdhëniet me popujt e tjerë, krahas të tjerave, kanë patur edhe ndikime në gjuhë. Historia e gjuhës shqipe si edhe etimologjia e shqipes bën një ndarje në ndërmjet elementëve të huazuar nga ato vendase, vetjake.

Kështu, në gjuhën shqipe krahas një fjale tjetër është pranuar fjala e huaj: a) kur ka qenë një term ndërkombëtar, b) kur ka sjellë një nuancë kuptimi më të përpiktë e të vecantë, c) kur e ka kërkuar një stil i caktuar i gjuhës, d) edhe për shkak të prirjes së disa të folmeve profesionale, për të qenë “sa më të përgjithshme, sa më ndërkombëtare”. Kjo gjë vërehet në leksikun e fushave të artit, të modelistëve, të biznesit, të financave, të informatikës, të turizmit etj dhe lidhet me fushën, por edhe me kulturën e atyre që i përdorin fjalët e huaja.

Duhet pranuar që gjate dy dekadave të fundit kontakti i botës shqiptare me atë angleze e amerikane ka qenë tejet i zhvilluar në sfera të larmishme si: shkencë, ekonomi, politikë, kulturë etj. Ky ndikim është vënë re edhe në gjuhën shqipe më së shumti në leksik dhe në sintaksë. Për pasojë, gjuha shqipe vazhdon të pasurohet duke krijuar fjalë të reja, me brumin dhe mjetet fjalëformuese të saj; nëpërmjet marrjes së fjalëve nga dialektet a të folmet territoriale e sociale dhe ngritjes së tyre në normë duke u bërë pjesë e leksikut standart; nëpërmjet huazimit, sidomos kur fjalët janë huzime historike, kulturore etj. dhe jo huazime gjuhësore.⁶¹

Gjuha shqipe është e hapur ndaj gjuhëve të huaja e sidomos ndaj gjuhës angleze si një gjuhë botërore tashmë e folur prej më shumë se 1.2 miliard njerëz. Fusha të ndryshme të shkencës si financa, biznesi, informatika, artet por edhe sporti kanë prurë në gjuhë emërtime të reja duke shoqëruar konceptet që ato shprehin. Kështu në gjuhën shqipe këto dekadat e fundit kanë hyrë mijëra fjalë prej të cilave duhet pranuar që mund të përfitohen vlera stilistikore, shprehëse e shënuese. Gjithashtu, shume fjalë e terma të huazuara nga anglishtja apo fjalë të tjera kanë mbushur zbrazetinë e leksikut të shqipes. Por ka edhe syresh të cilat përbëjnë kërcënim serioz duke mos sjellë asnjë nga vlerat e lartpërmendura, por thjesht zënë një vend përdorimi në situatë të caktuara duke mënjanuar fjalët shqipe. Gjuhëtari J. Thomai shprehet se huazimet nga

⁶¹ E. Lafe, “Shqipja standarte në vështrim strukturor dhe funksional, Konferenca shkencore “Shqipja standarte dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë, 2003, f.249.

anglishtja apo gjuhë të tjera kanë vlerën e vet pasuruese, por, nëse bëhet pa kurrfarë kontrolli e pengese kthehet në një dukuri të dëmshme për gjuhën tonë, sidomos kur mbushet me fjalë të huaja ligjërimi i folur ose shtresa leksikore e përdorimit të përgjithshëm.⁶² Mirëpo, është detyrë e shkrimtarëve, e gazetarëve, e veprimtarëve politikë e shoqërorë, e njerëzve të kulturës e të artit, e shkencëtarëve për pastrimin e pasurimin e gjuhës standarte shqipe përmes zëvendësimit të fjalëve të huaja me ato shqipe.

Sipas studiuesit J. Thomai huazimet më të hershme në gjuhën shqipe janë fjalët *me burim nga greqishtja e vjetër*. Huazime të tilla si për shkaqe gjeografike depërtuan në gjuhën shqipe që nga shekulli I VII para epokës së re, kur kolonë grekë erdhën dhe u vendosën në trojet ilire. Huazimet greke përgjithësisht u përkasin fushave shoqërore, bujqësisë etj. si p.sh. mokër, pjepër, presh, qershi, mokër etj.⁶³ Ndërsa huazimet greke të kohës së re dhe bizatine kanë hyrë sidomos në jetën shoqërore, artizanat, në botën shtëpiake, në kopshtari etj.: avlli, fis, lajm, flamur, oreks, i pastër, trastë, trëndafil, etj.

Leksiku i shqipes është pasuruar edhe përmes *huazimeve latine e romane gjatë* shekujve të parë të erës sonë, sikundër zgjati edhe pushtimi romak në Shqipëri rreth 500 vite. Ky huazim ka qenë tepër i ndjeshëm në gjuhën shqipe por shqipja nuk arriti të asimilohej duke i bërë ballë ndikimit prej saj. Kështu gjendet ndikimi latin prej gjuhëve frënge dhe italiane në fushën e tregtisë, të lundrimit, të luftës, etj. si p.sh.: bankë, barkë, fitoj, karrocë, kushton, marinar, paguaj, timon, trumbetë, vapor, velë; nga frengjishtja sjellim fjalët që i përkasin fushës administrative, juridike, shoqërore e politike si p.sh.: ambasadë, barrikadë, bluzë, plazh, grevë, kamion, masazh, pallto, parashutë, ekip, etapë, shofer, shovinizëm, pudër, prizë, pardesy, triko, turne. etj. Huazimet frënge, përgjithësisht, bëjnë pjesë në leksikun profesional e terminologjik dhe mjaft prej tyre kanë karakter ndërkombëtar.

Në leksikun e gjuhës shqipe hasen edhe fjalë të burimit sllav (te depërtuara përmes serbishtes dhe bullgarishtes), të cilat kanë mundur të depërtojnë gjatë periudhës së Mesjetës. Huazime slave gjejmë në fushën e bujqësisë e blegtorisë, zejtarisë etj. si p.sh. çekiç, çudit, kyç, kockë, kovaç, kovë, krahinë, fllad, gostit, gozhdë, grabit, grusht, mace, memec, mërzit, neverit, oborr, patë, porosit, prag, prashit, pushkë, strehë, trup, etj. Nga gjuha slave kanë ardhur edhe disa toponime, emra lumenjsh, perrenjsh, fshatrash, etj. si p.sh.: Bistricë, Bogovë, Çorrovodë, Pogradec, Goricë, huazime të cilat i përkasin periudhës së para shekullit të XV. Ndikimi sllav mbi gjuhën shqipe tashmë është pothuajse i ndërprerë.

Gjithashtu, ndikimi turk, i cili nisi që nga shekulli i XV, mbetet i padiskutueshëm në leksikun e shqipes për shkaqe historike më se të ditura. Gjurmët e pushtimit osman pesë shekullor në trojet shqiptare sigurisht që janë reflektuar edhe në gjuhë. Turqishtja u ndje më së shumti në fushën e urbanizimit, administratë, kuzhinë, veshje etj. Më të hershmet kanë qenë huazimet leksikore në fushën e luftës e veshmbathje si p.sh.: çorape, çarçaf, daulle, dyfek, fitil, sënduk, top, hendek, baba, bilbil, fodull, tepsi, xhezve, xhep, sahat, raki, perde, hakë etj. Sipas gjuhëtarit J. Thomai shumë huazime turke janë asimiluar plotësisht nga gjuha shqipe dhe janë bërë pjesë e saj. Përmes turqishtes kanë depërtuar edhe fjalë arabe ose persiane, por gjuhë huazuese për shqipen edhe e

⁶² Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f 262.

⁶³ Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f 257

këtyre fjalëve ka qenë turqishtja. Megjithatë, shqipja me gjithë huazimet e shumta, ka ruajtur originalitetin e saj, si gjuhë e veçantë indoevropiane.

KREU 4 RRUGËT KRYESORE TË PASURIMIT TË LEKSİKUT NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE

4.1 Fjalëformimi dhe mënyrat e tij

4.1.1 Gjuha dhe ndryshimi gjuhësor

Në përpjekje për të përmbledhur në një formulim të vetëm raportin që ekziston midis njerëzve dhe gjuhës, shkencëtari dhe filozofi i njohur Umberto Eco shprehet se “njerëzit janë fakte gjuhësore”. Përmes këtij formulimi arrijmë të veçojmë faktin e lindjes së gjuhës si nevojë e domosdoshme në procesin e shoqërizimit të njeriut si dhe rolin e gjuhës në shndërrimin e njeriut.⁶⁴ Gjuha shfaqet kështu si një rregullator i marrëdhënieve shoqërore dhe si një mjet për formimin kompleks të njeriut të sotëm.

Një tjetër fakt i pamohueshëm është dhe ndryshimi e zhvillimi i pandërprerë që pësojnë të tëra gjuhët në hapësirë dhe në kohë. Pra, gjuha na shfaqet kështu një mjet komunikimi, i cili garanton qëndrueshmëri në të gjitha situatat komunikuese në mënyrë të tillë që folësi nuk e vë re zhvillimin e saj përgjatë kohës. Dukuria e evolucionit gjuhësor është mjaft e variueshme. Kjo variueshmëri përshkruhet sipas tri këndvështrimeve që janë: shpejtësia e ndryshimit; shkalla e vetëdijes së folësve për ndryshimin gjuhësor; si dhe mënyra se si këto ndryshime prekin gjuhën.

Gjuhëtarët diskutojnë për faktorë të brendshëm si ai morfologjik e leksikologjik e të jashtëm ku përfshihen ndikimet prej kontakteve të gjuhëve si dhe ndryshimet shoqërore, të cilët ndikojnë drejtpërdrejt në evoluimin e gjuhës.

E parë në kuadrin leksikologjik e morfologjik, gjuha e cila ndodhet në një proces të pandërprerë zhvillimi, shndërrohet dhe zhvillohet në mënyrë të pandërprerë duke pasqyruar ndryshimet në veprimtarinë shoqërore, politike, ekonomike, kulturore dhe shkencore të vetë shoqërisë që e flet atë.

Këto ndryshime dhe evoluime, pasqyrimin e tyre të drejtpërdrejtë dhe të shpejtë e gjejnë veçanërisht në leksikun e gjuhës. Gjuhëtari J. Thomai njih tri procese zhvillimi në leksikun e gjuhës letrare :a) krijimi i fjalëve të reja me brumin e gjuhës amtare dhe hyrja e fjalëve të reja nga gjuhë të tjera, b) dalja jashtë përdorimit të fjalëve të vjetëruara a huazime të panevojshme dhe c)ndryshim në përmbajtje e në formë të fjalëve të njohura, duke zgjeruar strukturën kuptimore me kuptime të reja e më rrallë duke humbur ndonjë kuptim të vjetëruar. Procesi i parë është më i shpejtë, prandaj leksiku i gjuhës letrare vjen gjithnjë duke u zgjeruar e duke u pasuruar, krahas zhvillimit të shoqërisë, kulturës e të mendimit.

Edhe dalja e fjalëve jashtë leksikut të gjuhës nuk realizohet menjëherë. Faza e parë është kalimi i këtyre fjalëve në shtresën pasive dhe kjo ngushton përdorimin e tyre, duke i kthyer në fjalë të vjetëruara.⁶⁵ Kështu, ndryshimet në leksikun e një gjuhe janë ndodhin në dy kahe. Nga njëra anë ai zgjerohet përmes njësisive të reja leksikore, por nga ana tjetër kemi daljen jashtë përdorimit të

⁶⁴ Sh. Rrokaj, Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme, Tiranë, 2007, f. 11

⁶⁵ J. Thomai “Leksikologjia e gjuhës shqipe”, Tiranë, 1974, f.15-16.

fjalëve të vjetra si arkaizmat, historizmat etj., të cilat sigurisht që janë më të pakta në numër nga njësitë hyrëse.

Tre mënyrat kryesore të pasurimit të fjalorit apo leksikut të një gjuhe janë: fjalëformimi apo pasurimi morfologjik ku krijimi i fjalëve të reja kryhet përmes brumit të një gjuhe të caktuar dhe me mjetet fjalëformuese të asaj gjuhe; përmes procesit të huazimit të fjalëve nga një gjuhë të tjera, e së treti pasurimi semantik. Leksiku i gjuhës shqipe pasurohet së tepërmi përmes procesit fjalëformues e huazimit.

4.1.2 Fjalëformimi dhe mënyrat fjalëformuese

Një nga mënyrat më të rëndësishme të pasurimit të leksikut të një gjuhe është fjalëformimi. Proçesi i fjalëformimit të gjuhës shqipe ka qenë pjesë e studimeve jo vetëm e gjuhëtarëve shqiptar, por edhe e gjuhëtarëve të huaj, si p.sh. A. Kostallari, Sh. Demiraj, E. Hysa, J. Thomai, M. Çeliku, K. Cipo, S. Mansaku, Xh. Lloshi, M. Samara, etj por edhe të huaj. Keta gjuhëtarë kanë trajtuar një sërë problemesh të kësaj tematike si p.sh. formimi i fjalëve në gjuhën shqipe dhe paradigmat fjalëformuese, tipat dhe mënyrat fjalëformuese, koncepti për fjalën, rrugët kryesore të pasurimit të leksikut, e të tjera. Studimet e tyre janë bërë pjesë e hulumtimeve dhe kërkimit tonë shkencor në këtë punim, i cili në fokus të studimit ka proceset fjalëformuese, në rrafshin krahasues ndërmjet anglishtes e shqipes. Është bërë një përjasje krahasuese në modelet e formimit të fjalëve, sidomos në atë ndajshësor, parashtesor. Kemi analizuar faktin se sa e ndikueshme është teoria e relativizmit gjuhësor në dy gjuhët e marra në studim e si ndikon relativizmi gjuhësor pikërisht në formimet parashtesore në shqipe e anglishte.

Sipas gjuhëtarit J. Thomai “njohja e mjeteve fjalëformuese dhe e llojeve të tyre sipas vendit që zënë në lidhje me temën prodhuese (parashtesa, prapashtesa) lejon të kuptojmë ndërtimin e fjalës dhe të bëjmë zbërthimin e saj sipas pjesëve përbërëse”.⁶⁶

Nga literatura e huaj gjuhësore vijnë përkufizime dhe përcaktime thuajse të njëjta për objektin dhe detyrat e fjalëformimit. Kjo gjë duket qartë në përkufizimin që jep Ingo Plag në studimin e tij në lidhje me fjalëformimin në gjuhën angleze. “Fjalëformimi nga vetë fjala është formimi i fjalëve të reja në një gjuhë.”⁶⁷ Sipas Plag, çështja e fjalëformimit ngre edhe një hallkë tjetër për tu konsideruar, që është *inflection*, eptimi, të cilën ai e dallon nga prejardhja si proces i fjalëformimit. Në skemën më poshtë jepet kjo ndarje qartazi.

⁶⁶J. Thomai “Leksikologjia e gjuhës shqipe”, Tiranë, 1974, f.15-16, 17.

⁶⁷I.Plag “Wordformation in English”, Cambridge University Press, 2003, f 9.




Figure 1 - Fjaleformimi ne gjuhen angleze sipas I. Plag

Gjithashtu, Plag bën një përkufizim të asaj çka quhet fjalë në morfologji; bën një dallim të qartë midis morphemes së lirë free morpheme dhe asaj jo të lirë bound morpheme.(fjalë të parme e jo të parme). Në morfologjinë e gjuhës angleze gjejmë të shënuar përveç parashtesave (prefixes) dhe prapashtesave (suffixes), edhe termin affixes ku përfshihen të gjitha morfemat jo të lira, të cilat nuk qendrojnë dot vetëm, e që u paravendosen apo prapavendosen fjalëve të parme. Një vëmendje e veçantë i jepet edhe **bound roots, rrënjëve jo të lira të cilat lidhen vetëm me disa rrënjë të tjera** jo të lira zakonisht me origjinë latine si p.sh.: circul- (as in circulate, circulation(qarkulloj-qarkullim), circulatory,circular (qarkullues, qarkor)), approb- (si në approbate-miratoj, approbation-miratim, approbatory-miratues, approbator), simul- (si në stimulant-simulues, sajues, simulate, simulation), ndërsa rrënjë jo të parme (jo të lira) të me origjinë kombëtare mund të gjenden edhe si në rastin e hap-, si në hapless – i pafat).⁶⁸

Ashtu siç do ta shohim edhe në ndonjë gjuhëtar të gjuhës shqipe, Plag klasifikon me fjalën *root* rrënjë, të gjitha ato fjalë të parme të pandashme. Fjalëve të prejardhura ai u referohet si *derivate*.

Sipas studiuesit të gjuhës angleze Katamba, fjalët edhe pse konsiderohen si njësi më të vogla kuptimplotë të gjuhës, mund të ndahen në morfema, pjesë më të vogla, të cilat janë kuptimplotë ose kanë funksion gramatikor në një gjuhë. Këto pjesë më të vogla kanë kuptime apo funksione të qëndrueshme në mijëra fjalë jo vetëm në një.⁶⁹ Morfemat zotërojnë një kuptim ose funksion relativisht të qëndrueshëm ose të pranishëm në jo vetëm një, por disa mijëra fjalë. Gjuha angleze përmban një numër të madh mjetesh me të cilat kombinohen morfet ose ndryshohen për formuar

⁶⁸ I.Plag "Wordformation in English",Cambridge University Press, 2003,f 14.

⁶⁹ Katamba, F. 2005. English Words. Structure, history, usage. London: Routledge. F 15-44.

fjalë të reja. Megjithatë, vetëm dy nga këto procese të formimit të fjalëve siç është prejardhja dhe përbërja, janë përgjegjës për një numër të madh fjalësh të reja ⁷⁰.

“Gramatika e gjuhës shqipe” jep këtë përkufizim për mënyrën e fjalëformimit: “Mënyra është nënndarja më e madhe e sistemit të fjalëformimit. Sistemi i fjalëformimit përbëhet nga tërësia e mënyrave dhe tipave fjalëformues. Të gjitha fjalët e formuara me të njëjtin lloj formanti i takojnë një mënyre fjalëformimi.”⁷¹ Mënyra ndahet më tej në tipa fjalëformimi, sipas përkatësisë leksiko-gramatikore të temës a temave fjalëformuese dhe ndajshitesës që merr pjesë në fjalëformim.

Gjithashtu, në veprën “Gramatika e gjuhës shqipe” gjejmë fjalëformimin morfologjik të bazohet tek analogjia; temat dhe ndajshitesat fjalëformuese bashkohen për të formuar fjalë të reja në bazë të analogjisë me fjalët e tjera jo të parme që ekzistojnë tashmë në gjuhë. P.sh:

i ndershëm	i natyrshëm
Ndershmëri	Natyrshmëri

Në punimin e tij “*Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*” (Tiranë, 1962), gjuhëtari Sh. Demiraj trajton çështjen e mënyrave të fjalëformimit, mjeteve fjalëformuese, fjalës dhe pjesëve të saj. Demiraj ben klasifikimin e fjaleve në gjuhën shqipe: fjalë të para, të prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura.⁷² Tek fjalët e prejardhura ai përfshin vetëm formimet me parashtesë, prapashtesë dhe parashtesë e prapashtesë njëkohësisht. Si fjalë të prejardhura dallon emra, mbiemra, folje dhe ndajfolje. Në grupin e fjalëve të përbëra përfshin emra, mbiemra dhe pak folje. Përemrat e pacaktuar, ndajfoljet, disa numërorë, dhe parafjalë i konsideron si fjalë të përngjitura.⁷³

Gjuhëtari J. Thomai është i mendimit se gjatë procesit fjalëformues në gjuhën shqipe ndiqen dy linja fjalëformuese, linja morfologjike, dhe ajo semantike. Sipas tij linja morfologjike e cila nënkupton temën fjalëformuese dhe parashtesën, ben te mundur formimin e njësisë së re leksikore, zbulimin e mënyrave prodhimtare, dhe jo prodhimtare të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, me fjale të tjera, të ndërtohet sistemi fjalëformues i gjuhës shqipe. Ndersa, me linje semantike do të kuptojmë motivimin e njësisë, pra njesinë motivuese, e cila motivon semantikisht dhe morfologjikisht edhe njësinë e sapoformuar. Ne procesin e formimit të fjalëve, sipas J.Thomai, ndodhin disa lloje ndryshimesh semantike të cilat ai i klasifikon në tri grupe: a) ndryshime të kuptimit kategorial ⁷⁴; b) ndryshime të kuptimit leksikor të fjalës ose të klasës së fjalëve, e modeleve fjalëformuese. që ndodhin në të gjitha vargjet dhe c) ndryshime të përbërësve suplementarë me vlerë të njësisë semantike themelore, sic janë nuancat e shkallës së intensitetit të veprimit, të përsëritjes, të përforcimit, të ngjyritimit emocionues, etj.

Gjuhëtari K. Cipo në punimin “Gramatika e shqipes”, gjithashtu trajton çështjen e fjalëformimit ku analizon pjesët e ndryshme të ligjëratës dhe ben dallimin mes përngjitjes dhe prejardhjes. Të

⁷⁰The structure of modern English A linguistic Introduction. Laurel J. Brinton John Benjamins Publishing Company Amsterdam/Philadelphia f 85.

⁷¹ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, f. 58.

⁷² Sh. Demiraj, Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa e I. Morfologjia, Tiranë 1962 f 87

⁷³ Sh. Demiraj, Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa e I. Morfologjia, Tiranë 1962 f87

⁷⁴ “J. Thomai ”Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe”, 248-249.

gjitha fjalët e formuara me prapashtesa emërtohen “derivate”.⁷⁵ Gjithashtu, janë të përfshira emrat që formohen me parashtesa e prapashtesa⁷⁶. Foljet e formuara me parashtesa Cipo i jep emërtimin ‘të përngjitura’.⁷⁷

Sipas gjuhëtarit Rami Memushaj, pasurimi i leksikut bëhet përmes; a) *pasurimit të strukturës kuptimore të fjalës me kuptime të reja*; b) *krijimit të fjalëve të reja me anë të mënyrave të fjalëformimit*; c) *përmes huazimit të fjalëve nga gjuhë të tjera*. Megjithatë, ai mbetet i mendimit se formimi i fjalëve të reja realizohet se tepër me anë të prejardhjes morfologjike duke qenë kjo e fundit edhe mënyra më prodhimtare për pasurimin e leksikut. që studiohen Sipas tij, mënyrat më të njohura të fjalëformimit janë prejardhja me ndajshesa, kompozimi dhe përngjitja, sikurse ka edhe mënyra të tjera që luajnë një rol më të vogël në pasurimin e leksikut, si shkrirjet e shkurtesat dhe prejardhja prapavajtëse⁷⁸.

Gjuha shqipe është e pasur me mënyra fjalëformuese. Në veprën *Gramatika e gjuhës Shqipe*, në vëllimin e parë që përmban Morfologjinë e fjalëformimit dhe Morfologjinë e eptimit të gjuhës shqipe paraqiten gjashtë të tilla bashkë me nënndarjet e tyre:

4.2 Prejardhja me nënndarjet e saj:

- a.prejardhje parashtesore
- b.prejardhje prapashtesore
- c.prejardhje parashteso-prapashtesore
- ç.prejardhje pa ndajshesë

2.Nyjëzimi

3. Kompozimi

4.Përngjitja

5.Konversioni

6.Mënyra e përziera

- a.përngjitje + prapashtesim
- b.kompozim + prapashtesim
- c.nyjëzim dhe prapashtesim
- ç.nyjëzim dhe parashtesoprapashtesim
- d.nyjëzim dhe përngjitje

⁷⁵ K. Cipo, Gramatika shqipe, Tiranë 1949, f.35

⁷⁶ K. Cipo, Gramatika e shqipes, Tiranë, 1949, f. 38

⁷⁷ K. Cipo, Gramatika e shqipes, Tiranë, 1949, f. 39

⁷⁸ Memushaj, R. *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2006, f. 281

Në gjuhën angleze mënyrat prodhimtare të fjalëformimit mbeten kompozimi ose përbërja (composition), prejardhja (derivation), konversioni (conversion), shkurtime (abbreviations) dhe prapaformimi (back-formations)⁷⁹.

4.2.1 Prejardhja

Prejardhja është mënyra më prodhimtare dhe më e larmishme në sistemin e fjalëformimit të gjuhës shqipe. Prejardhje quhet formimi i fjalëve të reja me anë të bashkimit të ndajshesave fjalëformuese me tema fjalësh ose me fjalë, sipas modeleve të fjalëformimit që ekzistojnë në gjuhë. Sipas llojit të ndajshesës fjalëformuese dhe sipas mënyrës së bashkimit të saj me temën dallohen këto lloje të prejardhjes:

- a.prejardhje parashtesore
- b.prejardhje prapashtesore
- c.prejardhje parashteso-prapashtesore
- ç.prejardhje pa ndajshesë

Mënyra fjalëformuese e prejardhjes ka qenë objekt studimi i mjaft gjuhëtarëve e albanologëve të huaj si Pedersen-I, Jokli dhe Meyer-i, dhe Jokli. Gjithashtu, gjuhëtari e studiuesi i shquar Aleksandër Xhuvani duke studiuar ndajshesat fjalëformuese të shqipes, ka arritur të mbledhë dhe analizojë rreth 170 prapashtesa dhe rreth 80 parashtesa bashkë me Çabejn. Në punimin “Mbi prejardhjen e fjalëve”⁸⁰ Xhuvani shkruan rreth studimeve të shumta që janë bërë në lidhje me mënyrën e prejardhjes që nga Kristoforidhi. Dhimitër S. Shuteriqi gjithashtu shkruan në shkrimet e tij në lidhje me prejardhjen, si mënyra më prodhimtare e pasurimit të leksikut të gjuhës shqipe ndër kohëra⁸¹. Sipas tij numri i fjalëve të prejardhura është pesë herë më e madhe se ajo e fjalëve të përbëra. Studiuesi E. Hysa shkruan rreth mundësisë së bashkimit të mjeteve ndajshesore me tema të ndryshme fjalëformuese si tema emërore, foljore, mbiemërore dhe ndajfoljore, të cilat përbëjnë dhe klasat më të pasura të leksikut të gjuhës shqipe⁸².

4.2.1. Prejardhja parashtesore

Prejardhja parashtesore është ajo mënyrë fjalëformuese e cila formon fjalë të reja përmes parashtesave, ku si tema motivuese mund të shërbejnë fjalë të thjeshta ose dhe fjalë të prejardhura, me parashtesa: çlodh, përjetoj, përflas, shqep, zhvesh, mosardhje, stërmbesë, nënvlerësoj, jokonkret etj., , çarmatos, i pazakonshëm , zhvendos, etj. Mund të themi se ky nëntip fjalëformimi është shumë prodhimtar në gjuhën shqipe, por gjithsesi prapashtesimi mbetet nëntipi më prodhimtar i prejardhjes. Shkak për këtë është kryesisht numri më i madh prapashtesave krahasuar me parashtesat e shqipes. Kështu, në veprën e tij A. Xhuvani përfshin 82 parashtesa, disa prej të cilave nuk përdoren më sot e rreth 168 prapashtesa. Ndër parashtesat e shqipes të cilat janë vjetëruar tanimë e nuk janë më prodhimtare mund të përmendim: d(ë) dëborë, shtër-, g(ë)- gdhij; dëboj, f- fshij; n(ë)- ndaj, ndez, ngordh etj.

⁷⁹ Becera, Z, A. A. (2000). Handbook of general and applied linguistics, f.34.

⁸⁰ Në: Aleksandër Xhuvani, Vepra 1, f. 355-358

⁸¹ Dhimitër S. Shuteriqi në “Fjalë nga leksiku i shqipes para Buzukut” (në Studime filologjike, 1/1983, f.197-209).

⁸² E. Hysa, Dukuri e prirje të formimit të fjalëve në shqipen e sotme letrare, në: Gjuha Jonë 1/1985, f. 112.

Në mënyrën fjalëformuese me parashtesim ngrihet një problematikë e cila ka të bëjë me faktin se kjo mënyrë fjalëformuese ngatërrohet tepër me mënyrën e përngjitjes nga njëra anë, dhe kompozimit nga ana tjetër. Në punimin e tij “Parashtesat e gjuhës shqipe”, gjuhëtari dhe studiosi i shqipes A. Xhuvani shprehet se “ duke qenë se kufijtë mes parashtesimit dhe përngjitjes nuk janë përherë të prera, e bën më të vështirë vecimin e këtyre elementeve formative nga fjalët bazë që janë formuar me to.”⁸³ Duke qenë se shndërrimi i disa parafjalëve dhe pjesëzave në parashtesa e ka burimin te përngjitja, marrëdhëniet midis këtyre dy mënyrave të fjalëformimit janë dhe sot mjaft të gjalla, aq sa ndonjëherë e kemi të vështirë të dallojmë se me cilën prej mënyrave është formuar një fjalë e caktuar. Një përpjekje për të bërë një ndarje midis të dyjave d.m.th parashtesimit dhe përngjitjes na sugjerohet në veprën e Gramatikës së gjuhës shqipe. Ndryshimin ndërmjet një togu parashtesor apo të përngjitjes mund ta bëjë analiza e motivimit të fjalës, p.sh.: fjala *nëntokë* (shtresa e dheut që ndodhet nën sipërfaqen e tokës) motivohet me togun nën tokë, dmth nën tokë ruan vlerën e saj parafjalore, kurse nëngrup nuk mund të motivohet me një tog të tillë; parashtesa nën këtu tregon thjesht marrëdhënie të pjesës (nën) ndaj së tërës (grup). Tek fjala *nëntokë* kemi të bëjmë me përngjitje, ndërsa tek *nëngrup* kemi të bëjmë me parashtesim.

Në lidhje me tiparet e parashtesave të shqipes gjuhëtari J. Thomai shprehet se parashtesimi nuk e ndërron kategorinë leksiko-gramatikore të fjalës. Megjithatë, ai sjell shembujt si mposht (nga ndajshtesa poshtë), apo zbardh nga mbiemri i bardhë, mposht nga ndajfolja poshtë, duke ja atribuar dhe një funksion klasifikues parashtesave.

Ndërsa gjuhëtari E. Hysa i konsideron këto fjalë si formime parashteso-prapashtesore me prapashtesë zero duke ja lënë funksionin klasifikues vetëm prapashtesave.

Parashtesa përgjithësisht nuk ia ndërron kategorinë leksiko-gramatikore fjalës me të cilën bashkohet, por i jep asaj vetëm një kuptim të ri plotësues.⁸⁴ Në këto raste parashtesa i ngjitet fjalës. Kur me anë të parashtesimit kalohet nga një pjesë ligjërate në një tjetër, atëherë parashtesa i ngjitet temës së fjalës. Në këto raste tema e bjerr zanoren fundore të patheksuar që mund të ketë si p.sh.: mburr, shfaq, përgjak përmes parashtesave *për-*, *m-*, *sh-* nga temat buz, burr, faq, balt.

Një numër parashtesash, si: *sh-*, *zh-*, *ç-*, *s-*, *z-*, *m-*, *n-*, *stër-*, *shpër-* etj merren si të parme, por shumë parashtesa që janë sot shumë prodhimtare, kanë dalë prej fjalësh të tjera: prej parafjalësh si: *mbi*, *ndër*, *në*, *nën*, *pa*, *për* ose prej pjesëzash si: *jo-*, *mos-*, *sapo-*, *porsa-*, *a* *posa*. Kur kalojnë në parashtesa, sipas vjetërsisë së kalimit e sipas dendurisë së përdorimit me këtë funksion, ato, i dobësojnë lidhjet me kategoritë leksiko-gramatikore nga kanë dalë dhe afrohen me parashtesat e tjera të mirëfillta, duke fituar kuptime përgjithesuese, karakteristike për ndajshtesat fjalëformuese. Gramatika e gjuhës shqipe sjell shembullin e parashtesës *mbi-* e cila është tepër prodhimtare në formimin e emrave *jo* me kuptim hapësinor të parafjalës *mbi*, por për të treguar shkallën më të lartë të asaj që emërton fjala motivuese, p.sh.: *mbingacmim*, *mbilodhje*, *mbishpenzim* etj.

Mjaft të ndërlikuara në gjuhën shqipe janë edhe lidhjet e parashtesimit me kompozimin. Ka një numër fjalësh, elementi i parë i të cilave përdoret në gjuhë edhe në mënyrë të pavarur, si ndajfolje ose si parafjalë, si p.sh.: fjalë që nisin me *para-*, *prapa-*, *pas-*, *jashtë-*, *brenda-*, *larg-*,

⁸³ A. Xhuvani; E. Cabej “Parashtesat e gjuhës shqipe”. f.361.

⁸⁴ Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë 1995, f. 61

lart-, pranë-, sipër- etj p.sh.: paraardhës, parandiej, parandjnjë, paraburgim, paracaktoj, paradhënie, paradhomë, parafjalë, parapëlqej etj. Te këto shembuj kur pjesa e dytë është një folje (paracaktoj) ose emër vepruesi (pasardhës), pjesa e parë ka plotësisht vlerë ndajfoljore dhe kemi të bëjmë me një kompozitë.

Kështu në gjuhën shqipe për të bërë dallimin mes parashtesimit dhe përngjitjes duhet të merret parasysh natyra e motivimit të fjalës dhe natyra leksiko-gramatikore e elementit të parë.

Gjuha shqipe si një gjuhë e hapur ka pranuar në leksikon shumë fjalë të huaja nga gjuhë të ndryshme. Në kuadrin e huazimeve duhet theksuar edhe fakti i depërtimit të një numri parashtesash të huaja. Podgorica ka mbledhur dhe analizuar në punimin e tij rreth 77 parashtesa të huazuara, ndonëse disa prej tyre është shumë e vështirë të dallohen pa ditur më parë se si janë formuar këto fjalë në gjuhën e huaj.

Gjuhëtari M. Çeliku në punimin "Gramatikën praktike të shqipes" rendit një listë parashtesash të huazuara, të cilat herë-herë janë zëvendësuar me parashtesa të tjera të shqipes, të tilla janë: a-, an-, i-, anti-, de-, dez-, dis-, pro-,in-, pan-, inter-,auto-,super-,poli-. *a-* (me kuptim mohues) anormal (jonormal), afetar (jofetar), asimetrik(josimetrik), apolitik(jopolitik); *an-* analfabet *in-/i-* ireal, imoral, ilegal, inorganik.

anti- (me kuptimin e kundërshtisë) antipopullor, antidemokratik, antinjerëzor, antikombëtar,antiajror (kundërajror), antishkencor.

De- (me kuptim të kundërt)

Deformoj(shformoj), demobilizoj(çmobilizoj), degradoj(zhgradoj), deçentralizoj.

Dez-(me kuptim të kundërt)

Dezinfektoj-infektoj, dezintegroj (çintegroj)

Pro-(me kuptim pranues, përkrahës)

Proamerikan, profashist

In-

Inorganic (joorganik)

Pan- (me kuptimin gjithë, mbarë)

Panballkanik, panafrikan

Ultra-(me kuptimin tepër, tejmasës)

Ultratingull, ultrareaksionar,ultraliberal

Inter-

Internacional-ndërkombëtar, interurban-ndërrurban

Auto-

Autobiografi, autokritikë, autoofiçinë, automjet

Super-

superprodhim, superstrukturë

Poli-

poliklinikë, polisemantik

Disa nga parashtesat e huaja janë asimiluar nga sistemi i fjalëformimit të shqipes në një shkallë të tillë, sa që kanë filluar të japin edhe formime të reja nga fjalë shqipe, p.sh.: afetar, panshqiptar, pannjerëzor etj. Megjithatë, në gjuhën shqipe vihet re një prirje e zëvendësimit të parashtesave të huaja me parashtesa të shqipes si p.sh.: kundërajror, kundërgaz, çmilitarizim, shpolarizim (demilitarizim, depolarizim), ndërkontinental, ndërmolekular) etj .

4.2.2 Prejardhja prapashtesore

Prejardhja me prapashtesim është formimi i fjalëve të reja duke i vendosur temës së fjalës ndajshitesën prapashtesuese, p.sh.: vezak (vez+ak), vulos (vul+os), harkëtar (hark+ëtar), majtas (majt+as) etj.

Prapashtesimi është tipi më prodhimtar i ndajshitesimit. Prapashtesat e gjuhës shqipe janë rreth tri herë më shumë se parashtesat dhe kuptimet e tyre fjalëformuese janë më të shumta e më të larmishme se kuptimet e parashtesave.

Në përparësinë që ka prapashtesimi ne raport me parashtesimin, si dhe prodhimtarinë më të madhë të prapashtesimit, ndikon jo vetëm fakti që numri i prapashtesave të gjuhës shqipe është më i madh se numri i parashtesave, por edhe se temat me të cilat bashkohen prapashtesat mund të jenë tema të një fjale të parme (*lexoj*), të një fjale të prejardhur (*zhdoganim*) apo edhe të një fjale të përbërë (*shpirtligësi*). Me ane të prapashtesimit formohen mbiemra, emra, folje dhe ndajfolje nga po ajo pjesë ligjerate, por edhe prej pjesësh të tjera të ligjeratës. Nje karakteristike e prapashtesave është funksioni i tyre klasifikues. Prapashtesat e shqipes përveç kuptimit të ri që i japin temës me të cilën lidhen, përcaktojnë edhe pjesën e ligjeratës ku hyn fjala e re.

Kështu p.sh. nga foljet *lexoj, mesoj, shpall* etj. formohen emrat mesim, shpallje; nga emrat *trimeri, pambarim, nxitim* etj. formohen ndajfoljet **trimerisht, pambarimisht, nxitimthi**, etj. Megjithatë, ka raste kur fjalët e reja të formuara me ane të prapashtesimit, nuk e ndërrojnë kategorinë gramatikore të temës fjalëformuese më të cilin është lidhur prapashtesa. Kështu p.sh. nga emrat *kengë, furre, oborr*, etj. formohen me prapashtesim emrat: **kengetar, furretar, oborrtar**, etj; ose nga mbiemrat *i bukur, i kaltër* etj, formohen mbiemrat **bukurosh, gjatosh, kaltërosh** etj.

“Gramatika e gjuhës shqipe” përveç prapashtesave vendase e atyre të huaja të asimiluara prej kohësh, na paraqet edhe një numër prapashtesash të huaja, si: -ist, -izëm, -itet, -azh, -al, -esk, etj, të cilat përdoren më shumë në terminologji shkencore e politike. Ashtu siç ndodh me parashtesat, edhe te prapashtesat, huazimi ndodh bashkë me fjalët e formuara prej tyre. Këto fjalë mund të konsiderohen si të motivueshme edhe brenda shqipes, në rast se përdoret si fjalë më vete edhe tema fjalëformuese e tyre si p.sh.: arbitraritet(arbitrar), anarkizëm(anarki), industrial(industri).

Gjuhëtari M. Çeliku në punimin ” Gramatikën praktike të shqipes” rendit një listë prapashtesash të huazuara, të tilla janë:

-ist : centralist, artist, kitarist, makinist, futbollist;

-ier, -er: bankier, boksier, kuzhinier, karrocier;

-ant: kursant, emigrant;

-ent: asistent, referent;

-xhi/çi: bojaxhi, sahatçi, interesaxhi etj.

Prejardhja parashteso-prapashtesore

Prejardhja parashteso-prapashtesore është një mënyrë fjalëformimi me anë të së cilës formohen fjalë të reja duke iu bashkangjitur drejtpërdrejt temës fjalëformuese parashtesa dhe prapashtesa njëkohësisht. Ky nëntip fjalëformimi është më pak prodhimtar se dy nëntipet e tjera të diskutuara. Formime parashteso-prapashtesore janë pak emra dhe disa folje si: përbindësh, përdhes, përjetësi, përkrenare, përqindje, etj; Folje: përmalloj, përtërit, përvetësoj, shfletoj, shfrytëzoj, shkripëzoj, shpronësoj, zgjeroj përfundoj, zhdoganoj, zbukuroj, nguros, përgjithësoj, përgënjeshtroj, përjetësoj, etj.

Prejardhja pa ndajshesë

Kjo mënyrë fjalëformimi karakterizohet nga mungesa e ndajshesës fjalëformuese, e cila bëhet këtu shprehëse e kuptimit, që ka fituar fjala e prejardhur në raport me temën motivuese të saj. Duhet theksuar fakti që te fjalët e formuara me anë të prejardhjes pa ndajshesë, një rol fjalëformues luan edhe paradigma e re e fjalës dhe ndryshimet fonetike. Fjalë të tilla janë emrat si: hap-i, mund-i, të formuara nga foljet hap, mund, shkund; foljet: huaj krip, kuq, ndryshk, sit shëndosh të formuar përkatësisht prej emrave e mbiemrave hua, kripë, i kuq, ndryshk, sitë, shëndoshë.

Pra, formimi i këtyre fjalëve bëhet pa ndonjë ndajshesë⁵⁷, por vetëm me kalimin e saj nga një kategori e caktuar leksiko-gramatikore në një tjetër. Në këto raste kemi të bëjmë me formantin fjalëformues ndajshesor zero, i cili bashkë me paradigmen e re të fjalës bëhen shprehës të kuptimit që fiton fjala e re e formuar në raport me temën e saj fjalëformuese.

Prejardhja pa ndajshesë nuk është mënyrë prodhimtare në sistemin e sotëm të fjalëformimit të shqipes.

Nyjëzimi

Nyjëzimi është një tjetër mënyrë fjalëformuese tepër prodhimtare në gjuhën shqipe, ku formohen fjalë të reja me anë të një nyje të përparme. Nyjat janë kryesisht morfema trajtëformuese, shprehëse të kategorive gramatikore, por ato mund të jenë njëherazi edhe fjalëformuese, si ndodh në rastet kur nëpërmjet tyre formohen mbiemra të nyjshëm, duke kryer në këtë mënyrë dy funksione.

Kompozimi

Kompozimi është ajo mënyrë fjalëformimi e cila krijon fjalë të reja me dy ose më shumë tema motivuese; njëra nga temat mbështetëse, që është përgjithësisht e dyta, mbart kuptimin gramatikor. Tema tjetër mbart kuptimin leksikor, p.sh.: bregdet, verilindje, parashikoj, marrëdhënie, vendbanim etj.⁸⁵ Pas ndajshesimit kompozimi është mënyra më prodhimtare e formimit të fjalëve në shqipen e sotme.

Kompozita formohet nga emra, mbiemra, folje e ndajfolje, si edhe numërorë e përemra. Kuptimimi leksikor i të cilëve është i qartë, i përcaktuar. Gjymtyrët e kompozitës mund të paraqiten në marrëdhënie bashkërenditjeje, si p.sh. politiko-shoqëror, por edhe në marrëdhënie nënrenditjeje. Sipas këtij kriteri dallohen kompozitat këpujore e kompozitat përcaktore.

Kompozitat këpujore janë fjalë të përbëra prej dy ose më shumë gjymtyrësh me lidhje bashkërenditje midis tyre si: deledash, dritëhije, verilindje, jugperëndim, bar-kafe, etj., e mbiemra, si: bardhezi, leksiko-gramatikor, etj.

Kompozitat përcaktore, përbëhen prej vetëm dy gjymtyrësh, nga të cilat njëra përcakton tjetrën; ose e para të dytën, p.sh.: kryeqytet, këpucëbërës, sypetrit, kryeplak, bukëpjës, keqpërdor, etj., ose e dyta të parën, p.sh.: këndvështrim, peshk-gjel, buzëvarur etj. Edhe kur kompozita ka tri a më shumë tema motivuese, ajo është përsëri një formim dygjymtyrësh: zëvendës-drejtor (zëvendës) + (drejtor), zëvendëskryeredaktor, (zëvendës) + (kryeredaktor) tj..

⁸⁵ Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, f.44, Tiranë, 1976.

4.2.3 Përngjitja

Përngjitja është një mënyrë fjalëformimi me anë të së cilës formohen fjalë të reja përmes leksikalizimit të një togfjalëshi, i një togu parafjalor ose i një grupi fjalësh në përgjithësi. Lidhjet sintaksore ndërmjet gjymtyrëve të togfjalëshit a të togut ruhen në përgjithësi të qarta edhe në strukturën e fjalës së re të përngjitur, p.sh.: farefis (farë e fis), gjëegjëzë (gjë e gjëzë), trembëdhjetë (tre mbë dhjetë), askush (as kush), tungjatjeta (tu ngjat jeta), etj.

4.2.4 Konversioni

Konversioni është mënyra e formimit të fjalëve të reja përmes kalimit nga një pjesë e caktuar të ligjeratës në një tjetër pa ndërhyrjen e ndonjë afiksi apo alternimi fonetik.

Përmes këtij tipi fjalëformues mund të formohen emra nga mbiemra dhe nga pjesore, të cilët kur emërzohen, nuk emërtojnë më cilësi e tipare të personave ose sendeve, apo një veprim si tipar të një sendi, por vetë personat e sendet, apo veprimin të marrë si send. Të tillë janë: *i dashuri, e keqja, e shkuara, besniku, i gjalli, veriori, të kuqtë, të ftohtët etj.* Gjithashtu, nëpërmjet konversionit formohen edhe shumë mbiemra, p.sh: *fshatçe, pleqërishte, etj.*

Në gjuhën shqipe ndajfoljet formohen edhe nga rasat e ndryshme të emrave, si dhe nga foljet, kryesisht nga pjesorja e foljes dhe më pak nga përcjellorja mohore e mënyrës⁸⁶: fare, herët, krejt; ditën, natën, etj.; motit, sheshit, një nate etj.; fshehur, prerë, shkoqur; papritur, padashur etj.

4.3 Mënyrat e përziera

Mënyrat e fjalëformimit veprojnë shpeshherë edhe në kombinim me njëra-tjetrën. Më të zakonshmet janë kombinimet e mëposhtme:

- a. Përngjitje+ prapashtesim
- b. Kompozim+prapashtesim
- c. Paranyjëzim+prapashtesim
- ç. Paranyjëzim+parashteso-prapashtesim
- d. Paranyjëzim+përngjitje

⁸⁶ Kështu e quan M. Çeliku formën e pashtjelluar mohore formuar nga pa + pjesore në “Format e pashtjelluara te foljes në gjuhën e sotme shqipe”, Tiranë, 2000.

4.4 Fjalëformimi në gjuhën angleze

Vëmendja e kushtuar dhe interesi në studimin e mënyrave fjalëformuese si një nga mënyrat kryesore të pasurimit të fjalorit të anglishtes ka qënë aq i madh sa dhe vetë studimi mbi gjuhën në përgjithësi. Kështu, në lidhje me fjalëformimin kanë shkruar që nga koha e Paninit, i cili arriti te realizojë një përshkrim të detajuar të mënyrave fjalëformuese të sanskrishtes. Në veprën “Word-formation in English”, Lauer shkruan se problematika të fjalëformimit që ngrihen sot nga gjuhëtarë të ndryshëm të botës, janë hedhur për diskutim që herët, në shekujt 17, 18 e 19-të.⁸⁷(Brekle, 1911; Brekle and Kastovsky 1977b), dhe nuk është se janë dhënë dhe aq shpjegime të tjera apo njohuri të reja në lidhje me ato çështje që nga koha e Paninit.

Kohët e fundit fjalëformimi është konsideruar nga gjuhëtarë të ndryshëm nga këndvështrime të ndryshme si p.sh nga këndvështrimi fonologjik (Halle,1973; Lightner, 1975), nga këndvështrimi sintaksor (Jackendoff, 1975; Roeper and Siegel, 1978), ng këndvështrimi semantik (Leech, 1974;Lyons, 1977). Përsa i përket emërtimit dhe përkufizimit të fjalëformimit, Lauer e përkufizon atë në këtë mënyrë: “Fjalëformi ka një emërtim tradicional, i cili është gjetur i përshtatshëm, por që nuk mbulon të gjitha mënyrat e formimit të asaj që është quajtur fjalë.”⁸⁸ Lauer tërheq vëmendjen për mungesën e universalitetit në lidhje me proceset fjalë-formuese. Në këtë emërtim është marrë parasysh vetëm gjuha angleze dhe në përgjithësi të tëra gjuhët indo-europiane, por jo në rang botëror.

Sipas Ginzburg, fjalëformimi është procesi i krijimit të fjalëve nga materiali egzistues i një gjuhe pasi zbatohen modele e formula semantike e strukturore të caktuara⁸⁹. Ky njihet si procesi i formimit të fjalëve me përmasa më të mëdha, më komplekse nga fjalë më të thjeshta, më të shkurtra, sepse i shtohen temës fjalëformuese përgjithësisht morfema.

L.Bauer në veprën “English word-formation” , bën një klasifikim brenda morfologjisë duke ndarë morfologjinë që merret me mbaresat, eptimin e fjalëve nga mënyrat fjalëformuese të gjuhës angleze. Në skemë vihet re qartë që Bauer konsideron prejardhjen, *derivation*, dhe kompozimin si dy nga format kryesore të formimit të fjalëve në gjuhën angleze.⁹⁰

⁸⁷ Bauer L. Salvador Valera Hernández Waxman Verlag “Approaches to Conversion / Zero-Derivation” GMBH 2005, Postfach 8603, 4804,6 Munster Germany f19-25.

⁸⁸ L. Bauer “Wordformation in English”, f 9.

⁸⁹ R. S. Ginzburg S. S. Khidekel, G. Y. Knyazeva, A. A. Sankin A course in modern English Lexicology Moskw (f113)979

⁹⁰ L. Bauer, “English wordformation”, f 33, Cambridge University press.




Figure 2 - Skema e fjaleformimit sipas L. Bauer

Gjithashtu, A. Sharra paraqet kompozimin dhe prejardhjen si mënyrat më prodhimtare të gjuhës angleze. Për më tepër mënyra të tjera të formimit të fjalëve të cilat paraqiten në punimin e tij “Word Formation A supplement to English Grammar” janë:

- Composition (Kompozimi, Përbërja)
- Derivation (Prejardhja)
- Conversion (Konversioni)
- Abbreviation (Shkurtime)
- Back-formation⁹¹ (Prapaformimi)

Përsa i përket prejardhjes (derivation), Lauer përfshin nëntipet kryesore të fjalëformimit që janë parashtesimi dhe prapashtesimi, të cilat në gjuhën angleze përmblihen si *affixation*, ndajshtesimi. Ndajshtesimi në gjuhën angleze, ashtu si e pamë edhe në shqipe, është ai proces fjalëformues i cili përmes parashtesave e prapashtesave që u shtohen rrënjëve e fjalëve të parme krijon fjalë të reja, si p.sh.: prapashtesa **-able** pranë fjalës *pass*, formon fjalën e re *passable* (i kalueshëm). Në të njëjtën mënyrë, nëse fjalës së formuar *passable* i pranëvitet parashtesa **im-**, formohet fjala e re *impassable* (i pakalueshëm).

4.4.1 Ndajshtesimi

Përkufizimi që bëri Yule për prejardhjen në gjuhën angleze është "proçesi fjalëformues më i rëndësishëm i fjalëformimit që formon fjalë të reja duke shtuar rrënjëve morfema të tjera" (Yule

⁹¹ Sharra, Th. A supplement to English Word Formation Tiranë 1971, f 4.

2006, 57) Këto morfema u pranëvihen rrënjës me anë të ndajshesimit, parashtesimit e prapashtesimit. Ndërsa parafjalët si: *un-* apo *dis-* zakonisht nuk e ndryshojnë kategorinë leksikore të fjalës, prapashtesat si p.sh.: *-ness* apo *-ation* e ndryshojnë atë. Nëse merr shembujt *happy* → *unhappy* (i lumtur – i palumtur) dhe *happy* → *happiness* (i lumtur – lumturi), është më se e qartë se për shkak të prapashtesës *-ness*, kategoria leksikore ka ndryshuar, nga mbiemer (*happy-i lumtur*) është kthyer në emër *happiness* (lumturi).

4.4.2 Kompozimi

Kompozimi, apo përbërja në gjuhën angleze ka të bëjë me kombinimin e dy apo me shumë fjalëve të parme, rrënjëve për të formuar një fjalë të re, p.sh. fjalët: *blackboard* (tabelë e zezë), të formuara nga rrënjët *black* dhe *board*, *brother-in-law* (kunati), *brother* (vëlla), *in* (në) dhe *law* (ligj). Përbërja është procesi fjalëformues më i zakonit në të tëra gjuhët. Karakteristikat e fjalëve të përbëra në gjuhën angleze:

Se pari, fjalët e përbëra nga ana gramatikore dhe semantike sillen njëjloj si fjalë të vetme.

Se dyti, kompozitat marrin mbaresa vetëm në fund të tyre, si p.sh: *bedrooms, schools, buses, water resistant*. Perjashtim bëjnë fjalet: *passersby-kalimtare, brothers-in-law-kuneter*.

Se treti, në gjuhën angleze fjalët e përbëra i gjejmë në disa forma:

a. **Të hapura**, d.m.th fjalët e përbëra lidhen bashkë pa asnjë element si p.sh.: *toy store* (*dyqan lodrash*), *diving board*, *flower pot* (*vazo lulësh*).

b. **Të lidhura me vizë**, (-) që bën ndarjen e fjalëve të kompozitës, p.sh.: *flower-pot, air-brake, she-pony*.

c. **Të lidhura**, ku fjalët përbërëse lidhen me njëra-tjetrën pa asnjë element lidhës, vizë apo hapësirë, si p.sh.: *flowerpot, washrooms, pickpocket*.

Duhet theksuar fakti që tendenca e të formuarit të kompozitave me vizë ndërmjetëse të fjalëve është më e përhapur në anglishten britanike sesa atë amerikane. Në anglishten amerikane mbizotëron prirja e formimit të fjalëve të përbëra të hapura dhe të lidhura (Quirk et al., 1985).

Se katërti, një karakteristikë tjetër është se kuptimi që fjalët e përbëra mbartin në gjuhën angleze del nga të dy elementët që lidhen si p.sh.: a *boathouse* is ‘një vend ku qëndrojnë varkat’; *bookstore* është një dyqan ku shiten libra etj. Megjithatë, ka edhe fjalë të tjera të përbëra kuptimi i të cilave duhet mësuar si të ishin fjalë të vetme, p.sh.: një *Redcoat* d.m.th ushtar britanik, jo një pallto e kuqe. *Flatfoot* d.m.th detektiv ose polic, ndërkohë që fjalë për fjalë kuptimi është këmbë e sheshtë; *turncoat* d.m.th ‘tradhëtar, a *hot dog* d.m.th një lloj ushqimi i shpejtë, dhe jo një qen i nxehtë etj.

Se pesti, theksi bie zakonisht në elementin e parë të fjalëve të përbëra si p.sh.: "*air-crafts, chewing-gum*. Por këtu duhet të bëjmë dallimin midis fjalëve të përbëra dhe frazat tq cilat kanë të njëjtët elemente dhe rend si kompozitat. Këto të fundit theksin më tepër e kanë në elementin e

dytë si p.sh.: *the "white house vs. the "White House*. Megjithatë, ka raste kompozitash ku theksi bie në elementin e dytë siç e pamë tek grupet emërore më lart: *working "man, flying "saucer, woman "writer, fancy "dress*.

Gjithashtu, elementi i dytë zakonisht përcakton kategorinë gramatikore të së tërës, d.m.th të gjithë fjalës së përbërë.

4.4.3 Huazimet

Një tjetër mënyrë e pasurimit të fjalorit rë gjuhëve është edhe përmes **huazimeve**. Është i njohur botërisht fakti i zhvillimit të gjuhëve duke e konsideruar gjuhën e një populli si një sistem dinamik, gjithmonë në ndryshim. Leksiku i saj zgjerohet si nga elementi vendas, ashtu edhe nga ai i huaj. Pra, leksiku i një gjuhe nuk është një grumbull i thjeshtë fjalësh, por një sistem njësisht, që klasifikohen sipas prerjeve të ndryshme dhe kriterëve nga nisemi. Leksiku mund të kundrohët sipas burimit të fjalëve, që nënkupton dy grupe paradigmatiche të mëdha njësisht: *grupi i njësisive leksikore që lidhen me leksikun amtari (autokton)* dhe *grupi i njësisive leksikore të huazuara*.

Ndikimi dhe kontributi i elementit të huaj ndodh që të jetë vërtetë aq i madh sa të mund të konsiderohet akoma më domethënës në prurje fjalësh se sa ai autokton. Më pas janë pikërisht rregullat dhe ligjësitë fonetike dhe gramatikore të gjuhës pritëse ato të cilat i përpunojnë dhe i përshtasin në gjuhë. Në ditët tona kanë mbërritur shumë pak fjalë kelte në anglishte, pra fjalë që përbëjnë grupin e njësisive leksikore që lidhen me leksikun amtari (autokton). Edhe pse fjalëformimi është një mënyrë shumë e rëndësishme e formimit të fjalëve në gjuhën angleze, duhet theksuar fakti që burimi më i furishëm i pasurimit të fjalorit ka qënë grupi i njësive leksikore të huazuara nga gjuhët e tjera, sidomos atë, latine, frënge, greke, skandinave, italiane etj.

Me teprinë e fjalëve me origjinë nga latinshtja dhe greqishtja përmes gjuhës latine, një vëshgues i thjeshtë do ta konsideronte gjuhën angleze si një gjuhë romane (neolatine) ashtu si edhe frëngjishtja, spanjishtja dhe italishtja, e folur nga romakët e vjetër. Por, pavarësisht kësaj gjuha angleze bën pjesë në grupin gjermanik të gjuhëve e për rrjedhojë konsiderohet motër e gjuhëve të zhdokura si gjuha e vjetër norse (old Norse) dhe gotike (Gothic) apo motër e gjuhëve të tjera moderne si suedishtja, hollandishtja dhe gjermanishtja.

Huazimet shprehin procesin nëpër të cilin folësit adoptojnë fjalët nga gjuha burimore në gjuhën amtare. Ato vijne si rrjedhojë e bashkëveprimeve dhe kontakteve kulturore ndërmjet popullatave që flasin këto gjuhë. Huazimet kanë dy kahe, të dyja gjuhet në kontakt japin e marrin fjalë të njëra-tjetrës, por në përgjithësi ekziston një farë asimetrie, d.m.th nga njëra gjuhë kalojnë më shumë fjalë në tjetrën. Në këtë rast, folësit e gjuhës burimore kanë një lloj fuqie, prestigji apo pasurie, që i bën folësit e gjuhës marrëse të dëshirojnë fjalët e tyre. Për shembull, fiset gjermanike në shekujt e parë pas Krishtit huazuan shumë fjalë nga latinishtja, meqenëse blinin shumë prodhime romake. Megjithatë, e kundërta nuk ndodhi, pasi shume pak fjalë gjermanike hynë në fjalorin e latinishtes.

Procesi i huazimit është tejet i ndërlikuar. Në të shumtën e rasteve, një pjesë e folësve të gjuhës marrëse e njohin gjuhën burimore, ose të paktën dinë të përdorin disa fjalë. Ata përdorin fjalën e

re të huazuar pasi ajo shpreh më qartë idenë që duan të përcojnë. Në kësi rastesh, ata i shqiptojnë fjalët e huazuara njësoj si në gjuhën burimore. Për shembull, anglezët huazuan nga italishtja fjalën përshëndetëse *ciao*, apo *espresso* me shqiptim si në italisht. Pa dyshim që folësit e parë që e përdorën atë dinin italisht ose e kishin dëgjuar këtë fjalë në një kontekst ku flitej italisht. Për folësit e tjerë fjala tingëllon e huaj. Në anglisht ka shume fjalë e togje fjalësh të huaja si *cappuccino*, *al dente*, *al fresco* etj që për shumë folës edhe sot tingëllojnë të huaja. Sigurisht që me kohë, folësit mësohen me shprehjen apo fjalën e re, deri në atë pikë sa edhe ata që nuk e e flasin gjuhën burimore ta kuptojnë e ta përdorin atë fjalë. Fjala e re konvencionalizohet e në këtë pikë ajo quhet “huazim”. Konvencionalizimi është një proces i ngadaltë ku fjala përshkon ligjërimin e të gjitha grupeve të popullsisë për tu bërë pjesë e fjalorit të gjithkujt. Fjala e re e huazuar merr karakteristikat e gjuhës marrëse, pasi ata që nuk e njohin gjuhën burimore e përshtasin këtë fjalë sipas sistemit të tyre linguistik, fonetik, morfologjik. Por, sa më shumë të përdoret fjala aq më shumë i humbet nuancat e fjalës së huaj dhe duket si një fjalë amtare.

Është për tu theksuar se termi huazim i përket përshkrimit diakronik të prejardhjes së fjalorit. Shumë herë ky term përdoret edhe në përshkrimin sinkronik të fjalës, sidomos kur origjina e saj nuk dihet në cilën periudhë apo gjuhë ka mbërritur deri në ditët tona. Gjuhëtarët ende diskutojnë mbi dallimin mes termave, *burime të huazimeve*, dhe *origjina e huazimeve*. Burim i huazimit do të thotë se nga cila gjuhë X fjalë ka hyrë në gjuhën angleze. Origjinë e huazimit do të thotë të hulumtosh thellë në etimologjinë e fjalës së huazuar për të gjetur burimin fillestar. P.sh table ka hyrë nga burimi frëng, por origjina e saj është latine, *tabula*. Burimi i huazimeve është natyrisht i një rëndësie të madhe për studentët e gjuhës angleze, pasi ai zbulon faktorët jashtëgjuhësorë përgjegjës për procesin e huazimit dhe gjithashtu pasi fjalët e huazuara ruajnë gjurmët e formës tingullore, grafike, morfologjike dhe strukturën sematike karakteristike të gjuhës nga ku huazohen.

Gjuha angleze ka kaluar nëpër shumë periudha huazimesh. Ato përkojnë me kontaktet më të mëdha kulturore mes anglishtes dhe gjuhëve të tjera. Këto periudha nuk janë të prera me thikë por shkrihen me njëra-tjetrën. Për shembull ndikimi skandinav nisi në shekullin VIII dhe vazhdoi edhe pas pushtimit norman. Huazimet nga gjuhët në kontakt janë tipike e historisë kulturore të Anglisë. Ka pasur disa vite kur gjuhëtarët u bënë qëndresë e huazimeve. Ndryshe nga shtete të tjera europiane, për shembull, në Britani apo SHBA nuk ekziston Akademia Kombëtare roli i së cilës është kufizimi dhe ndalimi i hyrjes dhe përdorimit të fjalëve të huaja.

Në të gjitha gjuhët e botës, dhe në ato me shkallë të lartë përpunimi dhe me aftësi e mundësi shumë të mëdha krijuese gjejmë grupin paradigmatic të huazimeve. Huazimi si proces tregon se popujt kanë qënë a janë kufitarë ose kanë pasur apo kanë marrëdhënie historike, ekonomike, a kulturore ndërmjet tyre. Persa i përket huazimit, ai leksikor ndodh në rrethana historike, gjuhësore të caktuara, edhe kur në gjuhë ka emërtim për të njëjtën realie a për të njëjtin koncept. Kështu, krahas një fjale tjetër është pranuar fjala e huaj: a) kur ka qene një term ndërkombëtar, b) kur ka sjellë një nuancë kuptimi më të përpiktë e të vecantë, c) kur e ka kërkuar një stil i caktuar i gjuhës, d) edhe për shkak të prirjes së disa të folmeve profesionale, për të qënë “sa më të përgjithshme, sa më ndërkombëtare”. Kjo gjë vërehet në leksikon e fushave të artit, të modelistëve, të biznesit, të financave, të informatikës, të turizmit etj dhe lidhet me fushën, por edhe me kulturën e atyre që i përdorin fjalët e huaja.

Më poshtë listojmë disa parashtesa të anglishtes me origjinë latine:

Tabela 2 - Disa parashtesa të anglishtes me origjinë latine

prefiksi	Kuptimi	Shembuj
co-	Bashkë	Coauthor-bashkëautor, coedit, coheir
de-	-{di} parasht ç-; sh-; zh-;de-	Deactivate-çaktivizoj, defrost – shkrij; decompress-çngjesh; deplane-zbres nga aeroplani.
dis-	Pa-, ç-; zh-; mos-.	disbelief-mosbesim, discomfort- bezdí; mungësë komoditëti, discredit- diskreditím, turpërím; disrepair-lënie pas dóre; rrëním, disrespect-mungësë respékti; mosrespektím;
inter-	Ndër	International-nderkombetar, intertëine-nderthur, intercellular-nderqelizor
non-	mos-; pa-; jo-.	Nonessential-jo kryesor, nonmetallic- jo metalic, nonresident-jorezistues, nonstop-pa ndalese
post-	prapa-; pas-; prej:	postdate, postwar, postnasal, postnatal
pre-	para-	preconceive, preexist, premeditate, predispose, prepossess, prepay
re-	ri-; përsëri	Rearrange-riorganizoj, rebuild-rindertoj, remake-ribej, rewrite-rishkruaj.
sub-	nën; pranë; sub.	submarine, subsoil, subway, subhuman, substandard
trans-	Trans	transatlantik, transpolar

Zgjerimi i fjalorit të gjuhës angleze ka ardhur edhe si rezultat i huazimit të vazhduar, gje e cila ka cuar në krijimin e shumë fjalëve të reja. Parashtesat “a-, be-, fore-, mis- dhe un- na rezultojnë me origjinë gjermane, ndersa të gjitha parashtesat e tjera produktive të gjuhës angleze nuk janë me origjinë gjermane. Shumë prej tyre janë ndërkombëtare. Përveç parashtesave a-, auto-, hyper, dhe mal-, të tjerat mund të kombinohen si me fjalë me origjinë gjermane ashtu dhe me fjalë jo me origjinë gjermane. Per parashtesat “a- dhe be-” nuk është akoma e prere nese ato të konsiderohen parashtesa të prejardhura në të gjitha rastet, pasi ne shembujt si p.sh ashore, afire, belie, afire ato kanë tiparet e parafjaleve.

KREU V PARASHTESIMI NË GJUHËN ANGLEZE DHE SHQIPE

5.1 Parashtesimi në gjuhën angleze

Nëse krahasojmë të dy tipet e prejardhjes në sistemin fjalëformues të gjuhës angleze, parashtesimi na rezulton si më pak i favorizuar se prapashtesimi. Gjuhëtarët nuk e kanë përcaktuar qartësisht numrin e saktë të parashtesave të anglishtes i cili sigurisht që është më i vogël në numër se prapashtesat në këtë gjuhë. Megjithatë, fjalori i anglishtes Webster (2002)⁹² regjistron 95 parashtesa dhe 235 prapashtesa. Më poshtë listojmë prefikset angleze të pasqyruara në fjalorin e gjuhës angleze Webster (2002).

Prefiksi i anglishtes	Kuptimi, parashtesa e shqipes	Shembuj
Ab- abs	Larg, larg nga	Abduct = rrembej, abjure = heq dore nga abscond = iki fshehurazi.
Ad- Ac- af- ag- an- ap- ar- as- at-	Përpara, në përputhje me	advance = eci përpara accord = marreveshje affliction = vuajtje aggregation = grumbullim annexation = aneksim, appease = qetesoj arraignment = aktakuze, assumption = supozim attendance = presence
Ambi-	Të dy	ambiguous = me dy kuptime,i paqarte ambivalent = vi ndare me dysh ambidextrous = mashtrues
An-, a-	Pa, a	Anarchy =anarki, amoral = amoral, atypical = atipik
Ante-	Para	Antecedent =paraprake antediluvian =e lashte, e hershme antecedence = perparesi
Anti-	Anti, kunder	antipathy =antipati antithetical =armiqtësor anticlimax = antiklimaks

⁹² A Dictionary of Prefixes, Suffixes, and Combining Forms Webster' Third New International Dictionary, Unabridged 2002.

Arch-	Krye	archetype archbishop -kryepeshkop archangel -
Be-	Parashtesë që formon folje nga folje	bemuze befuddle bemoan belittle
Bi-	Dy	bicameral biennial bicycle
Cata-	Kata	catastrophe =katastrofe cataract =katarakt, catapult = katapult
Circum-	Rreth	Circumnavigate -lundroj rreth botes circumspect -i matur circumscribe -rrethoj circumstances -rrethana
Com- co- col- con- cor-	Me, sëbashku	combine ⁹³ coeditor collateral conference corroborate
Contra- contro-	Kundër, kontra	contravene contraband
De-	De,zh	debase -perul decadence -dekadence depreciate - zhvleresohet
Demi-	Gjysmë	demigod demiglace
Di-	Di, dy	Dilema
Dia-	Dia	diagonal diameter diabolical
Dis- Dif-	Dis	differ differentiate discord

⁹³ Te gjitha fjalët me parashtesa të gjuhës angleze janë të pasqyruara me përkthim në fjalorthin anglisht-shqip në fundin e punimit. Më lart sillen disa prej tyre për të ilustruar me shumicë prefikset angleze..

Dys-	Dis	dysfunctional dysentery = diarrhea
Extra-, extro-	përtej, jashtë	extracurricular curriculum extraterrestrial extrovert
Hyper-	mbi, tej, hiper	hyperbole hyperventilate hyperactive
Hypo-	Hipo	hypoglycemia hypodermic hypochondriac
In, il, im, ir-	Jo-; Pa-; mos-; ç-	inefficient inarticulate illegible impeccable irrevocable
Inter-	Inter, ndër	intervene international interjection
Intra-, intro-	Intra	intramural introvert introspection examination
Macro-	Makro	macrobiotic macrocosm
Mega-	Mega	megalomania megaton
Meta-	Meta	metamorphosis

Mis-	Mis	misdemeanor mischance
Mono-	Mono	monarchy-monarki

		monotheism-monoteizem
Multi-	Multi	multifarious multitudinous
Neo-	Neo, i ri	neologism
Non-	Mos, pa, jo	non-acceptance=Mospraním; mospëlqím
Ob- oc- of- op-	Kundër	obstruct occlude offend opponent
Olig-		oligarchy
Pan-	Pan	panacea, panorama
Para-	Para	parallel paraphrase
Per-	Per	permeable pervade
Peri-	Peri-, rreth-	perimeter periphery
Poly-	Poli	polyglot
Pre-	Para	preamble, premonition
Prim-	Prim	Primordial, primogeniture
Pro-	Pro	propulsive proponent
Proto-	Proto	prototype
Pseudo-	Pseudo	pseudonym
Re-	Ri	reiterate reimburse

Retro-	Retro	retrospect
Se-		secede seclude
Semi-	Gjysmë	semiconscious conscious
Sub- suc suf sug sup sus	Nën	subjugate succumb suffuse suggjest suppress suspend
Super-, sur-	Super	supernatural surtax surcharge
Syn- sym syl sys		synchronize sympathize syllogism system
Tele-	Tele	telegraphic telescopic
Trans-	Trans	transport transcontinental
Ultra-	Ultra	Ultraviolet
Un-	(ç-,sh-,z-,zh-pa-)	uncertain-i pasigurt
Under-	Poshtë	underling understudy
Uni-	Një	unison
Vice-	Zëvendës	viceroi vice-president
With-	Me	Withstand

Parimisht, gjuha angleze i merr njësitë e saj leksikore të reja nga proceset krijuese të brendshme si përbërja dhe prejardhja. Duhet theksuar fakti që parashtesimi është më pak i favorizuar nga sistemi morfologjik i anglishtes sesa prapashtesimi. Marchand jep këtë përkufizim në lidhje me parashtesat e gjuhës angleze: “Parashtesat konsiderohen si morfema të lidhura të cilat u paravendosen morfemave të lira apo rrënjëve”. Në një sintagmë të caktuar AB parashtesat mbajnë pozicionin A; normalisht ato funksionojnë si përcaktuese të rrënjës B të cilës i parashtesohen.”⁹⁴.

Parashtesat e gjuhës angleze përdoren kryesisht në proceset e tipit fjalëformues të prejardhjes, që do të thotë se ato u japin një kuptim të ri fjalës së cilës ato i parashtohen duke e kthyer atë në një tjetër klasë fjale. Megjithatë, në shumicën e rasteve nuk ka asnjë ndryshim në klasën e fjalës⁹⁵.

Megjithëse parashtesat e gjuhës angleze ndajnë shumë veçori të përbashkëta, gjuhëtarët nuk e kanë parë dhe aq të lehtë ti grupojnë ato të gjitha bashkë sipas një mënyre të përgjithshme dhe llogjike, pasi vetë termi prefix ka ngjallur diskutim midis gjuhëtarëve të gjuhësisë angleze.

Sipas Marchand, nuk mund të jepet një përkufizim i qartë për termin prefix që të mund të bien dakord të tërë gjuhëtarët. “Kështu, disa gramaticienë e konsiderojnë parashtesimin si pjesë të mënyrës fjalëformuese të kompozimit. Përkufizimi që i bëhet termit *prefix* sipas fjalorit të Oxfordit (OED) përfshin çdo nyje parashtuese, por përdor termin formë e përbërjes për parashtesa të ndryshme pa dhënë asnjë përkufizim tjetër”.⁹⁶ Pra këto janë vetëm dy nga shumë përkufizime të tjera për termin *prefix*.

Sipas një klasifikimi të bërë në bazë kriteresh etimologjike, morfologjike dhe të kuptimit, parashtesat angleze grupohen në: a.Parashtesa etimologjike, historike; b.Parashtesa morfologjike, formale; c. Parashtesa semantike.Marchand i ndan parashtesat angleze historike në dy nëngrupe vendase, autoktone dhe jo vendase, pra me origjinë të huaj.⁹⁷

Grupi i parë përfaqëson pakicën liston këto 6 parashtesa:**a-, be-, fore-, mid-, mis-** dhe **un-**, ndërsa grupi i dytë që ja kalon në numër parashtesave vendase, është me origjinë greko-romake.⁹⁸ Gjuhëtarët kanë grupuar parashtesat në bazë tiparesh të përbashkëta si psh: karakteristika të ngjashme fonologjike, morfologjike, dhe semantike.

5.2 Veçori dhe klasifikime të parashtesave angleze

Gjuhëtarët kanë grupuar parashtesat angleze në bazë tiparesh të përbashkëta si psh: parashtesa me karakteristika të ngjashme fonologjike, morfologjike, dhe semantike:

⁹⁴ Marchand, Hans,1969, ”The categories and types of present-day English word-formation (2-nd edition), f 129

⁹⁵ Kortmann, Bernd. Linguistik: Essentials. Berlin: Cornelsen Verlag, 1999, pg 52.

⁹⁶ Marchand, Hans,1969, ”The categories and types of present-day English word-formation (2-nd edition) f 129

⁹⁷ Marchand, Hans (1967) Expansion, transposition and derivation. La linguistique 1, 13-26

⁹⁸ Marchand, Hans The Categories and types of present day English word formation(1969): Synchronic and diachronic approach. University of Alabama press; f129.

Duke u bazuar ne tiparet e ngjashme fonetike, ndajshitesat angleze klasifikohen ne dy kategori:
a) në grupin e parë përfshihen parashtesa të cilat nuk i sjellin asnjë ndryshim fonetik rrënjës së cilës i parashtohen *stress-neutral affixes*;

b) në grupin e dytë përfshihen parashtesa të cilat sjellin ndryshime fonetike rrënjës së cilës i parashtohen, *non-neutral affixes*⁹⁹.

Pjesa dërrmuese e parashtesave angleze i përkasin kategorisë së parë, d.m.th nuk kanë theksim dhe as nuk shkaktojnë të tillë në rrënjën ku parashtesohen.

Megjithatë, Marchand pohon se një pjesë e parashtesave të gjuhës angleze janë të theksuara si p.sh.: parashtesat **be-** në fjalën **becloud** – mbuloj me re, errësoj, ose **un-** si në **unoriginal** ose **unpack**.¹⁰⁰ Francis Katamba sugjeron një listë të parashtesave angleze të theksuara dhe të patheksuara¹⁰¹. Prefikse angleze të patheksuara fonetikiisht (stress-neutral prefixes).

be- (formon folje të parashtesuara me kuptimin e përgjithshëm rreth, përreth)

p.sh.: *beset-rrethoj*, përfshij, *besmear- lyros*, fëlliq, *becloud- mbuloj me re*

co-/con-com-së bashku, bashkë:

co-operate: bashkëpunoj, *co-habit*: bashkëjetoj, *co-appear*: bashkëshfaqet, *combine*: kombinoj, *conspire*-konspiroj, komplotoj

ex- ish: *ex-miner*:ish minator, *ex-wife*: ish bashkëshorte, *ex-leader*: ish udhëheqes, *ex-director*: ish drejtor, *ex-pupil*:ish nxënës, *ex-pilot*: ish pilot.

mis-keq:

mis-understand: keqkuptoj, *mis-manage*: keqmenaxhoj, *mis-read*: keqlexoj, *mis-inform*: keqinformoj

mal(e)- keq:

Malcontent: i pakënaqur, *malpractice*: i keqpërdorur, *maladjusted*: i keqpërshtatur, *malefactor*: keqbërës, *malevolent*: keqdashës.

re- ri, përsëri

re-think, *re-take*, *re-play*, *re-examine*, *re-issue*

⁹⁹ Katamba, Francis. English Words. London: Routledge, 1994; f. 62

¹⁰⁰ Marchand, Hans. The Categories and Types of Present-Day English Word-Formation. A Synchronic-Diachronic Approach. Munchen: Beck'sche Verlagbuchhandlung, 1969; f.139.

¹⁰¹ Katamba, Francis. English Words. London: Routledge, 1994.f. 62-63

un-pa, jo

unexciting: i pakënaqur, *unhappy*: i pa lumtur, *uncomfortable*: i parehatshëm, *unëise*:jo i zgjuar, *unmanageable*: i pa menaxhueshëm, *uncool*: jo I ftohtë

dis- (i parashtesohet mbiemrave):

dishonest:i pandershëm, *dishonourable*: çnderues, *discomfortable*: i parehatshëm

dis- (i parashtesohet foljeve)

Disalloë: nuk lejoj, *disagree*: nuk bie dakord, *disapprove*: nuk miratoj, *dislike*: nuk pëlqej, *disaffirm*: mohoj, anulloj, *disbelieve*: nuk besoj, *disarm*: çarmatos

in- (i parashtesohet mbiemrave)

Inarticulate: I pa artikuluar, *inactive*: jo aktiv, *inept*: i pa vend, *inevitable*: i pashmangshëm, *intangible*: i pa prekshëm, *innumerable*: i panumërt

un- (i parashtesohet mbiemrave)

Unoriginal: jo origjinal, *unusual*: i pa zakontë, *unseemly*: i paturpshëm, *unripe*: i papjekur, *unpleasant*: i pakëndshëm, *unsavoury*: i neveritshëm, *unreliable*: jo të besueshme

un- (i parashtesohet foljeve)

i.e. undo, unblock, unpack, unravel, unpick, unseat, unroll, unsaddle.

Prefikse angleze të theksuara fonetikisht (*non-neutral prefixes*)¹⁰²

Tabela 3 - Prefikse angleze të theksuara fonetikisht

Theksi mbi prefiksin (Emer)	Theksi mbi rrokjen e parë të rrënjës (folje)
`conduct	con`duct
`contract	con`tract
`convert	con`vert
`digest	di`gest

¹⁰² Katamba, F, English Words: Structure, History, Usage. Routledge, 2005, f. 69.

`export	ex`port
`import	im`port
`permit	per`mit
`preserve	pre`serve
`project	pro`ject
`present	pre`sent
`produce	pro`duce
`reject	re`ject
`subject	sub`ject
`survey	sur`vey
Theksi mbi prefiksin (mbiemer)	Theksi mbi rrokjen e parë të rrënjës (folje)
àbstract	ab`stract
`perfect	per`fect
`present	pre`sent

Gjithashtu, Marchand sugjeron se një pjesë tjetër e parashtesave angleze pasi parashtesohen, shkaktojnë theks në mes të fjalës. Vetëm parashtesat **a-**, **be-**, **em-**, **en-**, janë zakonisht të patheksuara fonetiki dhe mund të përjashtohen nga rregulli.

5.3 Veçoritë morfologjike të parashtesave angleze

Parashtesat angleze nga ana morfologjike zakonisht u parashtohen klasave përkatëse të fjalëve, p.sh.: parashtesa in- u parashtohet klasës së mbiemrave. Parashtesa të caktuara u parashtesohen vetëm emrave. Një grup tjetër parashtesash u parashtohen mbiemrave ose foljeve. Por jo gjithmonë është kaq e thjeshtë, pasi ka parashtesa të cilat u parashtesohen në më shumë se një klasë të caktuar fjalësh.

Parashtesa **dis-** duke ju paravendosur foljes figure formon foljen **disfigure**-shfytëroj; duke ju paravendosur mbiemrit dishonest- i pandershëm, ose i paravendoset emrit **dishonesty**-pandershmeri. Një tjetër shembull është parashtesa un- e cila mund të formojë mbiemër (unfair) - i padrejtë, folje (undo)-çbëj ose emër (unemployment)-papunësi.

Edhe pse pjesa më e madhe e parashtesave angleze kanë aftësinë për të formuar një fjalë të re përmes procesit të derivacionit, prejardhjes, ato zakonisht nuk e ndryshojnë klasën e fjalëve të fjalës së prejardhur, p.sh.: to rewrite = write-rishkruaj; uneasy= easy- e pa lehtë¹⁰³.

¹⁰³ Tietze, Godhard O. A.Einführung in die Wortbildung des heutigen Englisch. Typen und Prozesse. Tübingen: Max Niemeyer Verlag, 1974, f.41.

Ka vetëm disa parashtesa në gjuhën angleze të cilat ndryshojnë kategorinë gramatikore si p.sh.: parashtesa **en-** e cila i paravendoset klasës së mbiemrave duke formuar folje..p.sh.: **En-** paravendoset mbiemrit **large** duke formuar foljen **enlarge-** zgjeroj, zmadhoj.

Parashtesa **de-** e cila i paravendoset klasës së emrave duke formuar folje. **De-** i paravendoset emrit **frost** - acar, ngrice dhe formon foljen **defrost** - shkrij; ose sjellim shembullin bark - **debark**-shkarkoj, zbarkoj.

Parashtesa **a-** i paravendoset foljeve ose emrave duke formuar mbiemrat predikativë si p.sh mbiemrin **ablaze-** në flakë. Sjellim gjithashtu rastin e parashtesës **be- bethink** - mendoj veten.¹⁰⁴

Në rastet e parashtesave angleze **a-** dhe **be-** Lenski nuk është shumë i sigurtë nëse ato janë gjithmonë ndajshitesa pasi sipas tij ato priren të marrin më shumë funksionin e parafjalëve si p.sh. në rastin e fjalëve **ashore** - drejt bregut ose në shembullin belie - shtrihem afër apo underlie-shtrihem poshtë.¹⁰⁵

Siç u përmend dhe më lart, përveç përjashtimeve si p.sh.: **en-/em-, be-,** dhe **de-**, pjesa dërrmuese e parashtesave angleze nuk kanë asnjë ndikim mbi klasën e fjalëve të prejardhura.

Shpesh ato emërtohen si ndajshitesat kryesuese për shkak të pozicionit kryesues që mbajnë në fjalë. Gjuhëtari i gjuhësisë angleze R. Lieber dhe gjuhëtarë të tjerë të anglishtes kanë vënë re se edhe funksione të tjera përcaktuese të parashtesave angleze ndaj ruajnë atë pozicion në fillim të fjalëve.¹⁰⁶

Stekauer pohon se parashtesat angleze shoqërohen me kuptime të caktuara semantike, megjithëse kuptimi i tyre zakonisht është i paparashikuar. Parashtesat angleze klasifikohen semantikisht duke u bazuar në tipare semantike të përbashkëta si më poshtë: parashtesa me kuptim negativ, të kundërt, mohues¹⁰⁷.

Fjalët e prejardhura që mbartin kuptim negativ zakonisht formohen nga parashtesa të tilla si **in-, non-, or un-** si p.sh.: emrat **inactivity, nondelivery, unkindness**, por ka edhe paravendosje ndaj mbiemrave dhe foljeve gjithashtu¹⁰⁸. Megjithatë, Stekauer vë re një tjetër ndryshim brenda këtij grupi. Ndërsa fjalët e parashtesuara me prefiksin **un-** kanë kuptime negative tejet të veçanta dhe ndonjëherë të paparashikuara, fjalët e parashtesuara me prefiksin anglez **non-** mbartin kuptim më transparent, dhe të parashikueshëm¹⁰⁹. Sjellim shembujt më poshtë:

unattractive - jotërhëqës; i pabukur;

¹⁰⁴ Lenski, Daniel. 2000. "The Status of Etymology in the Synchronic Morphology of English" f 4.

¹⁰⁵ Lenski, Daniel. 2000. "The Status of Etymology in the Synchronic Morphology of English" f 4, 5.

¹⁰⁶ Stekauer, Pavol. English Word-Formation. A History of Research (1960-1995), f.254.

¹⁰⁷ Tietze, Godhard O. A.Einführung in die Wortbildung des heutigen Englisch. Typen und Prozesse. Tübingen: Max Niemeyer Verlag, 1974; f.47.

¹⁰⁸ Tietze, Godhard O. A.Einführung in die Wortbildung des heutigen Englisch. Typen und Prozesse. Tübingen: Max Niemeyer Verlag, 1974; f.47.

¹⁰⁹ Stekauer, Pavol. English Word-Formation. A History of Research 2000. f 203.

unauthentic - joautentík; i rrémë;

unauthenticated- i paligjësúar; i palegalizúar;

unauthorized -i paautorizúar;

unavailability- padispunueshmëri, pavlefshmëri,

unavailable- i padisponúeshëm;

unavailing - i padobíshëm;

unavoidable - i pashmángshëm.

unavowable - i parrëfyeshëm.

unawakened - i pazgjúar; që s'është zgjúar.

unaware - i padítur; i panjoftúar

Sipas Stekauer kuptimi i fortë mohues i parashtesës **non-** *mos, pa jo*¹¹⁰, është karakteristikë për këtë parashtesë, ndryshe nga parashtesa **un-** *pa, jo* ku ky kuptim është më i zbutur. Këtë ide mund ta shikojmë edhe në shembujt e fjalorit anglisht-shqip të hartuar nga leksikologu Pavli Qesku, i cili në fjalorin e tij 70 000 fjalësh sjell shembullin **unimportance**, të përkthyer si rëndësi e paktë, ku vihet re kuptimi i zbutur i parashtesës **un-**. Më poshtë sjellim shembuj të fjalëve të parashtesuara me parashtesën **non-**:

non- *parasht.* Mos-; pa-; jo- :

non-acceptance- mospraním; mospëlqím

non-activity – mosveprím

non-adjustable-e paregjistrúeshme, parregullúeshme

non-admission - mospraním; moslejím.

non-aggressive -joagresív; mossulmúes.

non-alcoholic – joalkoolík ;

¹¹⁰ Fjalori me 70 000 fjalë dhe 250 000 referenca i Pavli Qeskut, 2000, 1331, jep këto kuptime për parashtesat non- dhe un-. **non-** *mos, pa jo*; **un-** *pa, jo, anti*. Për të formuar folje që shprehin veprim të kundërt në shqipe kemi ç-, sh-, zh-, z. P.sh, unbalance- çekuilibroj, zbalancoj; unearth- zhvarros; unclasp-zbërthej;b) mbiemra: un- (pa), anti, kundër, jo: unacceptable- i papranueshëm, unpatriotic –antipatriotik, unprofessional-joprofesional.

non-belligerent - mospjesëmárrës;

nonchalance-moskokëçárje; shpërfíllje;

non-effective - i paeféktshëm; i pavléfshëm.

non-arrival - Mosmbërrítje; mosparaqítje.

non-attendance - Mospjesëmárrje; mungésë.

Gjithashtu, edhe parashtesa angleze **dis-** si në shembullin **disbelief** mund të përfshihet në grupin e parashtesave me kuptim negativ apo mohues, edhe pse kjo parashtesë herë-herë paraqet edhe kuptime mohues ose reversativ.

Në grupin e dytë të parashtesave do të përfshihen prefikset angleze me kuptim reversativ. Titze pohon se parashtesat të cilat kanë kuptim reversativ zakonisht i japin fjalës kuptimin të kundërt si p.sh.: **dis- disappear** – zhduk ose **de- decentralize- deçentralizoj**. Megjithatë, parashtesat **dis-** dhe **de-** mund të kenë edhe kuptim negativ ose privativ gjithashtu.

disrespectful - i parespékt; i parespektúeshëm.

dissimilarity -Pangjashmëri; ndryshím;

disregard – Shpërfíll;

dissatisfy- Lë të pakënaqur (*dikë*); i shkaktój pakënaqësi (*dikujt*).

dissatisfied- i pakënaqur.

disproportion - shpërpjesëtím; mospërpúthje.

disagreement- mosmarrëveshje

disappear –zhdukem

disappearance-zhdukje

disapproval-mosmiratim

deactivate - çaktivizoj

decompress – çngjesh, dekomprimoj

depopulate – shpopulloj

depopulation – shpopullim

decentralise - shpërqendroj, decentralizoj

decivilization -primitivizim; shqytetërim.

declassification- heqje nga lista e rezervuar.

declassify-heq nga lista e rezervuar.

decode – dekodoj, deshifroj.

Sipas Marchand, edhe nga shembujt e marra më lart është më se e qartë se nuk është gjithmonë e lehtë ti gruposh bashkë ndajshitesat sipas vecorish të përbashkëta pasi kuptimet e parashtesave nuk janë të ndara kategorikisht. Në shumë raste, të njejtat afikse mund të shprehin kuptime krejt të ndryshme në varësi të rrënjëve të cilat u paravendosen.¹¹¹

Një pjesë parashtesash nuk përfshihet në asnjërin nga grupet e lartpërmendura duke shprehur nocione të ndryshme si parashtesa “co-” në kuptimin “së bashku” tek fjala *co-pilot* (bashkëpilot), “mal-“ me kuptimin “e gabuar, e keq” si *mal-administration* (keqadministrim), apo parashtesa “mis-” me kuptimin “e gabuar” si *misaligned* (i rreshtuar gabimisht), apo parashtesa “pseudo-” me kuptimin “false” *pseudo-writer* (shkrimtaruc),¹¹² apo “under-” me kuptimin “ul vlerën” si *underrate* (nënvlerësoj), apo parashtesa “vice-“ me kuptimin “në vend të” si *vice-president* (nënpresident, apo zëvendësues i tij). Pjesa më madhe e parashtesave nuk e ndryshojnë kategorinë sintaksore të rrënjëve të tyre, por veprojnë thjesht si “modifiers” (plotës, rrethanor). Për më tepër mund të vërehet se parashtesat mund t’i ngjiten disa kategorive sintaksore si foljeve, mbiemrave, apo emrave dhe nuk ndikojnë në theksin e rrënjëve ku parashtohen.

5.4 Zhvillimi i parashtesave angleze

Është për tu theksuar fakti që një pjesë e konsiderueshme e prefikseve angleze të cilat përdoren gjerësisht edhe në anglishten e sotme nuk janë vendase, por të huazuara nga gjuhë të tjera me të cilat anglishtja ka patur kontakte përgjatë shekujsh. Numri i parashtesave autoktone angleze është shumë më i vogël se sa mund të mendohet. Sipas Marchand ka vetëm gjashtë parashtesa angleze autoktone që janë: **a-, be-, fore-, mid-, mis-, and un-** .

Marchand shprehet se këto parashtesa origjinën e tyre e kanë nga fjalë të cilat më parë kanë qenë morfema të lira, të pavarura¹¹³.

Nëse shqyrtojmë përdorimin e parashtesave angleze përgjatë viteve, na duhet të pranojmë që përdorimi i tyre sot është bërë shumë më i rrallë se në kohët e mëparshme.

¹¹¹ Marchand, Hans. The Categories and Types of Present-Day English Word-Formation. A Synchronic-Diachronic Approach. Munchen: Beck'sche Verlagbuchhandlung, 1969. f.135.

¹¹³ M. archand, Hans. The Categories and Types of Present-Day English Word-Formation. A Synchronic-Diachronic Approach. Munchen: Beck'sche Verlagbuchhandlung, 1969. f.129

Sipas Marchand kjo vjen për shkak të prirjes për të formuar sa më shumë fjalë të prapashtesuara. Që nga anglishtja e vjetër e deri më sot, parashtesat lokative të cilat, të parashtuara foljeve nuk vendoseshin më përpara, por pas foljeve, duke bërë kështu uljen e përdorimit të parashtesave.¹¹⁴

Parashtesat mund të klasifikohen gjithashtu edhe në bazë të shkallës së prodhimitarisë:

a) në parashtesa shumë prodhimitare, b) prodhimitare dhe c) jo prodhimitare.

Parashtesa **a-** pikun e prodhimitarisë së saj e pati në shekullin e 19-të dhe tani është shumë pak produktive.

Parashtesën **be-** në anglishten e sotme e gjejmë nga ana formale dhe stilistikore tejet të kufizuar.

Parashtesa **mis-** duke u përzier me parashtesën frënge **més-** rilindi sërish për sa i përket prodhimitarisë. Në shekullin e 20-të rezultonte pak prodhimitare në procesin fjalëformues.

Parashtesa **un-** mbetet shumë prodhimitare, sidomos kur i paravendoset mbiemrave¹¹⁵. Për më tepër, Bauer pohon se humbja e madhe e prodhimitarisë së parashtesave angleze në poçeset fjalëformuese, gjë që është një karakteristikë e Anglishtes së sotme për pjesën dërrmuese të parashtesave autoktone, herët a vonë do të rezultojnë në zhdukjen e plotë të tyre. Përfundimisht sipas Bauer bën vetëm parashtesa **-un**.¹¹⁶

Megjithatë, kur ka një ulje nga njëra anë e procesit, patjetër që do të ketë një ngritje nga ana tjetër. Rrjedhimisht hasen gjithmonë e më shumë parashtesa të huaja, të cilat përgjatë viteve, janë tërësisht të njehsuara në sistemin e gjuhës angleze.

Lenski pohon se ka një rritje të parashtesave jo vendase me origjinë frënge, latine, e greke të cilat përgjatë viteve janë integruar totalisht në sistemin gjuhësor të anglishtes. Parashtesat gjermanike sipas Lenskit kanë përgjithësisht prodhimitari të ulët, përveç parashtesave **- un-, under-, over-, fore-** dhe **out-** të cilat mund të lidhen me rrënjë latine e jo latine.¹¹⁷

5.5 Mbizotërimi i parashtesave të huaja

Anglishtja e sotme mund të përcaktohet me siguri si një gjuhë e përzierë, pasi ajo ka pranuar dhe huazuar njësi leksikore të shumta nga gjuhë të ndryshme dukë i integruar në sistemin e vet gjuhësor. Fluksi më i madh i fjalëve vjen nga gjuha frënge, latine, dhe greke për shkaqe të përmendura në kapitujt e mëparshëm.

¹¹⁴ Marchand, Hans. The Categories and Types of Present-Day English Word-Formation. A Synchronic-Diachronic Approach. Munchen: Beck'sche Verlagbuchhandlung, 1969. f.131.

¹¹⁵ Bauer, Laurie. 2003. English Prefixation; A Typological Shift; accessed 20th of July, 2005; f.34.

¹¹⁶ Bauer, Laurie. 2003. English Prefixation; A Typological Shift; accessed 20th of July, 2005; f.35.

¹¹⁷ Lenski D. The Status of Etymology in the Synchronic Morphology of English December 7, 2000; [http://myxo.css.msu.edu/dlenski/academic/pdf.\(01/02/2013\);f.5](http://myxo.css.msu.edu/dlenski/academic/pdf.(01/02/2013);f.5).

Nën-sistemi i fjalëformimit në veçanti ka qenë tepër i ndikuar. Shumë nga parashtesat si *ante-*, *extra-*, dhe *para-*, të cilat përdoren më së shumti sot në anglishten shkencore, kanë origjinën e tyre në latinishten moderne. Për më tepër, gjuha angleze përdor format latine ose greke si p.sh.: *circum-*, *intra-*, or *hyper-*. Këto forma mund të jenë gjithashtu parashtesa, edhe pse në latinisht mund të përdoren si fjalë më vetë të pavarura (edhe si pjesëza apo parafjalë).¹¹⁸

Për sa i takon morfologjise, një pyetje shumë interesante që shtrohet është nëse të gjitha parashtesat me karakter latin, janë përfshirë plotësisht në gjuhën angleze dhe nëse mund ti bashkëngjiten jo vetëm fjalëve autoktone, por edhe rrënjëve jo autoktone. Në lidhje me këtë çështje Plag shprehet se morfemat e lira dhe afikset apo ndajshitesat mund të kombinohen vetëm nëse tiparet e tyre etimologjike janë të përputhshme. Pra, për të përgjigja në lidhje me pyetjen e ngritur nuk është positive. Morfemat e gjuhës angleze klasifikohen ose si [+ Latinate], cka do të thotë se mund të lidhen me morfema latine, ose si [- Latinate], d.m.th nuk mund të lidhen me morfema latine¹¹⁹.

Shembuj të mirë të morfemave angleze të cilat lidhen më morfema me karakter latin janë parashtesat me origjinë latine **dis-** dhe **in-**; shembuj të rastit të kundërt mund të sjellim parashtesat gjermanike **a-** ose **for-**.

Ekziston edhe një mundësi tjetër ku një morfemë e lidhur mund të kombinohet më të tëra llojet e morfemave, pavarësisht gjuhës nga kanë hyrë. Këto morfema sipas Lenski janë mund të analizohen nga ana etimologjike, siç është rasti i parashtesave latine **arch-** dhe **co-**, ose i parashtesës greke **para-**.¹²⁰

Lenski ka grupuar parashtesat angleze sipas etimologjisë së tyre për të parë se si ato bashkëveprojnë me morfemat e lira.

Për sa i përket ndajshitesave me origjinë gjermanike, ato shquhen për një prodhimtari tepër të ulët. Përrjashtime bëjnë vetëm parashtesat **un-**, **under-**, **over-**, **fore-** dhe **out-** të cilat mund të lidhen edhe me rrënjë latine edhe jo latine¹²¹.

Këtë prodhimtari të ulët të parashtesave gjermanike Marchand ia atribuon fluksit masiv të parashtesave frënge që nga periudha e pushtimit norman dhe lëvizjes së pjesëzave lokative nga pozicioni i paravendosur në atë të prapavendosur rrënjës gjatë periudhës së anglishtes së mesme¹²².

Megjithatë, duhet pranuar fakti që prirja për një prodhimtari të ulët në procesin fjalëformues nuk mund të shikohet vetëm në parashtesat me origjinë gjermane, por kjo është një dukuri e cila

¹¹⁸ Marchand, Hans. The Categories and Types of Present-Day English Word-Formation. A Synchronic-Diachronic Approach. München: Beck'sche Verlagbuchhandlung, 1969. f.31,32.

¹¹⁹ Lenski D. The Status of Etymology in the Synchronic Morphology of English December 7, 2000; <http://myxo.css.msu.edu/dlenski/academic/pdf>. (01/02/2013); f.2.

¹²⁰ Lenski D. The Status of Etymology in the Synchronic Morphology of English December 7, 2000; <http://myxo.css.msu.edu/dlenski/academic/pdf>. (01/02/2013); f.2.

¹²¹ Lenski D. The Status of Etymology in the Synchronic Morphology of English December 7, 2000; <http://myxo.css.msu.edu/dlenski/academic/pdf>. (01/02/2013); f.5.

¹²² Lenski D. The Status of Etymology in the Synchronic Morphology of English December 7, 2000; <http://myxo.css.msu.edu/dlenski/academic/pdf>. (01/02/2013); f.4,5.

përfshin pak a shumë të gjitha parashtesat angleze. Edhe pse në anglishten e sotme ekzistojnë parashtesa prodhimtare në procesin fjalëformues parashtesor, sidomos parashtesat me origjinë frënge, përdorimi i tyre nuk është aq i shpeshtë sa çka qenë më parë. Shumë prej parashtesave prodhimtare romane si p.sh. **de-, dis-, re-** kanë hyrë në gjuhën angleze si rezultat i pushtimit norman.

Me romanizimin e sistemit të gjuhës angleze, i tërë sistemi i procesit të fjalëformimit në gjuhën angleze u rimodelua. Ndikimi i huazimeve frënge, ku përfshiheshin edhe ndajshitesat, nxorrën jashtë pozitës dominues afikset vendase angleze. Për sa i përket parashtesimit, parashtesat autoktone angleze nisën të përdreshin shumë më pak, duke i lënë vendin e parë përdorimit të parashtesave frënge, e më pas parashtesave me origjinë latine dhe greke. Kështu, në anglishten e sotme parashtesat jo autoktone përbëjnë pjesën dërrmuese të parashtesave angleze¹²³.

Gjuha angleze ka pësuar ndryshime të shumta me kalimin e kohës. Kështu nëse i referohemi veçorive fonologjike të parashtesave angleze mund të vihen re dy ndryshime të mëdha. Më parë parashtesat angleze ishin të patheksuara fonetikiisht ndërsa në anglishten moderne, ato janë fonetikiisht të theksuara duke shfaqur ngjashmëri me morfemat e lira.

Sipas Bauer një prirje e re që vihet re fjalëformimin e anglishtes moderne është orientimi drejt mënyrës fjalëformuese të kompozimit. Kjo vihet re edhe në faktin se elementët ndajshitesorë gjithmonë e më shumë po adoptojnë tipare të morfemave të lira.¹²⁴ Një prirje drejt mënyrës së kompozimit për fjalëformimin e gjuhës angleze është vënë re që në kohët më të hershme kur sistemi gjuhësor i anglishtes bazohej në gjuhën gjermane. Parashtesat e anglishtes të kësaj periudhe kishin pothuajse të njëjtat veçori si të morfemave të lira, duke zotëruar theks dhe kuptim.

Kur sistemi gjuhësor i anglishtes nisi të zhvillohej më tej, këto lloj parashtesash filluan të humbnin tiparet e tyre, edhe pse në anglishten e sotme kemi të bëjmë me një rishfaqje të pamohueshme të këtij tipi parashtesash.

Kështu, parashtesat nuk mbartin më vetëm kuptim gramatikor ose parashtesor, por edhe kuptime siç mbartin morfemat e lira si p.sh.: parashtesat *audio-, chloro-, kilo-, dhe petro-*.¹²⁵

Sipas Bauer pjesa më e madhe e parashtesave angleze shfaqin një nivel tepër të lartë pavarësie dhe nëse marrim për shqyrtim sistemin gjuhësor të anglishtes, nuk mund të mohohet fakti se ka një numër parashtesash të palidhura apo të lira si p.sh. parashtesa **extra-** të cilat sillen gjithmonë e më shumë si elemente të kompozitave.¹²⁶

extracurricular- jashtë programit shkollor

extrajudicial - jashtëgjyqësore

extramarital - jashtë martesor

extramural - jashtë qytetit

¹²³ Bauer, Laurie. 2003. English Prefixation A Typological Shift; accessed 20th of July, 2003,f.33.

¹²⁴ Bauer, Laurie. 2003. English Prefixation A Typological Shift; accessed 20th of July, 2003,f.33.

¹²⁵ Bauer, Laurie. 2003. English Prefixation A Typological Shift; accessed 20th of July, 2003,f.33.

¹²⁶ Bauer, Laurie. 2003. English Prefixation A Typological Shift; accessed 20th of July, 2003,f.37

extraterrestrial - jashtëtokësor
extratime - kohë shtesë
extraordinary - e jashtëzakonshme

Në mbështetje të kësaj ideje Marchand pohon se jo rrallë parashtesa të tilla të palidhura dhe të pavarura kanë dalë nga procesi i mënyrës fjalëformuese që në gjuhën angleze njihet si *clipping*, siç është rasti i parashtesës *mini*.¹²⁷ Sigurisht që të tilla ndryshime nuk ndodhin brenda një dite, por brenda një periudhe të gjatë kohore.

Një nga problemet më të mëdha që ka lindur si rrjedhojë e të tilla kalimesh Brenda sistemit fjalëformues është vështirësia për të dalluar ndërmjet parashtesave dhe elementeve të përbërjes. Ka shumë raste sipas Bauer kur nuk është e qartë nëse pjesëza përpara fjalës është parashtesë apo pjesë e kompozitës¹²⁸.

Në veprën e tij “Fjalëformimi i gjuhës angleze” studiuesi I. Plag bën një klasifikim të parashtesave angleze nga ana kuptimore, semantike.¹²⁹

Në grupin e parë sipas Plag përfshihet një grup parashtesash të cilat përcaktojnë sasinë e rrënjës tek e cila parashtohen si “uni-” (një), tek unicellular (njëqelizor), “bi” (dy) si biannual (që ndodh dy herë në vit), ose “di” (dy) si diglossia (dygjuhësi) (ose dy dialekte të përdorura së bashku), “multi” (disa) si multi-stage (shumë katësh), “poly-” (shumë) si polytechnic (politeknik), “semi” (gjysmë) si semifinal (gjysëmfinale), e “omni-” (tërë) si omniscient (i gjithë dijsëm), “micro-” (i vogël) si microcomputer (mikrokompjuter), “macro-” (i madh) si macrocrystalline (me kristale të mëdha), “hyper-” (më shumë seç duhet) si hypertension (hipertension), “under-” (jo i mjaftueshëm) si undercooked (i pa gatuar mjaftueshëm).

Në grupin e dytë përfshihet grupi i parashtesave vendore, sic i emërton ai locative, si “circum-” me kuptimin “around” (rreth) si circumambulate (vij qark), “counter-”, në kuptimin “against-” (kundra) si counter-intuitive (kundërintuitive), “endo-” me kuptimin “përbrënda diçkaje” si endogamy (martesë brenda fisit), “epi-” me kuptimin “mbi”epicycle (epicikël), “inter-” me kuptimin “ndërmjet” si inter-active (ndëraktiv), “intra-” me kuptimin “brenda”, “intra-” si intramural (brenda mureve), “para-” me kuptimin “së bashku me” si paramilitary (paraushtarak), “retro-” me kuptimin “mbrapsht” si retroaction (prapaveprim), “trans-” me kuptimin “përtej” si transoceanic (ndëroqeanic, përtej oqeanit).

Grupi i tretë i parashtesave angleze sipas Plag, përfshin parashtesat kohore të cilat shprehin nocione me kuptimin (përpara) si p.sh. “ante -, pre- dhe fore-” si në shembujt: antechamber-paradhomë, antedate – paradataj (vë një datë më të hershme), predetermine-paracaktoj, premedical, forefather-stërgjysh, foresee-parashoh, prearrange (paracaktoj), forecast (parashikoj) dhe me kuptimin (pas) “post” (pas -), si në shembujt: poststructuralism-poststrukturalizëm, postmodern-postmoderne, postcommunism (paskomuniste).

¹²⁷ Marchand, Hans. The Categories and Types of Present-Day English Word-Formation. A Synchronic-Diachronic Approach. Munchen: Beck'sche Verlagbuchhandlung, 1969; f.130.

¹²⁸ Bauer, Laurie. 2003. “English Prefixation ñ A Typological Shift?”; accessed 20th of July, 2005.f.37

¹²⁹ Plag, Ingo. Word-formation in English f 98-99.

Në grupin e katërt Plag përfshin një grup parashtesash që shprehin “mohim” (**a (an)-, de-, dis-, in-, non-, un-**). Brenda këtij grupi sipas nuancave kuptimore që ato mbartin vihen re nuance kuptimore negative, keqësuese, kundërshtore, përçmuese, privative, antonimike, përkeqësuese e përvulëse.

Megjithatë, ka edhe një grup parashtesash të cilat Plag nuk i përfshin në ndonjërin prej grupeve më lart që shprehin nocione të tilla si (keq, e gabuar) në parashtesën “**mal-**” si malfunction-keqfunksionim, malnutrition-kequshqyerja mal-administration (keqadministrim), apo parashtesa “**mis-**” me kuptimin “e gabuar” si **misaligned** (i rreshtuar gabimisht), apo parashtesa “**pseudo-**” me kuptimin “false” **pseudo-writer** (pseudo shkrimtar), apo “**under-**” me kuptimin “ul vlerën” si underrate (nënvlerësoj), apo parashtesa “vice-” me kuptimin “në vend të” si vice-president (nën-president, apo zëvendësues i tij) apo “co-” në kuptimin “së bashku”sin ë shembullin *co-author* (bashkëautor).¹³⁰

Gjithashtu, Plag pohon se pjesa më madhe e parashtesave nuk e ndryshojnë kategorinë sintaksore të rrënjëve të tyre, por luajnë rolin e plotësit apo rrethanorit “modifiers”. Për tu theksuar është fakti se parashtesat mund t’i paravendosen kategorive të ndryshme sintaksore si p.sh. foljeve, mbiemrave, apo emrave dhe nuk ndikojnë në theksin e rrënjëve ku parashtohen.

Në një nga gramatikat më të rëndësishme të gjuhës angleze “A comprehensive grammar of English language” parashtesat e gjuhës angleze klasifikohen si më poshtë:¹³¹

- 1) Parashtesat negative, si p.sh : a-,dis-, in-, non-,un-;
- 2) Kundërshtore ose mohuese, si p.sh: de-, dis-,un-;
- 3) Përbuzëse ose përçmuese, si p.sh: mal-, mis- dhe pseudo-;
- 4) Parashtesa të shkallës ose madhësisë, si p.sh.: arch-, co-, hyper-, mini-;
- 5) Parashtesa orientimi ose qëndrimi, si p.sh: anti-, contra-, counter-, pro;
- 6) Parashtesa të kohës dhe të rendit, si p.sh: ex-, fore-, post-;
- 7) Parashtesa të numrit, si p.sh: bi-, di-, poli-, etj.;
- 8) Parashtesa neoklasike të përziera, si p.sh : auto-, extra-, neo-,etj;
- 9) Parashtesa të konversionit, si p.sh : a-, be-, en/em-.

Ashtu si dhe në gjuhën shqipe, parashtesat angleze zakonisht nuk e ndryshojnë kategorinë gramatikore të fjalës tek e cila parashtohen, sic ka edhe nga ato që e ndryshojnë atë. Më poshtë paraqesim një listë parashtesash angleze të cilat nuk e ndryshojnë kategorinë gramatikore të fjalëve që u parashtohen.¹³²

Parashtesa angleze që nuk e ndryshojnë klasën gramatikore të fjalëve që u parashtohen.

a- \ei-, ´-, oe\ a, jo: amoral -amoral; aseptic-; atheist-ateist (n.).

¹³⁰ Plag, Ingo. Word-formation in English f 124.

¹³¹ Quirk Randolph, Sidney Greenbaum, Geoffrey Leech and Yan Startvick. 1985. A Comprehensive Grammar of the **English Language. London and New York Longman.f.** 1540-1542.

¹³² Zapata Becerra, A. A. (2000). “Handbook of general and applied linguistics.” f..20.

ante- \oentI-\ para: anteroom-paradhome; 'before, previous to': antenatal.

anti- \oentI-\ 1. kundër, anti, jo: antisocial-antisocial; antiseptic-antiseptik; 2. anti: anti-hero-anti-hero..

arch- \ ArtS-\ 'first, chief, head': archetype; archbishop.

audio- \Odi 'U-\ audio: *audiovisual-audiovizual; audio-frequency-audio-frekuencë.*

be-{bi } *parasht foljore*

1. formon folje nga folje. **Beset-** rrethoj. **Bespatter** - spërkat. **Bemoan** - vajtoj. Bespeak porosit (rroba). **Belabour-** mundoj ♦ (formon folje nga emra). **Becloud** -vesh me re. **Befriend-** bëj mik. **Beguile-** mashtroj.

Megjithatë, parashtesa **be-** formon folje edhe nga emra dhe mbiemra si p.sh. **befoul-** ndyj, fëlliq; **bedim** errësoj, **bejewelled** - me gurë të çmuar, **bewigged-** me paruke.

2. (~ + emër ose mbiemër =folje) me kuptimin *bëj*: **befriend-**bëj mik; **belittle-**pakësoj, zvogëloj. Nuk gjendet një parashtesë barazvlerëse në gjuhën shqipe për këtë parashtesë..

bi-{bai } parasht ♦ **dy-**; **bi-** (me dy elemente) **bicentenary** - dyqind vjeçar; **biennial** - dyvjeçar, **bilingual** - dygjuhësh.. Në gjuhën shqipe përvec parashtesës **dy**, përdoret edhe parashtesa angleze **bi** e cila është e huazuar në shumë raste sëbashku me fjalën, si. p.sh.:**bimolecular-bimolekular**, **bisexual-biseksual**, **bivalent-bivalent** etj.

by- {bai } *parasht afër, pranë* **by-dweller-** fqinj. **By passer-** kalimtar. **By-glance-** vështrim me bisht të syrit, **by-door** - derë anësore. **By-work** - punë plotësuese; punë e rastit; **by-effect** em efekt anësor (i mjekimit); **by-election** em pol zgjedhje plotësuese. Nuk gjendet një parashtesë barazvlerëse në gjuhën shqipe për këtë parashtesë.

co- {bai } parasht bashkë: **cohabit** - bashkëjetoj; **co-author-bashkëautor**; **co-operate-bashkëpunoj**;

de-{di } parasht **ç-; sh-; zh-;de-** ; **deactivation** – çaktivizim; **depopulate-shpopulloj**; **defrost-shkrij**; **defuse-çaktivizoj** (një bombë etj.); **ul** (tensionin).

dis- {dis} parasht **Pa-, ç-; zh-; mos-**, **disability** – paaftësi, **disbelief-** mosbesim;**disorder-çrregullim**; **disagreement-mosmarrveshje.**

equi- \ikui-, ekui-\ i njejtë, **equivalent-ekuivalent.**

Ex- {eks} parasht **ish**, 1. nga: **exclaim-thërras**; **extract-shtrydh,nxjerr.** 2. \eks-\ **ish**: **ex-ëife-ish** gruaja, **ex-president-ishpresidenti.**

extra- \ekstra\ parasht jashtë: **extracurricular-ekstra kurikulare.**

fore- \for-\ parasht përpara, para: foresee-parashikoj; foretell-parathem.

hyper- \haip´r-\ **hyper-** parasht hiper, mbi, tej, hyperbole-hiperbolë, hypercritical -me kërkesa të larta, hypersensitive-i mbindjeshëm. Përveç parashtesave të tjera të shqipes, përdoret edhe parashtesa e huazuar hiper.

in- parasht mohore (para **b, m, p -im**; para **l -il**; para **r -ir**) Pa-; mos-; ç-; **inaction**-mosveprim.
incalculable- i pallogarítshëm.

inter- \Int´r-\ ndër: international-ndërkombëtar; interplanetary-ndërplanetar.

intra- intro-\Intr´-\ intra, brenda: intravenous- intravenoz; introspection - introspekt.

mal- {mæl} parasht keq-. maladjustment- keqpërshtatje-; malnutrition-kequshqyerje.

mis- {mis} parasht Mos-; keq-; pa-. **mistrust-** mosbesím. **misbelieving**-mosbesúes.

misapprehension- keqkuptím, **misbecoming-** i pahíjshëm, **misinformed -i** keqinformúar.

multi- \malti-\ shumë, multi?: multistage; multicolored-shumëngjyrësh.

neo- \nio\ neo, i ri : neologism-neologjizëm; neo-classical-neo-klasik.

non- {non} parasht **Mos-; pa-; jo- ; non-acceptance**-mospraním; mospëlqím.

non-activity-mosveprim ; **non-adjustable**-pajisje e paregjistrúeshme.

out{aut} parasht ♦ (formon pjesoren e disa foljeve): **outlying** i largët. **outspread** i shtrirë.

♦ (formon emra nga folje) **outbreak** shpërthim

♦(formon emra nga emra) **out-building** aneks i ndërtesës

♦ (formon folje nga folje); **outdistance** kaloj, lë prapa; **out-act** kal luaj më mirë se dikush; ia errësoj lojën dikujt.

over- parasht **tej-, mbi- stër, tepër-** ; over-active- tepër aktiv, over-anxiety-shqetësim i tepruar

pan- \poen-\ ‘all, throughout’: panchromatic; pan-African.

photo- \fotou\ photoelectric-fotoelektrik, photocopy-fotokopjoj;photogenic-fotozhenik.

physi(o)- \fizio- physiotherapy-fizioterapi; physiology-fiziologji.

poly- \poli-\ poli, shumë: polygamy-poligami; polysyllabic-shumë rrokësh.

post- \post\ ‘post, pas: postscript; posthumous; post-graduate.

pre- \pri-\ pre, para: prefabricate-parafabrikat; premature-prematur; pre-recorded-pararegjistruar.

pro- \pro-\ pro: pro-Chinese; pro-revolutionary.

proto- \protou\ proto: prototip; protoplasm-protplazëm.

pseudo- \sudou-\ pseudo: pseudonym-pseudonim; pseudo-intellectual-pseudo-intelektual.

psycho- \saikou- psiko: psychiatry-psikiatri; psycho-analysis-psiko-analizë.

quasi- \kuazi-\ kuazi, gjysmë, gati, pothuaj: quasi-serious; quasi-explanation-gjysmë shpjegim.

re- \ri-\ përsëri: re-echo; reinstate.

retro- \retrou-\ ‘prapa, retro: retrospective-retrospektiv; retro-rocket-raketë frenimi.

self- \self-\ ‘vetë, auto: self-taught-autodidakt; self-service-vetë shërbim.

semi- \semi-\ ‘gjysmë’: semi-circular-gjysmërrethor; semi-detached-shtëpi me një mur të përbashkët; semi-final-gjysmë finale.

Sub {sΛb} parasht **nën; pranë; sub-**; subalpine-zonë subalpine, nënalpine, subclass-nënklasë, nëngrup.

super- \sup´r-\ mbi, tej: super-structure-super strukturë; superego-mbiuni.

trans- \troenz-\ 1. ‘trans’: transatlantic-transatlantik; trans-continental-transkontinental,

transplant-transplant; transform-transform.

tri- \trai-\ ‘tre’: triangle-trekëndësh; tricolor-tringjyrësh.

un- \an-\ - parasht ♦ (për të formuar folje që shprehin veprim të kundërt) **ç-; -sh; z-; -zh; pa unabashed-** i padrúajtur; i patúr; unable-i paaftë; untruth-e pavërtetë, uncover-zbuloj; unpack-çmbështjell.

under- \and´r-\ parasht pa-; më pak: **under-craft** -Hilé, **under-produce** - Prodhóje më pak se (kapaciteti), **under-production** -Prodhím i dóbët (i pamjaftúeshëm), **under-representation**-Përfaqësím nën nivélin e dúhur.

uni- \juni-\ uni, e njejtë: uniform-uniformë; unisex-uniseks.

up- \ap-\ ‘lart, sipër’: uphill-rrugë e përpjetë, malore; upgrade-ngre në përgjegjësi dikë.

vice- \vais-\ zëvendës: vice-consul-zv konsull; vice-president-zëvendës president.

ultra- \øltr'-\ 'ultra: ultraviolet-ultra-violet; ultra-liberal-ultra-liberal.

Parashtesa angleze që ndryshojnë klasën gramatikore të fjalëve që u parashtohen.

Table 4 - Parashtesa angleze që ndryshojnë klasën gramatikore të fjalëve që u parashtohen

Parashtesa	+	Emër	=	Ndajfolje
A-	+	Bed	=	Abed (në shtrat)
A-	+	Sleep	=	Asleep (i përgjumur)
Be-	+	Friend	=	Befriend (zë mik)
En-	+	Danger	=	Endanger (rrezikoj)
Em-	+	Power	=	Empower (fuqizoj)
A-	+	Field	=	Afield (në fushë)
A-	+	Blaze	=	Ablaze (i përflakur, i ndezur)
A-	+	Singing	=	Asinging

Parashtesa	+	Mbiemër	=	Folje
Be-	+	Little	=	Belittle (zvogëloj)
En-	+	Large	=	Enlarge (zmadhoj)

Parashtesa të anglishtes që u parashtohen fjalëve jo të parme për të formuar fjalë të kuptimta:

ab- \eb-, ʼb-\ ‘jo, pa : *absent-mungues; abnormal-jo normal.*

ad- \ʼd-, oed-\ ‘drejt’: *advance-përparim; adjoin-jam ngjitur.*

aero- \ero-\ ‘aero’: *aerodinamik.*

ambi- \oembi-\ ‘dy: *ambiguous-mëdyshje.*

an- \oen-, ʼn-\ ‘, jo, pa’: *anaesthetic-jo estetik; anonymous-anonim.*

anthropo- \antropo-\ antropo: *anthroopoid; anthropology.*

astro- \oestrou-\ astro: *astronomy;astronaut.*

biblio- \blbio-\ : *bibliography; bibliophile.*

bio- \baio-\ ‘bio’: *biography;biology; biotic.*

centi- \sentI-\ ‘me kuptimin një qind’: *centigrade;centimeter.*

chrono- \kron ʼ-\ ‘krono: *chronology; chronometer.*

con-, col-,com-, cor- \kʰn-, kʼn-; kʼl-; kʰm-, kʼm-; kʰr-,kʼr-\‘me kuptimin me, së bashku’:
conduct; collaborate;combine; correlate.

contra- \kontr ʼ-\ ‘against; opposite to’: *contraception;contradict.*

demi- \demI-\ ‘gjysmë’: *demimonde; demigod.*

di- \daI-, dI-\ ‘dy, di’: *dilemma; dioxide.*

dia- \daI ʼ-\ ‘me kuptimin përmes’: *diameter; diagonal;diaphragm.*

electro- \llektrou-\ ‘elektro :*electrocute; electromagnet.*

geo- \dZio-\ ‘gjeo’: *geography; geology.*

hemo-,haemo- \hemou ʼ-\ ‘ me kuptimin gjak, hemo’: *hemoglobin; hemorrhage.*

hetero- \heterou\ ‘tjetri, i ndryshëm’: *heterogeneous; heterosexual.*

homo- \homou-\ ‘i njëjti’: *homogenous; homosexual.*

hydro- \haIdro´-\ ‘hidro’: hydrant; hydro-electric.

macro- makrou\ ‘makro’: macrocosm;macrobiotic.

matri- \moetrI-, meItrI-\ ‘me kuptimin mama’: matriarch; mat-ricide.

mega- \mega-\ 1. ‘mega’: megalith. 2. ‘one million’:megaton.

micro- \maikro)- 1. ‘mikro’: micro-film; microëave. 2.micro-scope; microphone.

milli- \mili-\ e një mijëta, : milligram; millimeter.

mono- \mono-\ ‘mono’: monosyllable; monotone.

neuro- \nUr´-\ neuro: neuralgia; neurology.

ortho- \Orto´-\ : orthodox; orthopaedic.

paleo-, palaeo- \poeli´-\ : paleolithic; paleontology.

patri- \peItrI-,poetrI-\ ‘me kuptimin baba’: patriarch; patricide.

phono- \fono ‘fono’: phonetic; phonology.

socio- \sosiou- ‘socio’: sociology; socio-economic.

sym-, syn- \sIm-, sIn-\ : sympathy; synchronize.

techno- \tekno\ ‘tekno’: technocracy; technology.

tele- \tele\ ‘tele’: telepathy;television.

theo- \teo\ ‘që ka lidhje me Zotin’: theocracy; theology.

thermo- \termo-\ ‘termo’: thermostat; thermometer¹³³.

5.6 Parashtesimi në gjuhën shqipe

Parashtesimi është një nëntip i veçantë i formimeve ndajshesore, krahas prapashtesimit dhe prapashtesimit, pesha e të cilit është relativisht e kufizuar, e vogël në krahasim me dy të parat. Prejardhja parashtesore është mënyra e formimit të fjalëve të reja përmes parashtesave, të cilat bashkohen me fjalë ose tema fjalësh, p.sh.: mosbesim, stërgjysh, i pavlefshëm, çarmatos, mbiçmoj etj. Këto fjalë janë të formuara përkatësisht me anë të parashtesave mos-, stër-, pa-, ç-, mbi-, nga fjalët besim, gjysh, i vlefshëm, armatos, çmoj; ose përbalt, përbuz, përgjak, mburr,

¹³³ <http://prefixes-suffixes.com/numerical-prefixes.html>

shfaq, etj., të formuara përkatësisht me anë të parashtesave për-, m-, sh-, nga temat balt-, buzë-, gjak-, burr-, faq-, të emrave: baltë, buzë, gjak, burrë, faqe.¹³⁴ Parashtesat e gjuhës shqipe, si sasi, janë rreth një e treta e prapashtesave dhe, veç kësaj, nuk e kanë prodhimtarinë e këtyre të fundit.

Megjithatë, parashtesimi është një nga mënyrat më të rëndësishme e më të gjalla të fjalëformimit të shqipes. Ne vepren “Parashtesat e gjuhës shqipe”, A. Xhuvani përfshin 82 parashtesa, disa prej të cilave nuk përdoren më sot e rreth 168 prapashtesa¹³⁵. Kështu, duke qenë se parashtesimi në gjuhën shqipe është zhvilluar në lidhje të ngushtë me përngjitjen nga njëra anë dhe kompozimin nga ana tjetër, “Gramatika e gjuhës shqipe” sugjeron analizën e motivimit të fjalës për të bërë dallimin mes një togu parashtesor apo përngjitje, p.sh.: fjala *nëntokë* (shtresa e dheut që ndodhet në sipërfaqen e tokës) motivohet me togun *nën tokë*, dmth *nën tokë* ruan vlerën e saj parafjalore, kurse *nëngrup* nuk mund të motivohet me një tog të tillë; parashtesa *nën* këtu tregon thjesht marrëdhënie të pjesës (*nën*) ndaj së tërës (*grup*). Pra, në rastin e parë kemi të bëjmë me përngjitje, në rastin e dytë me parashtesim.

Kur fjala ruan treguesin rasor, p.sh., *i paraluftës, paradite, pasdite, pasdreke*, përngjitja del edhe më e qartë. Këtu nuk mund të flitet për parashtesim, pasi për parashtesat nuk është karakteristike të bashkohen me një emër në trajtën e një rase të zhdrejtë.

Siç e përmendëm dhe më lart, lidhjet e parashtesimit janë tejet të ndërlikuara edhe me kompozimin. Ka një numër fjalësh, elementi i parë i të cilave përdoret në gjuhë edhe në mënyrë të pavarur, si ndajfolje ose si parafjalë si p.sh.: para-, prapa-, pas-, jashtë-, brenda-, larg-, lart-, pranë-, sipër-, etj., p.sh.: paraburgim, paracaktoj, paradhomë, paramendim, parandiej, parandjenjë, parafjalë, parapëlqej, pararojë, parashikoj, parashkollor, prapaskenë, prapashtesë, prapaveprues, pasardhës, pasnesër, jashtëzakonisht, i jashtëligjshëm, i brendashkruar, largpamës, largpamje, pranëvendosje, i lartpërmendur, sipërfaqje, sipërmarrës, sipërvendosje, etj. Gramatika e shqipes sugjeron këtë rregull për të bërë ndarjen midis parashtesimit e kompozimit “kur pjesa e dytë është një folje si p.sh. (parashikoj) ose një emër vepruesi (pasardhës), pjesa e parë ka plotësisht vlerë ndajfoljore dhe fjala është një kompozitë. Kur gjymtyra e dytë nuk është emër vepruesi por një emër tjetër ose mbiemër, caktimi i mënyrës së fjalëformimit paraqitet më i vështirë. Në këtë rast elementi i parë i fjalës mund të ketë gjithashtu vlerë ndajfoljore, p.sh. *praparojë*- fjalë për fjalë: “ajo që është prapa skene” e në këtë rast kemi të bëjmë mënyrën parashtesuese.¹³⁶ Parafjala në këtë rast ka kaluar në parashtesë dhe ka krijuar një ose disa tipa fjalëformimi. Mënyra e përngjitjes nuk mund të konsiderohet në këtë rast, pasi emri që shërben si pjesë e dytë e fjalës është në rasën emërore të pashquar e jo në rrjedhore, siç do ta kërkonte parafjala. Në punimin “Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe”, gjuhëtari E. Hysa shpreh qartë dallimin e ngjashmërinë që ekziston midis kompozimit dhe ndajshitesimit, përse i përket mënyrës së formimit. Njësitë e formuara nga të dy mënyrat fjalëformuese, atë të kompozimit dhe parashtesimit, përbëjnë akte formimi, ndryshe nga njësitë e formuara me përngjitje, të cilat formohen përgjithësisht në procesin e përdorimit të gjatë të dy ose më shumë njësive pranë njëra-tjetrës.¹³⁷ Dallimi ndërmjet kompozimit dhe parashtesimit lidhet me elementët përbërës të njësive të formuara. Kështu në një kompozitë, elementet përbërëse janë

¹³⁴ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, f. 59

¹³⁵ A. Xhuvani / E. Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe, në: Vepra I, Tiranë 1980, f. 359-418 .

¹³⁶ “Gramatika e gjuhës shqipe”, Tiranë, 1995.

¹³⁷ E. Hysa, “Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe”, f.67.

pjesë të mëvetësishme të ligjërtarës, ndërsa në ndajshitesim vetëm njëri element është i mëvetësishëm nga pikëpamja e varësisë gramatikore. Megjithatë E. Hysa nuk përjashton rastet kalimtare me drejtim nga kompozimi në ndajshitesim, si p.sh.: bashkëjetoj, bashkëpunoj; dhe bashkëpunëtor, bashkëfshatar, bashkëfajësi etj.

Njësitë e formuara nga parashtesimi ngjasojnë më shumë me njësitë e formuara me përngjitje, por dallohen prej tyre nga mënyra e formimit. Duhet theksuar fakti se edhe këtu nuk përjashtohen rastet kalimtare me drejtim nga përngjitja në ndajshitesim, p.sh. përherë, përditë, etj. Rrjedhimisht parashtesimi në gjuhën shqipe si një nga mënyrat prodhimtare të fjalëformimit, është pasuruar dhe pasurohet me mjete të reja që vijnë nga kompozimi dhe përngjitja. Në punimin e tij në lidhje me çështjet e parashtesimit në gjuhën shqipe, E. Hysa shkruan për të ashtëquajtuarat gjysmëprefikset, gjysmëparashtesat ose prefiksoidet. Proçesi i formimit të njësive me këto elemente është quajtur gjysmëparashtesim (gjysmëprefiksim). Pseudoprefikse emërtohen ato elemente formimi, të cilat vijnë nga tema që në gjuhën prej nga vijnë kishin një kuptim në vetvete.¹³⁸ Si të tilla konsiderohen elementët *auto-*, *hidro-*, *mikro-*, *pseudo-*, *bio-*, *gjeo-*, duke formuar njësitë si p.sh.: automjet, autopark, autokritikë, autosugjestion, autobiografi, autoportret; hidroplan, hidrografi, hidroelektrik, hidrografi; mikrobiolog, mikrokozmos, mikroorganizëm, mikrofon, mikroskenë; pseudofilozof, pseudoaleat, pseudosocialist; biokimi, biologji; gjeografi, gjeologji, gjeometri; poliambulancë, politeist, polifoni e të tjera struktura të ngjashme si këto.¹³⁹ Prefiksoidet, të cilat më së shumti janë përshtatje e fjalëve të huaja nga gjuhët neolatine, përdoren gjerësisht në shqipen e sotme në fusha të ndryshme si p.sh. në publicistikë, në letërsinë teknike e shkencore.

E. Hysa i kushton vëmendje të veçantë edhe disa njësive të cilat kanë si element të parë një fjalë shqipe, e ngjashme jo vetëm nga pikëpamja e funksionit, por edhe nga përmbajtja me një formant fjalëformues parashtesor. Elemente të tilla për shqipen konsiderohen: *gjith-*, *gjysmë-*, *krye-*, *plot-*, *zëvendës-*, *vetë-*, të cilat u parashtohen njësive: *i gjithanshëm*, *i gjithmbarshëm*, *i gjithhershëm*, *gjysmëkafshë*, *gjysmëerrësirë*, *gjysmëperëndi*; *ishvila*, *ishpedagogu*, *ishkryetari*; *jashtëgjuhësor*, *jashtëshkollor*, *i jashtëzakonshëm*; *kryeinxhinier*, *kryerresht*, *kryemjek*, *kryemjeshër*, *kryesekretar*; *ndihmëministër*; *i shumanshëm*; *i plotfuqishëm*; *vetëshërbyes*, *vetëdashje*, *vetëmbrojtje*, *vetëpastrohëm*, *vetëqeverisje*, *vetëvrasje*, *vetëveprues*, etj.¹⁴⁰ Elemente të tilla quhen gjysmëparashtesa ose prefiksoidet, për faktin se ato fitojnë një kuptim përgjithësues kur u parashtohen temave të fjalëve. Pra, fitimi i karakterit përgjithësues të këtij elementi është një nga treguesit kryesor që tregon kalimin e tij në gjysmëparashtesë. Kalimi i këtyre temave nga gjysmëparashtesa në parashtesa arrihet atëherë kur nuk ka më asnjë lidhje kuptimore midis tyre dhe fjalëve përgjegjëse.

5.7 Parashtesat e gjuhës shqipe

Studiuesit të cilët janë marrë me studimin e parashtesave të shqipes, e kanë patur jo fort të lehtë konstatimin e shqyrtimin e tyre pasi kufijtë midis parashtesimit dhe përngjitjes si dhe

¹³⁸ Florica Dimitrescu, "Quelques aspects de la pseudoprefixation dans la langue roumaine actuelle", 1969, f.77.

¹³⁹ F.Podgorica, "Parashtesat e huazauara, në Kongresin e Manastirit, Shkodër, 1969, f.67.

¹⁴⁰ E. Hysa, "Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe", f.75.

kompozimit, nuk janë përherë të prera. Kjo problematikë e bën më të vështirë veçimin e këtyre elementeve formative nga fjalët bazë që janë formuar me to. Fryt i një kërkimi disa vjeçar është punimi “Parashtesat e gjuhës shqipe” i akademikëve Xhuvani e Çabej. Në shqyrtimin e secilës parashtesë ata janë fokusuar në tre aspekte kryesore atë etimologjike, historike e morfologjike. Kështu përveç anës gjeografike e etimologjike nëse kemi të bëjmë me një formant të gjuhës mbarë apo të ndonjë dialekti të veçantë, parashtesat janë parë edhe historikisht në përdorimin e tyre që nga shkrimtarë të vjetër. Gjithashtu, parashtesat e shqipe janë studiuar edhe nga ana morfologjike. Është gjurmuar përdorimi i tyre në kategoritë e ndryshme gramatikore, e më pas është shqyrtuar funksioni i tyre brenda këtyre kategorive. Në punimin “Parashtesat e gjuhës shqipe”, listohen me shpjegime 82 parashtesa të shqipes:

a-

Kjo parashtesë u vendoset përemrave dëftorë, përemrave të pacaktuar, disa mbiemrave e ndajfoljeve përemërore, duke i dhënë një kuptim deiktik të largësisë, p.sh.: aty, ata.

a-

Parashtesa a- është parashtesë në thelb me origjinë greke, me funksion privative, e cila ka hyrë bashkë me fjalët si p.sh. : apolitik, ateist, afazi. Kjo parashtesë është bërë pak productive, në ndonjë fjalë si psh afetar.

akë-

Kjo parashtesë vendoset para disa përemrave të pacaktuar dhe ndajfoljeve përemërore, p.sh. :akëcili, akësh, akëqish, akëku. Përdorimi i kësaj parashtese është i kufizuar në toskërishte.

anti-

Kjo parashtesë, e cila në thelb është me origjinë greke, vendoset para emrave e mbiemrave me kuptimin e kundërshtisë, e ngjashme me parashtesën kundër-. Kështu kemi antiajror (por edhe kundërajror), antibiotik, antifashist, antitezë etj. Shumica e fjalëve me parashtesën anti janë marrë të gatshme nga gjuhët e huaja, si p.sh antiparti, antipod, antipatik etj.

b(ë)-

Kjo parashtesë u vendoset emrave si bzhollë (bëzhollë), bushtër (b ushtër).

bashkë-

Parashtesa *bashkë-* mbetet një parashtesë shumë prodhimtare në gjuhën e shkruar. Është barazvlerëse e prefikseve con-, co-; bashkatdhetat, bashkautor, bashkëluftëtar, bashkëjetoj, bashkëpunoj, bashkërendoj etj.

c-

Parashtesa **c-** paraqet nje formë dialektore të parashtesës **s-** në kushte të caktuara shfaqet si **z-** ose **x-**, p.sh: cfurk për sfurk, ckerfyell për skërfyell, cmir për smir, cbuloj për zbuloj, cbut për zbut etj.

ciri-

Paraqitet si formant i gjuhës familjare e më fort i asaj feminare psh: cirikokë, cirivi etj. Është pak prodhimtare.

çurru-

Parashtesë e rrallë, vendoset para emrave, si psh currubij-kalamaj të vegjël.

ç-

Del si variant dialektor ish-, e cila mbizotëron në gjuhënë shumicën e fjalëve, dhe në kushte të caktuara paraqitet edhe si **zh-**, e si **xh-**: çfaros për shfaros, çqep për shqep, çkallmoj për shkallmoj etj. Në gjuhën letrare janë bërë normë trajtat me parashtesën **ç-** kur parashtesa ndiqet nga një zanore ose një bashkëtingëllore e tingullt (l, ll, r, rr, m, n, nj, j): çliroj, çlodhem, çregjistroj, çmësohem, çnderoj.

D(ë)

Kjo parashtesë vendoset pranë disa foljeve, duke dhënë një kuptim intensiv, p.sh: dëboj, dëfrej, dëkoj, etj. b) vendoset pranë disa foljeve me kuptim antonimik: dvishem, dvesh. c) vendoset pranë emrave si dëborë, dërrasë, dërrudhë.

e- parashtesë e rrallë, vendoset në këto dy fjalë esëll, egjellë.

Çarra- Çili- F-, Gë- Jo- K(ë)- Kaca- Kakë- Kala-, Kara- Kata, Katra- Ko-, koko- Koco- Kolo- Kollo- Ko(r)o- Kse- Ku-, kuku- Kundër- L(ë) M(ë)-, mb(ë)- Ma- Mbi-, Mi- Me- , Mos-, Ndaj-, N(ë)-, Nën-, ndën-, Nöpër-, ndër-,Nj-,një-, nji-, Pa-, O- Pa- , Pala-, Para-, Parë-, Pas-, mbas- , Për-, Përmbi-, përmi-, Pici-, Pili-, Po-, Prapa-, mbrapa-, Pre-, Pro-, Q-, që-, qi-, Që-, R(ë),Rr(ë), Ri-, S-, Skë-, skër-, Spër-, Stër-, Surru-, Sh-, Shala-, shara-, Shka-, shkala-, shkara-, shkarra-, Shpër-, Shtë- shtër-, Të, Tej-, te-, Tër-, Tu-, U-, V(ë), X-, Xh-, Z-, Zdër-,

Zh- Kjo parashtesë vendoset para emrave, foljeve e mbiemrave. Para emrash si zhgun (gunë), zhgjandër(andërr). Para foljesh a)me funksion intensitetizhbart, zhdam, zhdedh, etj; b)me kuptim antonimik zhdukem(dukem), zhvesh(vesh); c) me analogji zhdjerg(djerg).

5.7.1 Tiparet e parashtesave të gjuhës shqipe

Në lidhje me tiparet e parashtesave të shqipes, shtrohet pyetja nëse parashtesat kanë kuptim klasifikues, pra nëse e ndryshojnë ato kategorinë gramatikore të fjalës që i parashtohen apo jo.

Në lidhje me këtë çështje gjuhëtari J. Thomai¹⁴¹ shprehet se zakonisht parashtesimi nuk e ndërron kategorinë leksiko-gramatikore të fjalës. Megjithatë, ai sjell shembujt si *mposht* (nga ndajshitesa poshtë), apo *zbardh* nga mbiemri *i bardhë*, *mposht* nga ndajfolja *poshtë*, duke i njohur dhe një funksion klasifikues parashtesave. Gjithashtu, sipas “Gramatikës së gjuhës shqipe”, parashtesa përgjithësisht nuk ia ndërron kategorinë leksikogramatikore fjalës me të cilën bashkohet, por i jep asaj vetëm një kuptim të ri plotësues.¹⁴² Megjithatë, kjo vepër paraqet pak më poshtë disa fjalë, të cilat duke u bashkuar me parashtesën për të formuar fjalën e re, kalojnë në një tjetër kategori leksikogramatikore, si p. sh.: emra që kthehen në folje: *përbuz* nga *buzë*, *përbalt* nga *baltë*, *përdor* nga *dorë*, *përgjak* nga *gjak*, *përligj* nga *ligj* etj. Në këto raste parashtesa i ngjitet fjalës. Kur me anë të parashtesimit kalohet nga një pjesë ligjëruese në një tjetër, atëherë parashtesa i ngjitet temës së fjalës, (në këto raste tema e bjerr zanoren fundore të patheksuar që mund të ketë si p.sh.: mburr, shfaq, përgjak përmes parashtesave për-, m-, sh- nga temat buz, burr, faq, balt¹⁴³.

Ndërsa gjuhëtari E. Hysa i konsideron këto fjalë si formime parashteso-prapashtesore me prapashtesë zero duke ja lënë funksionin klasifikues vetëm prapashtesave.¹⁴⁴ E. Hysi është i mendimit se kuptim klasifikues kanë vetëm prapashtesat, pasi vetëm ato mund t'i sjellin ndryshim temës lidhur me përkatësinë e saj në ndonjë pjesë ligjëruese. Fjalë të tilla formohen përmes një formanti që gjuha shqipe e njej mirë në çështjen e fjalëformimit, formanti zero.

Një numër parashtesash, si: *sh-*, *zh-*, *ç-*, *s-*, *z-*, *m-*, *n-*, *stër-*, *shpër-* etj merren si të parme, por shumë parashtesa që janë sot shumë prodhimtare, kanë dalë prej fjalësh të tjera: prej parafjalësh si: mbi, ndër, në, nën, pa, për ose prej pjesëzash si: jo-, mos-, sapo-, porsa-, a posa. Kur kalojnë në parashtesa, sipas vjetërsisë së kalimit e sipas dendurisë së përdorimit me këtë funksion, ato, i dobësojnë lidhjet me kategoritë leksiko-gramatikore nga kanë dalë dhe afrohen me parashtesat e tjera të mirëfillta, duke fituar kuptime përgjithësuëse, karakteristike për ndajshitesat fjalëformuese. Gramatika e gjuhës shqipe sjell shembullin e parashtesës *mbi-* e cila është tepër prodhimtare në formimin e emrave jo me kuptim hapësinor të parafjalës mbi, por për të treguar shkallën më të lartë të asaj që emërton fjala motivuese, p.sh.: mbingacmim, mbilodhje, mbishpenzim etj.

Mjaft të ndërlikuara në gjuhën shqipe janë edhe lidhjet e parashtesimit me kompozimin. Ka një numër fjalësh, elementi i parë i të cilave përdoret në gjuhë edhe në mënyrë të pavarur, si ndajfolje ose si parafjalë, si p.sh. fjalë që nisin me para-, prapa-, pas-, jashtë-, brenda-, larg-, lart-, pranë-, sipër- etj p.sh.: paraardhës, parandiej, parandjnjë, paraburgim, paracaktoj, paradhënie, paradhomë, parafjalë, parapëlqej etj. Te këto shembuj kur pjesa e dytë është një folje (paracaktoj) ose emër vepruesi (pasardhës), pjesa e parë ka plotësisht vlerë ndajfoljore dhe kemi të bëjmë me një kompozitë.

Kështu në gjuhën shqipe për të bërë dallimin mes parashtesimit dhe përngjitjes duhet të merret parasysh natyra e motivimit të fjalës dhe natyra leksiko-gramatikore e elementit të parë.

¹⁴¹ J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2011, f. 172.

¹⁴² Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë 1995, f. 61.

¹⁴³ Fonetika dhe Gramatika e Gjuhës shqipe;”prejardhja parashtesore” f. 35.

¹⁴⁴ E. Hysa, Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II*, Tiranë, 1975, f. 62. dhe 79-80

Gjuha shqipe është një gjuhë e hapur dhe si e tillë ajo ka bërë pjesë të leksikut të saj një numër të madh fjalësh të huaja nga gjuhë të ndryshme. Në kuadrin e huazimeve duhet theksuar edhe fakti i depërtimit të një numri parashtesash të huaja. Podgorica ka mbledhur dhe analizuar në punimin e tij rreth 77 parashtesa të huazuara, ndonëse disa prej tyre është shumë e vështirë të dallohen pa ditur më parë se si janë formuar këto fjalë në gjuhën e huaj.¹⁴⁵ Elementët parashtesore janë huazuar nëpërmjet huazimit të fjalës në tërësi. E. Hysi shprehet se në shqipe nuk ka parashtesa të huazuara shprehurazi nga fjalët me të cilat bashkohet parashtesa, edhe pse ka raste kur një parashtesë e huaj bashkohet me një fjalë shqipe. Raste të tilla realizohen kur parashtesa e huaj shprehurazi prej fjalëve me të cilat bashkohet dhe duke u ndjerë si një formant fjalëformues me vete, bashkohet edhe me fjalë shqipe.¹⁴⁶ Formante fjalëformuese të huaja në gjuhën shqipe *a-*, *anti-*, *inter-*, *dis-*, (*dez-*), *super-*, *ultra-*, *trans-*, *pro-* etj. p.sh afetar, disproporcion, superprodhim, ultrareaksionar etj. Në rast se krahas fjalës me parashtesë përdoret në gjuhë edhe fjala motivuese e saj, p.sh.: anormal-normal; dezinfektoj- infektoj; disharmoni- harmoni, ose kur përdoren të paktën dy fjalë të prejardhura me po atë rrënjë, si shembulli importoj-eksportoj, atëherë parashtesat e huaja janë të dallueshme edhe nga pikëpamja e sistemit fjalëformues të shqipes.¹⁴⁷ Fjalë të tilla si anarki, intervistë, distinktiv, konstrukt, antagonist etj., që nuk i përmbushin kushtet e mësipërme, konsiderohen si fjalë të parme për gjuhën shqipe, edhe pse nga gjuhët që rrjedhin nuk janë të tilla.

Në punimin e tij “Disa çështje të parashtesimit të gjuhës shqipe, E. Hysi sjell shembuj të parashtesave të huaja të cilat dallohen lehtësisht brenda strukturës së fjalës, duke u veçuar nga fjalët me të cilat bashkohen, p.sh.: *a-*, amoral, anormal, apolitik; *anti-* antiajror, antifetar, antikombëtar, antipopullor, antishkencor, antihistorik, antipedagogjik, antiburokratik, antihitlerian; *inter-*, interlinear, interplanetar, interurban, internacional; *intra-*intramuskular; *super-* superelastik, supertradicional, superprodhim,superfitim, superfuqi.

Gjuhëtari M. Çeliku në punimin “Gramatika praktike e shqipes” rendit një listë parashtesash të huazuara, të cilat herë-herë janë zëvendësuar me parashtesa të tjera të shqipes; të tilla janë: **a-**, *an-*, *i-*, *anti-*, *de-*, *dez-*, *dis-*, *pro-*, *in-*, *pan-*, *inter-*, *auto-*, *super-*, *poli-*.¹⁴⁸

a-(me kuptim mohues)

normal **anormal** (jonormal), fetar **afetar** (jofetar), simetrik **asimetrik** (josimetrik), politik **apolitik** (jopolitik);

an- analfabet

in-/ i-

ireal, **imoral**, **illegal**, **inorganik**.

anti- (me kuptimin e kundërshtisë)

¹⁴⁵ F. Podgorica, Parashtesat e huazuara, në: *Kongresi i Manastirit*, Shkëdhër, 1969, f. 65 - 79

¹⁴⁶ E. Hysa, Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II*, Tiranë, 1975, f.76.

¹⁴⁷ Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, Tiranë, 1976, f.38.

¹⁴⁸ M.Çeliku,M.Karapinjalli, R.Stringa “Gramatika praktike e gjuhës shqipe”, Tiranë,2007,f 321.

antipopullor, antidemokratik, antinjerëzor, antikombëtar, antiajror (kundërajror), **antishkencor.**

De- (me kuptim të kundërt)

Deformoj (shformoj), **demobilizoj**(çmobilizoj), **degradoj**(zhgradoj), **decentralizoj.**

Dez-(me kuptim të kundërt)

Dezinfektoj-infektoj, **dezintegroj** (çintegroj)

Dis –(me kuptim të kundërt)

Harmoni – disharmoni

Nivel - disnivel

Pro-(me kuptim pranues, përkrahës)

Proamerikan, profashist

In-

Inorganic (joorganik)

Pan- (me kuptimin gjithë, mbarë)

Panballkanik, panafrikan

Ultra-(me kuptimin tepër, tejmasës)

Ultratingull, ultrareaksionar, ultraliberal

Inter-

Internacional-ndërkombëtar, interurban-ndërrurban

Auto-

Autobiografi, autokritikë, autooficinë, automjet

Super-

superprodhim, superstrukturë

Poli-

poliklinikë, polisemantik

Disa nga parashtesat e huaja janë asimiluar nga sistemi i fjalëformimit të shqipes në një shkallë të tillë, saqë kanë filluar të japin edhe formime të reja nga fjalë shqipe, p.sh.: afetar, antifetar, antipopullor, panshqiptar, pannjerëzor etj. Megjithatë, në gjuhën shqipe vihet re një prirje e zëvendësimit të parashtesave të huaja me parashtesa të shqipes si p.sh.: afetar-jofetar, antiajror-kundërajror, kundërgaz, demilitarizim-çmilitarizim, depolarizim- shpolarizim , internacional-ndërnacional, etj¹⁴⁹. Krahas parashtesave të huaja *inter-*, *anti-*, *super-*, kemi parashtesat vendase *ndër-*, *kundër-*, *përmbi-*.

Duke u bazuar në tiparet e mësipërme parashtesat e huaja në gjuhën shqipe klasifikohen në grupet e mëposhtme¹⁵⁰:

- a) Parashtesa të huaja që nuk janë bërë prodhimtare në gjuhën shqipe.
- b) Parashtesa të huaja që nuk janë bërë prodhimtare në gjuhën shqipe, por që përdoren me fjalë të huaja, që kanë përdorim të mëvetësishëm edhe në gjuhën shqipe.
- c) Parashtesa të huaja që nuk janë bërë prodhimtare në gjuhën shqipe dhe që përdoren me fjalë të huaja, të cilat nuk kanë përdorim të mëvetësishëm në gjuhën shqipe.

Përsa i përket analizës, p.sh strukturore, brendapërbrenda shqipes parashtesat e huaja do të njihen si parashtesa: a) kur janë bërë prodhimtare edhe në gjuhën shqipe, si p.sh.: superfuqi, antipopullor, etj); b) kur ekziston fjala bazë me përdorim të mëvetësishëm, p.sh: anormal; c) kur ekziston edhe një fjalë antonime me një njësi të dhënë, p.sh.import-eksport.

Kur komponenti i dytë nuk ka përdorim të mëvetësishëm, dmth nuk mund të ndahet nga gjymtyra tjetër si p.sh: afeksion, atom, aglutinacion, amnezi, abdikoj, abstraksion, anarki, amfib, pretencë, prefekt, etj, atëherë nuk mund të flasim për parashtesa të fjalëve.

Kjo analizë strukturore mund të bëhet edhe për disa formime të vjetra të shqipes që kanë në përbërjen e tyre një element rrënjor, i cili nuk ka përdorim të mëvetësishëm. Zbërthimi dhe analiza e këtyre njësive bëhet e mundur duke u bazuar në opozicionin binar të dy njësive me kuptim të kundërt, antonimik. Në shqipe sjellim shembujt e çifteve: *mbuloj/zbuloj*, *mbath/zbath*, *ngul/shkul*, *ngarkoj/shkarkoj*, *ngjesh/zgjesh*, *ngjis/shqis* etj. Përmes këtyre opozicioneve bëhet i mundur dallimi që në të dy gjymtyrët e opozicionit ka një parashtesë të lirë dhe një temë të lidhur.

¹⁴⁹ Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe”, f 38.

¹⁵⁰ Hysa, Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe, në: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II*, Tiranë, 1975, f.77.

KREU VI DUKURI DHE PROBLEME TË PËRKTHIMIT TË FJALËVE ME PARASHTESA

6.1 Përkthimi dhe kuptimi i fjalëve

Në përgjithësi, përkthimin mund ta përkufizonim si riformulimin e asaj që është folur apo shkruar në tekstin origjinal, me fjalët e një gjuhe tjetër. Ka disa parime që ndjekin këtë proces, i cili kryesisht lidhet me saktësinë, qartësinë dhe natyrshmërinë e përcjelljes së kuptimit, ideve, apo mesazheve të përkthyer. Është shumë e rëndësishme që lexuesit e tekstit të synuar ta pranojnë informacionin e përkthyer në të njëjtën mënyrë si edhe lexuesit e tekstit në gjuhën burimore. Vetëm nese arrihet të ndjehet kjo natyrshmëri dhe saktësi nga lexuesit, përkthimi mund të quhet i arrirë. Kjo gjë e bën përkthimin një veprimtari tejet sfiduese dhe ka vështirësi disa prej të cilave shfaqen gjatë këtij procesi pasi çdo gjuhë ka origjinalitetin e saj kur përshkruan botën, strukturën e saj morfo-sintaksore, e rregullat e saj gramatikore etj.

Nida and Taber pohojnë se përkthimi është ngushtësisht i lidhur me problematikën e gjuhës, kuptimit, dhe ekuivalenceës. Nga përkufizimi që sjellin Nida dhe Taber¹⁵¹ në lidhje me përkthimin, theksohet qartësisht idea që procesi i përkthimit nënkupton arritjen e ekuivalencës kuptimore në tekstin e synuar. Mona Baker thekson në mënyrë të veçantë termin *ekuivalencë kuptimore* pasi ai ka të bëjë me kuptimin e kaluar në tekstin e synuar¹⁵². Ky është rasti kur përkthyesit përballen me tekstin si njësi kuptimore në formën e një vargu fjalësh ose fjalish.

Problemi kryesor në procesin e përkthimit ka të bëjë me kuptimin ndërsa procesi është në zhvillim e sipër, jo thjesht përkthimi si produkt. Pra, është më se e qartë se problemi kryesor është kuptimi: nëse kuptimi i tekstit të gjuhës burimore është qartësisht i kaluar në tekstin e gjuhës së synuar.

Megjithatë, përkthimi nuk merret vetëm me kuptimin thjesht si njësi leksikore. Procesin e transferimit apo kalimit të idesë nga gjuha burimore në atë të synuar përfshin disa aspekte të diksionin, strukturën gramatikore, vendosjen e komunikimit si dhe kontaktin kulturor të tekstit të gjuhës burimore. Kuptimi i të dy teksteve, pra atij burimor dhe të synuar duhet të jetë i barazvlefshëm në të tëra aspektet e lartpërmendura.

Nida dhe Taber dallojnë dy klasifikime të ‘kuptimit’ në procesin e përkthimit, atë referencial dhe konotativ.¹⁵³ Të njëjtin klasifikim e gjejnë edhe në punimin e Magdy M. Zaky “Përkthimi dhe kuptimi”.¹⁵⁴ Zaky pohon se “ka një dallim midis kuptimit konceptor nga njëra anë dhe kuptimit konotativ, stilistikor nga ana tjetër”.

Me **kuptim referencial apo dinotativ** do të kuptojmë fjalën si symbol e cila i referohet një objekti, një procesi, një sendi abstrakt dhe relacioni. Zaky shprehet se kuptimi referencial njihet gjithashtu edhe si “kuptimi i referencës”, "kuptimi leksikor", "kuptimi konceptual", apo si

¹⁵¹ Nida, Eugene A and Charles R. Taber (1982). The Theory and Practice of Translation. Leiden: E.J. Brill, f.12.

¹⁵² Baker, Mona (1992). In Other Words, A Coursebook on Translation. London: Routledge, f32.

¹⁵³ Nida, Eugene A and Charles R. Taber (1982). The Theory and Practice of Translation. Leiden: E.J. Brill. f.56.

¹⁵⁴ Zaky, Magdy M. (<http://accurapid.com/journal/14theory.htm>) Translation and Meaning Las, f 47.

"kuptimi dinotativ".¹⁵⁵ Duke dhënë kuptimin referencial të fjalës, një përkthyes duhet të jetë i ndërgjegjshëm për dy tipe shënuesish që përdoren për të dhënë kuptimin e fjalëve, morfologjik dhe sintaksor.

a) Në disa raste, kuptimi i një fjale pëktohet nga struktura gramatikore. Në tabelën më poshtë janë paraqitur fjalitë ku kuptimi i fjalëve edhe pse identike në të dyja fjalitë, ndryshon në varësi të klasës gramatikore që i përket. Këtu paraqitet qartë se si klasa gramatikore përcakton kuptimin e fjalës dhe përkthyesi kurrsesi nuk mund të mos e konsiderojë.

Tabele 5 - Fjali ku kuptimi i fjalëve edhe pse identike në të dyja fjalitë

I		II	
1	He picked up a stone. * <i>Ai mori një gurë.</i>	1	They will stone him. * <i>Ata do ta godasin me gurë.</i>
2	He saw a cloud. * <i>Ai pa një re.</i>	2	The quarrel will cloud the issue.* <i>Grindja do ta mjegullojë, turbullojë çështjen.</i>
3	She has a beautiful face. * <i>Ajo ka një fytyrë të bukur.</i>	3	He will face the audience.* <i>Ai do të përballet me publikun.</i>
4	He fell in the water. * <i>Ai ra në ujë.</i>	4	Please, water the garden.* <i>Të lutem, ujite kopështin.</i>

b) Kuptimi i fjalëve gjithashtu përcaktohet edhe nga marrëdhënia me fjalët e tjera brenda fjalisë në një kontekst të caktuar. Me fjalë të tjera, sintaksa e fjalisë ndikon në ndryshimin e kuptimit të fjalës. Në tabelën më poshtë paraqesim disa shembuj se si ndryshon kuptimi i fjalës.

Tabele 6 - Shembuj se si ndryshon kuptimi i fjalës nëvarësi të sintaksës së fjalisë

I		II	
1	The horse runs fast.* <i>Kali vrapon shpejt.</i>	1	The water runs through the path. * <i>Uji shkon përmes rrugës.</i>
2	Your hand is dirty. * <i>Dora jote është pis.</i>	2	All hands up! * <i>Të gjithë duart lart!</i>

6.2 Kuptimi konotativ i fjalës.

Të kuptuarit e fjalës nuk ka të bëjë vetëm me kuptimin referencial të saj, por një përkthyes gjithashtu ka nevojë edhe për ti dhënë një nuancë emocionale asaj, e cila mund të jetë e fortë, e

¹⁵⁵ Zaky, Magdy M. (<http://accurapid.com/journal/14theory.htm>) Translation and Meaning Last updated, f 44.

dobët, positive, negative. Ky lloj kuptimi është ngushtësisht i lidhur me qëndrimin emocional të përkthyesit. Baker paraqet tre parimet kryesore që shoqërojnë kuptimin konotativ¹⁵⁶:

6.2.1 Problemi i mungesës së ekuivalencës

Probleme të tilla në nivelin e fjalës janë të lidhura sipas Baker me ndryshimet apo dallimet kulturore, në rastin kur nuk ekziston asnjë fjalë ekuivalente që përkon edhe në tekstin e gjuhës burimore, edhe në tekstin e gjuhës së synuar. Ndaj në këtë pikë shpaloset rëndësia e studimit dhe analizimit të hipotezës së relativitetit gjuhësor sipas të cilit, në dy kultura dhe gjuhë të ndryshme mungesat dhe deficiencat përkthimore janë të padiskutueshme.

6.3 Dallimet kulturore ndërmjet gjuhëve

Newmark jep këtë përkufizim për kulturën “Mënyrë jetese dhe manifestimet e saj të cilat janë karakteristike për një komunitet që përdor një gjuhë të veçantë si mjet të shprehjes”.¹⁵⁷ Disa fjalë të tekstit të gjuhës burimore mund të shprehin koncepte të cilat nuk mund të kuptohen në mënyrë absolute nga lexuesit e gjuhës që synohet të përkthehet. Koncepti mund të jetë konkret ose abstrakt, si psh nga fusha e besimit, traditave, apo dhe ushqimit.

Alejandra Patricia Karamanian pohon në punimin e saj “Përkthimi dhe kultura” se “ne nuk përballemi vetëm me fjalë të shkruara në një kohë, vend, situatë sociopolitike të caktuar; më shumë rëndësi ka aspekti kulturor i tekstit i cili duhet marrë shumë në konsideratë. Proçesi i transferimit, rikodimi përmes kulturave, duhet të përcaktojë rrjedhimisht ekuivalentet përkatëse të kulturës që i takon gjuha e synuar në mnyrë që të sigurojë besueshmëri në sytë e lexuesve të gjuhës së synuar.”¹⁵⁸

6.4 Përkthimi, strategjitë dhe metodat e përkthimit

Krings e përkufizon strategjinë e përkthimit si "plane potenciale të vetëdijshme të përkthyesit për zgjidhjen e problemeve konkrete të përkthimit në kuadër të një detyre konkrete përkthimore," ndërsa Segino¹⁵⁹ beson se ka të paktën tre strategji globale të përdorura nga përkthyesit: (a) përkthimin pa ndërprerje për aq kohë sa të jetë e mundur; (b) korrigjimin e shpejtë të gabimeve sipërfaqësore; (c) lënien e monitorimit të gabimeve cilësore ose stilistike të tekstit në fazën e rishikimit.¹⁶⁰

¹⁵⁶ Baker, Mona (1992). In Other Words, A Coursebook on Translation. London: Routledge, f. 17.

¹⁵⁷ Newmark (1988). A Textbook of Translation. Hertfordshire: Prentice Hall International, f.94.

¹⁵⁸ Karamanian, Alejandra Patricia (<http://accurapid.com/journal/19culture2.htm>), Translation and Culture updated on: 02/26/2005

¹⁵⁹ Seguinot, C. (1989). The translation process. Toronto: H.G. Publications, f 45.

¹⁶⁰ Krings, H.P. (1986). Translation problems and translation strategies of advanced German learners of French, f.18.

Për më tepër, Loescher e përkufizon strategjinë e përkthimit si "një procedurë potenciale të vetëdijshme për zgjidhjen e një problemi në përballje me përkthimin e një teksti, apo pjesë të tij."¹⁶¹ Siç pohohet dhe në këtë përkufizim, nocioni i ndërgjegjes është i rëndësishëm në strategjitë dalluese të cilat përdoren nga nxënësit apo përkthyes. Nderkohe, Bell dallon strategjitë globale (ato që kanë të bëjnë me tekstet në tërësi) dhe lokale (ato që merren me segmente të tekstit) dhe gjithashtu pohon se ky dallim rezulton nga lloje të ndryshme të problemeve përkthimore¹⁶².

Newmark bën dallimin ndërmjet metodave dhe procedurave përkthimore. Ai është i mendimit se, "ndërsa metodat përkthimore lidhen me tekstet në tërësi, procedurat e përkthimit zbatohen mbi fjalitë dhe njësitë më të vogla të gjuhës."¹⁶³ Sipas tij metodat kryesore të përkthimit janë:

- *Përkthimi i fjalëpërfjalshëm;*
- *Përkthimi literal*
- *Përkthimi semantik:*
- *Pështatja*
- *Përkthimi i lire*
- *Përkthimi idiomatik*
- *Përkthimi komunikativ.*¹⁶⁴

Gjithashtu Njemark mendon se ekziston një lidhje e fortë midis përkthimit "semantik" dhe atij "komunikues".¹⁶⁵ Çdo përkthim mund të jetë "më shumë, ose më pak semantik - më shumë, ose më pak komunikues - madje edhe një pjesë e veçantë apo fjali mund të trajtohet si përkthyer në mënyrë më komunikuese ose më pak semantike". Të dyja synojnë një "efekt të njëjtë."

Venuti mendon se strategjitë e përkthimit "përfshijnë detyrat themelore e të zgjedhurit të tekstit të huaj për t'u përkthyer dhe zhvillimi i një metodë për ta përkthyer atë." Për t'iu referuar strategjive të përkthimit ai përdor konceptet e familjarizimit dhe të bërjes të huaj¹⁶⁶.

Procedurat e përkthimit që Njemark propozon janë:¹⁶⁷

- *ekuivalentët kulturorë,*¹⁶⁸
- *ekuivalentët funksionalë,*
- *ekuivalentët përshkrues*
- *Transferimi:* është procesi i transferimit të një fjale të tekstit original në tekstin e synuar..¹⁶⁹

¹⁶¹ Loescher, W. (1991). Translation performance, translation process and translation strategies. Tuebingen: Guten Narr, f 8.

tepruar; **hyperphysical**-I mbinatyrshtë ; **hypersensitive**- i mbindjeshëm. Qasja morfologjike e semantike e njëjtë.

Hypo- element fjalëformues, me origjinë nga greqishtja me barazvlerëse hipo, nën. Sjellim shembujt e shkeputur: **hypochlorite**-hipoklorit ; **hypochondria**-hipokondri; **Hypocrisy**-hipokrizi; **hypocrite**-hipokrit. Qasja morfologjike e semantike e njëjtë. Element fjalëformues i huazuar.

Kilo- element fjalëformues, me origjinë nga greqishtja me barazvlerëse mijë, kilo-. Sjellim shembujt e shkeputur: **kilobyte** kilobajt ; **kilocycle** kilocikël; **kilogram** kilogram ; **kilohertz** em fiz kiloherc. Qasja morfologjike e semantike e njëjtë. Element fjalëformues i huazuar.

Out- parashtesë me origjinë nga anglishtja e vjetër. ♦ Parashitesë e cila formon pjesoren e disa foljeve: **outlying** i largët, **outspread** i shtrirë. ♦ (formon emra nga

folje) **outbreak** shpërthim ♦(formon emra nga emra) **out-building** aneks i ndërtesës

♦ (formon folje nga folje) **outdistance** kaloj, lë prapa.; **out-act** luaj më mirë se

dikush; ia errësoj lojën dikujt. Siç shihet nuk ka përqasje morfo-semantike.

On- parashtesë me origjinë nga anglishtja e mesme me kuptimin mbi. Sjellim shembujt: **onlooker**- shikues, spectator; **onrush**-vërshim, **sulm**; **onset**- fillim. Sic shihet nuk ka përqasje morfo-semantike.

Onto- parashtesë me origjinë nga *anglishtja e mesme*.- Sjellim shembujt: **ontogeny**-ontogjeni; **ontological** mb ontologjike; **ontology**- ontologji. Kjo parashtesë ka hyrë bashkë me fjalët e huazuarasiç shihet dhe nga shembujt e shkeputur.

Pan- parashtesë me origjinë nga *anglishtja e vjetër* Barazvlerëset e tyre në shqipe janë **pan-**; **gjithë- mbarë**.- Sjellim shembujt: **Pan-african** mb panafrikan; **Pan-american** mb panamerikan; **Pan-americanism** em panamerikanizëm; **Pan-anglican** mb pananglikan. Në të gjithë shembujt e shkeputur është përdorur prefiksi i huazuar i anglishtes Pan-. Qasja morfologjike e semantike është e njëjtë.

Para- element fjalëformues, me origjinë nga greqishtja me barazvlerëse **para-**; **përtej**-. Sjellim shembujt: **Parable** em let.shëmbëlltyrë; parabolë; **Paracetamol**-paracetamol; **Parachute**-parashutë; **Parachutist**-parashutist. Kjo parashtesë ka hyrë bashkë me fjalët e huazuara si shihet dhe nga shembujt e shkeputur.

Post- parashtesë me origjinë nga latinishtja Barazvlerëset e tyre në shqipe janë prapa-; pas-; prej -.- Sjellim shembujt: **postscript**-passhkrim; **postëar**- i pasluftës; **postnatal**-i paslindjes; **postmeridian**- i pasditës ; **postpone**-shtyj, lë për më vonë (në këtë rast folja e anglishtes e formuar me anë të prefiksit post- nuk ka një barazvlerëse në shqipe përse, përdoret folja shtyj për më

vonë.. Në të gjithë shembujt e tjerë të shkëputur është përdorur prefiksi barazvlerës i shqipes pas-. Qasja morfologjike e semantike është e njëjtë.

Pre- parashtesë me origjinë nga latinishtja Barazvlerësja e saj në shqipe është **para -**.

Sjellim shembujt: **Predict-** parathem; **prehistoric-** parahistorik; **Pre-ignition-**paradjegje; **Prejudice-**dëmtoj, cënoj, paragjykoj; **Preliminary-** paraprak; **Premature-** i parakohshëm. Prelude- fillim, prelude. Qasja morfologjike e semantike është e njëjtë. Ka dhe raste kur përdoret prefiksi i huazuar i anglishtes pre- si në shembullin prelude-preludë.

Pro- parashtesë me origjinë nga greqishtja. Barazvlerësja e saj në shqipe është pro-, përkrahës, partisan-; fil-; fil-. Sjellim shembujt : **pro-**English- anglofil, **procreator-**krijues, **procuration** ndërmjetësim, **proclaim-**shpall, deklaroj, **procession-** procession. Qasja morfologjike e semantike është e njëjtë, por ka dhe raste kur përdoret prefiksi i huazuar i anglishtes pro- si në shembullin **procession-** procession.

Psycho- parashtesë me origjinë nga greqishtja. Barazvlerësja e saj në shqipe është parashtesa e huazuar psiko-. Sjellim shembujt: **psychoanalyse** kal psikanalizoj, **psychoanalysis** em psikanalizë, **psychoanalyst** em psikoanalist, **psychologic (al)** mb psikologjik; i psikologjisë, **psychopathology** em mjek psikopatologji **Psychosis** em mjek psikozë, **Psychosomatic** em psiko-somatik, **Psychotherapy** em mjek psiko-terapi. Në të gjitha rastet është përdorur parashtesa e huazuar psiko-.

Pyro- parashtesë me origjinë nga greqishtja. Barazvlerësja e saj në shqipe është parashtesa e huazuar piro-; por edhe zjarr-. Sjellim shembujt e shkëputur: **Pyrogen** em farm pirogjen; **Pyrographic** mb pirografik; **Pyrography** em pirografi; **Pyrolator** em adhurues i zjarrit; **Pyromaniac** em piroman; **Pyroscope** em fiz pirooskop; **Pyrotechnic (al)** mb piroteknik **Pyrotechnics** em piroteknikë.

Re- parashtesë me origjinë nga latinishtja. Barazvlerësja e saj në shqipe është parashtesa e huazuar ri-; përsëri. **Reabsorb** kal ripërthith ; **React** jokal kundërveproj; kundërpërgjigjem; reagoj; kundërshtoj ; **Re-act** kal luaj përsëri; vë në skenë përsëri; përsërit një shfaqje ; **representation** pol përfaqësim.

Semi- parashtesë me origjinë nga latinishtja. Barazvlerësja e saj në shqipe është parashtesa e huazuar semi-; gjysmë-. Sjellim shembujt : **Semi-annual** mb gjysmëvjetor; gjashtëmujor.

Semi-automatic mb gjysmëautomatik **Semi-axis** sh axes em mek semiaks **Semi-barbarian** mb,em gjysmëbarbar ; **Semi-beam** em ndërt gjysmëtra ; **Semi-centenary** em pesëdhjetor. Qasja morfologjike e semantike është e njëjtë, por ka dhe raste kur përdoret prefiksi i huazuar i anglishtes.

Stereo- parashtesë me origjinë nga greqishtja. Barazvlerësja e saj në shqipe është parashtesa e huazuar stereo-. Sjellim shembujt **Stereocamera** stereoskopik **Stereochemistry-** stereokimi **Stereogram-**stereogram ; **Stereography** – stereografi, **Stereometer** - stereometër.

Sub- parashtesë me origjinë nga latinishtja. Barazvlerësja e saj në shqipe është parashtesa **nën;** **pranë-** ; **sub-**. Sjellim shembujt : **Subalpine**-nënalpine; **Subaquatic**-nënujor; **Subaqueous**-nënujor;

Subarctic-nënarktik; **Subastral**-nënyjor. Qasja morfologjike e semantike është e njëjtë.

Super- parashtesë me origjinë nga latinishtja. Barazvlerësja e saj në shqipe është parashtesa mbi-tej-. Sjellim shembujt : **superable** -i kapërcyeshëm **Superabound**-me shumicë **Superabundance** begati **Superabundant**- i begatë. Nuk kemi të bëjmë me përjasje morfo semantike në shembujt e shkëputur. Megjithatë, ka dhe raste kur përdoret prefiksi i huazuar i anglishtes p.sh. supermarket.

Sur- parashtesë me origjinë nga frengjishtja. Barazvlerësja e saj në shqipe është parashtesa mbi-. Sjellim shembujt : **Surbase**-kornizë e pedestalit, **Surcease**-pezullim, **Surcharge**- mbingarkoj (qasja morfosemantike e njëjtë.) **Surcoat** *em* pallto; zhgun; mantel mbi armature, **Surface**-sipërfaqe. Në shumë raste nuk kemi të bëjmë me qasje morfo semantike.

Sym- parashtesë me origjinë nga greqishtja; gjendet edhe **Syn** {sin}. Barazvlerësja e saj në shqipe është parashtesa huazuar sim-. Sjellim shembujt: **Symbiosis**–simpliozë; bashkëjetesë-, **Symbiotic**-simbiotik, **Symbol**-simbol, **Symbolics**-simbolikë, **Syndicalist**-sindikalist, **Syndicate**-sindikata, **Syndrome**-sindromë, **Synecdoche**-sinekdokë, **Synonym**-sinonim. **Syntax** -sintaksë.

Tele- parashtesë me origjinë nga greqishtja. Barazvlerësja e saj në shqipe është parashtesahuazuar tele-. Sjellim shembujt: **Telecamera** – telekamera, **Telecommunication**-telekomunikacion,

Teleferic-teleferik, **Telefilm**-telefilm.

Thermo- parashtesë me origjinë nga greqishtja. Barazvlerësja e saj në shqipe është parashtesahuazuar termo-. Sjellim shembujt: **Thermobarometer**-termobarometër, **Thermochemical** termokimik, **Thermochemistry**-termokimi, **Thermodynamic**-termodinamik, **Thermometer** termometër.

Trans- parashtesë me origjinë nga latinishtja. Barazvlerësja e saj në shqipe është parashtesa e huazuar trans-; tej-. Sjellim shembujt: **Transaction**-transaksion, **Trans-African** transafrikan, **Transalpine**-transalpin, **Transatlantic**-transatlantik, **Transparent**-transparent, **Transplant**-transplant, **Transport**-transport.

Turbo- parashtesë me origjinë nga latinishtja. Barazvlerësja e saj në shqipe është parashtesa e huazuar turbo-. Sjellim shembujt: **Turbo-motor**- turbo motor, **turbo-bloëer**-turboventilator, **turbo-prop**- aeroplan me turboheliqë, **turbo-pump**-pompë centrifugale, **turbojet**-aeroplan turboreaktiv.

Typo- element fjalëformues, me origjinë nga greqishtja me barazvlerëse parashtesën e huazuar **tipo-**. Parashtesa vjen e përkthyer bashkë me fjalën. Sjellim shembujt: **Typographer**-tipograf, **Typography**-tipografi, **Typology**-tipologji.

Vice- parashtesë me origjinë nga latinishtja. Barazvlerësja e saj në shqipe është parashtesa nën-; fjalët zëvendës; mëkëmbës. Sjellim shembujt: **Vice-admiral**-nënadmiral, **Vice-chairman**-nënkryetar,

Vice-chancellor-nënkancelar, **Vice-counsel**-nënkonsull, **Vice-dean**-zëvendësdekan. Shohim që qasja morfologjike e semantike është e njëjtë.

Përmes vjeljes shteruese nga fjalori anglisht-shqip, kemi bërë të mundur përpilimin e një fjalori specifik të fjalëve të ndajshësuar me parashtesa, të renditura alfabetikisht. Në pjesën dërrmuese është gjetur një barazvlerës i plotë me ngjashmëri morfo-semantike, çka do të thotë që për secilën fjalë të parashtesuar në gjuhën angleze, barazvlerësja në shqipe ka përqasje morfologjike dhe semantike të njëjtë, si p.sh impossible-i pamundur. Në raste të tjera na rezultuan barazvlerëse vetëm nga ana semantike.

Së fundi, vijmë në përgjigjen e pyetjes së shtruar në fillim të punimit tonë: Si i përgjigjet gjuha shqipe shumësisë së prefikseve angleze? A mundet dot shqipja edhe nën ndikimin e trysninë e tezës së relativizmit linguistik të përgjigjet me një barazvlerëse në shqipe çdo prefiksi apo njësi të ndajshësuar me parashtesë të anglishtes?

Pas një kërkimi të thelluar, përmes vjellesh në fjalorë dy gjuhësh, si edhe përmes një studimi korpusesh gjuhësor, ne arritëm në përfundimin se gjuha shqipe ka mundësi të mëdha morfologjike e semantike si dhe potencialin e plotë leksikor për tu përballur me çdo njësi të re apo formim të ri të ndajshësuar parashtesor.

Së pari përmes ndajshësës, prefiksit korrelativ apo parashtësës barazvlerëse, p.sh.:inter-ndër; anti-kundër etj.

Së dyti, përmes ndajshësave polisemike (polifunksionale) çka nënkupton se për dy a më shumë ndajshësata të anglishtes kemi vetëm një ndajshësë të shqipes, p.sh.: **sh-**, **zh-**. **ç -**.

Së treti, përmes ndajshësave të huaja që shqipja i huazon bashkë me fjalën; a) nga anglishtja së bashku me fjalën b) shqipja huazon nga gjuhët e tjera neolatine, prej të cilave ka marrë dhe vetë anglishtja.

PËRFUNDIME

Punimi ynë me temë “*Rreth relativizmit gjuhësor në formimet parashtesore në gjuhën shqipe dhe angleze*”, duke patur karakter krahasues vendos përballë njëra-tjetrës gjuhën angleze dhe ate shqipe, me qëllim gjetjen e ndikimit të relativizmit gjuhësor në proceset fjalëformuese e sidomos në atë ndajshesor parashtesor krahasimisht. Gjithashtu, ky studim synon trajtimin e problemeve të përkthimit që vijnë si rezultat i dallimeve në përgjithësi e në veçanti probleme të përkthimit të fjalëve të prejardhura me parashtesa. Fokusi i studimit tonë është të trajtojmë çështjen se si dhe sa mirë shqipja i përgjigjet shumësisë së prefikseve angleze, nën trysinë e parimeve të relativitetit gjuhësor, duke e studiuar atë krahasimisht.

Ndër çështjet kryesore të trajtuara gjatë kapitujve të punimit do të theksonim së pari trajtimin e hipotezës së relativizmit gjuhësor e ndikimin e saj në marrdhënien midis dy gjuhëve, atë shqipe dhe angleze. Eduard Sapir dhe studenti i tij Benjamin Lee Whorf ishin të parët të cilët hodhën dritë mbi studimet në lidhje me determinizmin gjuhësor aty rreth vitet '30-të. Kërkimi i tyre çoi në ngritjen e një pyetjeje të qenësishme: ‘a formëson gjuha mënyrën se si ne mendojmë?’ Teoria e tyre, e njohur gjerësisht si hipoteza e Sapir Uorfit përfshin parimin e teorisë së relativitetit gjuhësor që ka në themel të saj dy versione: a) Variantin e fortë të hipotezës, b) Variantin e dobët të hipotezës.

Sipas variantit të fortë të hipotezës njerëzit e perceptojmë botën vetëm përmes gjuhës që përdorin. Pra, gjuha formëson mendimin dhe botëkuptimin njerezor. Ndërkohe sipas variantit të dobët të hipotezës së relativitetit gjuhësor gjuha nuk përcakton në mënyrë absolute mënyrën se si njerëzit mendojnë, por strukturat e ndryshme gjuhësore ndikojnë duke na drejtuar të perceptojmë dhe interpretojmë botën në mënyra të ndryshme, në mënyrën se si i qasemi problemeve dhe mbajmë mend faktet. Pjesa dërrmuese e gjuhëtarëve kundërshtojnë fuqishëm versionin e fortë të hipotezës së relativizmit, pasi ky variant i fortë i relativizmit nuk njih asnjë prej dukurive siç janë dygjuhësia (bilingualizmi), shumëgjuhësia (multilingualizmi), dhe përkthimin.

Çajka e konsideron mundësinë që marrëdhënia midis gjuhës dhe mendimit jo vetëm formëson perceptimet tona në lidhje me realitetin, por që e kundërta mund të ndodhë edhe në faktin që realiteti mund ta formësojë gjuhën e përdorur nga individët në idiolektet dhe sociolektet e tyre. “Gjuha dhe shoqëria janë aq shumë të ndërlidhura sa që është e pamundur të kuptosh njërin pa tjetrën. Nuk ka asnjë shoqëri njerëzore që nuk varet, nuk është formuar dhe nuk e formëson vetë gjuhën¹⁷⁶. ”

Ajo çka duhet patur parasysh në lidhje me relativizmin gjuhësor, në mënyrë që të mund ta mirë përdorim jo vetëm në përkthime, por edhe në analizimin e teksteve, janë dy parimet kryesore të relativizmit gjuhësor: determinizmin gjuhësor dhe relativitetin gjuhësor. Sipas parimit të determinizmit gjuhësor, procesi i të menduarit përcaktohet nga gjuha, ndërkohe që relativiteti gjuhësor mbështet faktin se individët të cilët flasin gjuhë të ndryshme e perceptojmë botën e jashtme në mënyra të ndryshme.

¹⁷⁶ Chaika, E. (1989). *Language the Social Mirror*. New York: Newbury House Publishers. f.2.

Rami Memushaj është gjuhëtar shqiptar që ka shkruar në lidhje me rëndësinë e hipotezës së relativizimit gjuhësor. Sipas tij, versioni i fortë i hipotezës së relativizimit gjuhësor, sipas së cilës shumë nga dallimet gramatikore dhe leksikore janë të tilla që ato që mund të thuhet në një gjuhë, nuk mund të thuhet në një gjuhë tjetër, bart një varg rrjedhimesh negative gjuhesore. Edhe pse gjuhët kanë shumë dallime midis tyre, ato kanë edhe shumë karakteristika të përbashkëta.

Se dyti, tiparet e përbashkëta të gjuhëve vijnë në rradhë të parë nga të ashtëquajturat universale gjuhesore, që mund të konsiderohet si pjesa e trashëguar e gjuhës. Së dyti, edhe procesi i huazimit, si p.sh. i huazimit të fjalëve, shprehjeve e ndërtimeve sintaksore që gjenden në gjuhë e të cilat kanë arritur të depërtojnë nga një gjuhë në një tjetër. Po t'i përmbahesh teorisë së relativizimit gjuhësor, mohohet mundësia e përkthimit nga një gjuhë në tjetrën, ashtu si mohohen edhe huazimet kulturore midis popujve me gjuhë të ndryshme, kur dihet që kulturat, ashtu si popujt, japin e marrin midis tyre.

Anglishtja e shqipja bartin edhe ndryshime e dallojnë ndërmjet tyre. Këto ndryshime lidhen me faktorët jashtëgjuhësorë, për shkak të faktit të njohur që anglishtja është gjuhë me shumë influencë në botë, influencë që ndikon edhe në pikëpamjet e një anglishtfolësi mbi botën, ndërsa shqipja është gjuhë e një populli të vogël e ndryshme që në origjinë me anglishten. Kështu, faktin se këto dy gjuhë përfaqësojnë dy realitete të ndryshme e veme re edhe në përkthimet nga anglishtja në shqipe e anasjelltas.

Problemet përkthimore vijnë si rrjedhojë e dallimeve gramatikore, sintaksore, e leksikore. Prandaj, në besojmë se hipoteza e relativizimit gjuhësor është universale dhe duhet përdorur në studimet krahasuese ndërmjet gjuhëve. Pikerisht për këtë arsye, në jemi mbështetur në këto hipoteze edhe pse bazohemi e jemi dakord vetëm me variantin e saj të dobët, jo me variantin e fortë, pasi ajo mbart një sërë rrjedhimesh negative të cilat u studiuat në kapitullin e parë. Në jemi të mendimit se pavarësisht faktit se ndërmjet gjuhëve mungojnë strukturat e njëjta morfo-sintaksore e leksiko-semantike, gjuhët sërish kanë ngjashmëri midis tyre.

Duke qenë se proceset fjalëformuese lidhen ngushtësisht me hipotezën e relativizimit gjuhësor, në punimin tonë dallimet dhe afritë në grupet paradigmatiche të formimeve parashtesore, janë trajtuar përmes analizimit të universaleve gjuhesore, si një veçori e përbashkët e gjuhëve e për pasojë edhe e gjuhës shqipe dhe asaj angleze.

Se treti, nëse nisemi nga origjina e të dy gjuhëve, duhet të theksojmë se edhe pse bëjnë pjesë në të njëjtën familje europiane, shqipja e anglishtja bëjnë pjesë në dy grupime të ndryshme. Ndërkohë që gjuha shqipe i përket grupit satem, (ku bëjnë pjesë indo-iranishtja, armenishtja shqipja edhe balto-sllavishtja), gjuha angleze bën pjesë në grupin kentum (ku bën pjesë anatolianishtja, helenishtja, italishtja, keltishtja gjermanishtja). Nga ana tjetër, shqipja gjenetiksht rrjedh nga ilirishtja, ndërsa gjuha angleze nga grupimi gjuhësor gjermanik, i cili ka edhe nënndarje të tjera.

Se katërti, gjuha angleze ndryshe nga shqipja karakterizohet si gjuhë analitiko-sintetike, dhe shqipja si gjuhë sintetiko-analitike. Gjuha angleze duke kaluar në tri etapa kryesore zhvillimi (periudha e anglishtes së vjetër, anglishtes së mesme dhe anglishtes moderne) ka pësuar ndryshime rrënjësore në strukturën e saj. Patjetër që të dyja gjuhët kanë veçantitë e tyre, të cilat

mund të vihen re në vëllimin e pabarabartë të pasurisë leksikore, të pasurisë semantike dhe të asaj frazeologjike. Formimi i vazhdueshëm i fjalëve të reja, i jep anglishtes statusin e gjuhës më të fuqishme sot. Gjuha shqipe është pasuruar vazhdimisht dhe në përballjen sidomos me leksikun e gjuhëve me të cilat ajo ka rritur ndjeshëm kontaktet. Gjuha angleze duke qenë një gjuhë me karakter te përzier, e cila përmban fjalë të burimit të hershëm indoeuropian, fjalë të anglishtes së vjetër, fjalë të gjuhës skandinave, fjalë të burimit gjerman, fjalë të burimit kelt, fjalë latine, frenge, italiane, hollandeze, ruse, greke, spanjolle, amerikano-indiane, sankritishte, hindishte, dravidiane, perse, arabe, afrikane kineze, australiane e fjalë të gjuhëve nga ishujt e paqësorit.

Bërthamën e leksikut të shqipes e përbën shtresa e lashtë indoeuropiane, por gjithashtu leksiku i shqipes përmban fjalë të burimit grek, të burimit latin e roman, fjalë të huazuara nga italishtja e anglishtja moderne, nga frëngjishtja, fjalë të burimit sllav, fjalë të burimit turk, shumë greqizma në toskërishte a në çamërishte. Gjuha shqipe në leksikun e saj nuk ka fjalë nga sankritishtja, dravidianishtja, hindishtja, amerikano-indiane apo nga ishujt e paqësorit. Huazimet kanë depërtuar në shqipe përmes pushtimeve dhe faktorit gjeografik, pra afrisë me vendet nga ku ka marrë, ndërsa gjuha angleze rezulton gjuhë më e hapur se shqipja në këtë aspekt.

Se pesti, pasurimi i leksikut si për gjuhen angleze ashtu dhe për atë shqipe bëhet përmes: a) pasurimit të strukturës kuptimore të fjalës me kuptime të reja; b) me anë të mënyrave të fjalëformimit.; c) me ane të procesit të huazimit. Formimi i fjalëve të reja me anë të mënyrave të fjalëformimit është mënyra më prodhimtare për pasurimin e leksikut me njësi leksikore. Mënyrat më të njohura të fjalëformimit për të dyja gjuhët janë prejardhja me ndajshitesa, kompozimi dhe përngjitja. Për me teper, përmendim shkrirjet e shkurtesat si edhe prejardhjen prapavajtëse¹⁷⁷. Në gjuhën shqipe kemi formimin e fjalëve të formuara me paranyjëzim, të cilën nuk e gjejmë në anglishte. Parashitesimi është më pak i favorizuar nga sistemi morfologjik i anglishtes sesa prapashtesimi. Kjo gjë u vu re edhe në gjuhen shqipe.

Në lidhje me procesin e huazimit, tek shqipja vihet re se në shumë raste ajo ruan elementin formativ të saj i cili mbetet sinonim me ndajshitesën e huazuar. Në gjuhën angleze nuk e vëmë re këto gjë pasi fjala huazohet në tërësi dhe përdoret e tillë duke zëvendësuar një fjalë të mëparëshme.

Parashtesat i gjejmë të burimit autokton dhe joautokton në të dyja gjuhët. Numri i parashtesave autoktone angleze është shumë më i vogël se sa mund të mendohet. Sipas Marchand ka vetëm gjashtë parashtesa angleze autoktone që janë: **a-, be-, fore-, mid-, mis-, and un-**. Ka edhe parashtesa si **mal-** që vjen nga frëngjishtja e latinishtja, **Contra-** nga latinishtja, **counter-** që është anglo-franceze, **anti-, dis-**, që vijnë nga gjuha frenge e vjetër, e **il-, in, im-, ir-** që janë latine. Gjuha shqipe ka huazuar parashtesa të huaja, si: **a-, anti-, de-, dez-, trans-, ultra-, dis-, pro-, pan-,** etj. Parashtesat zakonisht huazohen bashkë me fjalët e huazuara. Huazimet me parashtesat **de-, dis-, des-** e **diz-** janë huazuar bashkë me fjalën.

Një karakteristikë e përbashkët e ndajshitesave angleze e shqipe është se një pjesë e tyre janë polisemantike. Edhe pse janë të ngjashme semantikisht, ato nuk e zëvendësojnë njëra-tjetrën. Një tipar dallues për parashtesat e shqipes është zëvendësimi ndonjëherë me njëra-tjetrën kur ekziston një parashtesë e huazuar dhe një vendase me të njëjtin kuptim. Në gjuhën angleze nuk e

¹⁷⁷ Memushaj, R. Hyrje në gjuhësi, Tiranë, 2006, f. 281

gjejmë këtë fenomen. Karakteristikë për anglishten është zëvendësimi i fjalëve vendase me ato të huazuara, ndërsa në shqipe ndodh e kundërta.

E parë nga ana morfologjike, në gjuhën angleze, vendosja e një ndajstese ka shumë lidhje me origjinën apo etimologjinë e saj. Në gjuhën shqipe mbetet prirja për t'ju parashtesuar sa më shpesh rrënjëve vendase edhe pse ka raste kur ato u parashtesohen fjalëve bashkë me të cilat hyjnë në gjuhë.

Në lidhje me theksimin e parashtesave angleze, duhet të theksojmë faktin se zakonisht theksi kryesor bie mbi rrënjën e fjalës e jo mbi parashtesën. Në gjuhën shqipe kemi raste të theksimit të parashteseva, p.sh. formimet me parashtesa të shqipes me parashtesën **jo-**, joalkoolik, jodemokratik, jodialektik, johistorik. Gjithashtu, kur janë fjalë të huazuara bashkë me parashtesën, parashtesa del e patheksuar si në anglishte ashtu edhe në shqipe, si rasti antibiotic-antibiotik.

Një tjetër karakteristikë e parashtesave angleze është fakti se zakonisht shumica e tyre nuk e ndryshojnë kategorine gramatikore të fjalëve të cilave u parashtohen. Ka të tilla të cilat e ndryshojnë atë, edhe pse shumë pak në numër nëse i krahasojmë me pjesën më të madhe të tyre, si në tabelën më poshtë. Kjo karakteristikë nuk zë vend për gjuhën shqipe, ku parashtesat ndryshojnë vetëm kuptimin e fjalës ku parashtesohen. Te pakte janë shembujt që bëjnë përjashtim nga rregulla.

Parashtesa	+	Mbiemer	=	Folje
Be-	+	Little	=	Belittle (zvogëloj)
En-	+	Large	=	Enlarge (zmadhoj)
Em-	+	Power	=	Empower (fuqizoj)
En-	+	Danger	=	Endanger (rrezikoj)

Parashtesa	+	Emër	=	Ndajfolje
A-	+	Bed	=	Abed (në shtrat)

A-	+	Sleep	=	Asleep (i përgjumur)
Be-	+	Friend	=	Befriend (zë mik)
A-	+	Field	=	Afield (në fushë)
A-	+	Blaze	=	Ablaz (i përflakur, i ndezur)
A-	+	Singing	=	Asinging

Nyjëtimi i mbiemrave mbetet një tipar dallues i gjuhës shqipe, gjë që nuk e vume re në gjuhën angleze. Në gjuhën angleze parashtesa **in-** ka 4 alomorfet e saj (Il, ir, Im, in), të kushtëzuara fonetikisht në bazë të bashkëtingëllores nistore të fjalës ku parashtohen, gje te cilen nuk e gjejme në shqipe.

Në formimet ndajshesore me parashtesa në të dyja gjuhët vihen re dukuri të shumta semantike, morfologjike, e stilistikore. Gjuha angleze dhe ajo shqipe siç kanë të përbashkëta në formimet me parashtesa, kanë edhe dallime. Kjo u vu re në analizën e imtësishme të formimeve me parashtesa që bëjnë në kapitullin e shtatë. Vumë re që ashtu siç ekziston në shumë raste një përqsaje e plotë semantike dhe morfologjike nga anglishtja në shqipe midis formimeve me parashtesa, kjo përqsaje mungon në plot raste të tjera. Sjellim disa nga shembujt e shumtë ku përqsaja morfo-semantike është e njejtë p.sh: discourage-shkurajoj.

Në të dyja gjuhët, ate shqipe e angleze, parashtesimi mundësohet përmes dy proceseve fjalëformuese siç janë kompozimi e përngjitja. Por, në gjuhën shqipe duhet pranuar fakti se parashtesimi e kompozimi shpesh ngaterrohen, pasi një pjesë e parafjalëve madje edhe disa pjesëza janë shndërruar në parashtesa. Një pjesë parashtesash e prapashtesash kanë qenë historikisht ndajshesata. Pjesa e mbetur janë ndërkombëtare të ardhura prej huazimeve sintagmatike të gjuhëve të tjera.

Nga analiza e veprës klasike të Xhon Gollsuorth, përkthyer nga përkthyesi V.Kokona, vlen të nënvizojmë përdorimin pak a shumë e të gjitha metodave të përkthimit, në mënyrë për t'i qëndruar besnik mesazhit, kuptimit dhe ngjyimit stilistik. Vihet re përdorimi i shpeshtë i metodës së përkthimit të quajtur *modulim*, duke ndryshuar këndvështrimin e së njëjtës dukuri jashtëgjuhësore realizuar në rrafshin e përmbajtjes. Në këtë rast vetkuptohet që nuk kemi të bëjmë me përqsaje morfo-semantike. Këtu përkthyesi mund të ketë hasur probleme të karakterit të mospërkthimit të ekuivalentit një për një, por të përkthimit të kuptimit në fjali të tilla ku spikat përkthimi me fjalë të tjera, me ndryshim të pjesës së ligjëratës, me ndryshim të këndvështrimit të së njëjtës dukuri gjuhësore etj.

Nëse i referohemi problemeve të përkthimit të fjalëve me parashtesa nga anglishtja në shqipe dhe anasjelltas, erdhem ne konkluzionin se nuk mund të ketë ekuivalence absolute midis

tyre. Për pasojë edhe përkthimet e formimeve me parashtesa në vepren e zgjedhur si korpus gjuhësor “Saga e Forsajteve” nuk janë absolutisht apo plotësisht të sakta, edhe pse vepra e përkthyer nga V. Kokona në shqip është shume e vlerësuar. Pavarësisht kesaj, në erdhem në përfundimin se përdorimi i më shumë se një ekuivalenteje të fjalës së parashtesuar angleze, tregon për pasuri të leksikut të shqipes.

Përmes vjeljes shteruese nga fjalori anglisht-shqip, kemi bërë të mundur përpilimin e një fjalorthi specifik të fjalëve të ndajshitesuara me parashtesa, të renditura alfabetikisht. Në pjesën dërrmuese është gjetur një barazvlerës i plotë me ngjashmëri morfo-semantike, çka do të thotë që për secilën fjalë të parashtesuar në gjuhën angleze, barazvlerësja në shqipe ka përqasje morfologjike dhe semantike të njejtë, si p.sh. unsuitable-i papershtatshem. Në raste tjera rezultojnë barazvlerëse vetëm semantikisht.

Së fundi, vijmë në përgjigjen e pyetjes së shtruar në fillim të punimit tonë: Si i përgjigjet gjuha shqipe shumësisë së prefikseve angleze? A mundet dot shqipja edhe nën ndikimin e trysninë e tezës së relativizmit lingvistik të përgjigjet me një barazvlerëse në shqipe çdo prefiksi apo njësi të ndajshitesuar me parashtesë të anglishtes?

Pas një kërkimi të thelluar, përmes vjeljesh në fjalorë dy gjuhësh, si edhe përmes një studimi korpusesh gjuhësor, në arritëm në përfundimin se gjuha shqipe ka mundësi të mëdha morfologjike e semantike si dhe potencialin e plotë leksikor për tu përballur me çdo njësi të re apo formim të ri të ndajshitesuar parashtesor.

Së pari përmes ndajshitesës, prefiksit korrelativ apo parashtesës barazvlerëse, p.sh.:inter-ndër; anti-kundër etj.

Së dyti, përmes ndajshitesave polisemike (polifunksionale) çka nënkupton se për dy a më shumë ndajshitesa të anglishtes kemi vetëm një ndajshitesë të shqipes, p.sh.: **sh-**, **zh-**. **ç -**.

Së treti, përmes ndajshitesave të huaja që shqipja i huazon bashkë me fjalën; a) nga anglishtja së bashku me fjalën b) shqipja huazon nga gjuhët e tjera neolatine, prej të cilave ka marrë dhe vetë anglishtja.

Në besojmë fort se ky studim do të paraqesë shumë interes në procesin mesimdhënës e mësimnxënës për mësuesit e pedagogët të cilët janë të përfshirë në kurse të tilla si analiza e tekstit, studim intensiv i tekstit, apo leksikologji e semantikë, por në të njëjtën kohë edhe për procesin e përkthimit nga anglishtja në shqipë dhe anasjelltas.

BIBLIOGRAFIA

- Xhuvani, A Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve II Tiranë 1972, f 115.
- Xhuvani A. - Çabej, E. Parashtesat e gjuhës Shqipe, Buletin i Shkencave shoqërore a/1956, f. 63-103.
- Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës Shqipe, Tiranë, 2006, f. 270-272

- Thomai, J. Prejardhja semantike në gjuhën Shqipe 1989 f 120-130
- Thomai, J. Prejardhja semantike në gjuhën Shqipe 1989 f306-316.
- Xhuvani, A. Çabej, E. Parashtesat në gjuhën Shqipe, në E. Çabej, Vepra, III, Prishtinë, 1976
- Stefanllari, I. Fjalor Anglishte - Shqipe, Tiranë, 1988, I. Duro, Fjalor Shqip - Anglisht, Tiranë, 1986.
- Hysa, E. Formimi i emravenëgjuhënShqipe, Tiranë2004, f. 82-86, E. Hysa, Parashtesat me kuptimmohuesnëgjuhënShqipe, SF, 4, 1977, f. 120-124. Shih edhe Gramatika e gjuhës Shqipe, Tiranë, 1, 1995, f. 145
- Hysa, E."Disa Çështje të parashtesimit në gjuhën Shqipe në: Çështje të gramatikës së Shqipes së sotme II, Tiranë 1975.
- Hysa, E. Parashtesat me kuptimmohuesnëgjuhënShqipe ;StudimeFilologjike nr4 1977.
- Gramatika e Gjuhës Shqipe Tiranë 2002
- Gollsuorth Xh.. "Saga e Forsajteve", vepër letrare.
- Euralex International Congress. Torino, Italia, September 6th-9th, 2006. Alessandria: Edizionidell'Orso. 1115-1127.
- Ercikan, K. (1998) Translation Effects in International Assessments. International Journal of Educational Research, 29, 543-553.
- Ervin, S. and Bower, R. T. (1952) Translation Problems in International Surveys. Public Opinion Quarterly, 16, 595-604.
- Harvey, M. (2003). A beginner's course in legal translation: the case of culture-bound terms.Retrieved April 3, 2007 from <http://www.tradulex.org/Actes2000/harvey.pdf>.
- Hervey, S., & Higgins, I. (1992). Thinking Translation. London &Neë York: Routledge. f.29
- Rudolph, F. "English as a word donor to other languages of Europe".
- Lucy, J.A. (1997) Linguistic relativity. Annual Revieë of Anthropology 26, f. 291–312.
- Chomsky, N., Knowledge of Language, Praeger, 1986.f24-25
- Demiraj, Sh. Gjuha Shqipe dhe historia e saj, Tiranë, 1989
- De Sosyr, F. Kursi i gjuhësisësëpërgjithshme, Tiranë, 2002, f. 74
- Hudson, R., Socioinguistka, Tiranë 2002.
- Kostallari, A. Studimembileksikundheformimin e fjalëve II Tiranë 1972,
- Kostallari, A. 1984. 'Gjuha letrare kombëtare Shqipe dhe epoka jonë ' in Studime Filologjike 1984. No 4: 25—55
- Kostallari, A. Parimet Themelore për hartimin e Fjalorit të gjuhës sotme Shqipe në Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën Shqipe II Tiranë 1972
- Kostallari, A. 1968. 'Parimetthemelorepërhartimin e FJALORIT TE GJUHES SE SOTME SHQIPE' ne StudimeFilologjike 1968. No 2: 43—128
- Dhrimo, A. Formimi i Mbiemravenëgjuhën e sotmeShqipe.
- Dhrimo A..dhe në Çështje të gramatikës së Shqipes së sotme, II Tiranë.
- Baurer L Approaches to Conversion / Zero-Derivation edited by Laurie Bauer, Salvador Valera Hernández Waxman Verlag GMBH 2005, Postfach 8603, 4804,6 Munster Germany f 588.
- Bauer, Laurie. 1983. English word-formation. Cambridge: University Press.
- Baker, M. (1992). In Other Words: A course book on Translation. London: Routledge

- Bauer L. Salvador Valera Hernández Waxman Verlag “Approaches to Conversion / Zero-Derivation” GMBH 2005, Postfach 8603, 4804,6 Munster Germany.
- Bell, R.T. (1991: 13) Translation and Translating: Theory and Practice, London/Neë York: Longman f 3.
- Bell, R. T. 1994. Translation and Translating. Longman Group UK Ltd.
- Fromkin, V. Rodman, R. An Introduction to Language 6-th sdition. 1998 USA.. Lexical Change f 459- 463.
- Ginzburg R. S. Khidekel,S. S. Knyazeva, G. Y. Sankin A. A. A COURSE IN MODERN ENGLISH LEXICOLOGY Moskë,1979.
- Kussmaul, P. 1995. Training the Translator. John Benjamins Publishing Co. 177 p
- Kussmaul, P. (1995): Training the Translator, Amsterdam / Philadelphia, John Benjamins Publishing Company
- Hacken, P. ten; Abel, A.; Knapp J. (2006). “Word formation in an electronic learners’ dictionary: ELDIT.” International Journal of Lexicography 19 (3). 243-256.
- Hacken, P. ten; Abel, A.; Knapp J. (2006). “Word formation in an electronic learners’ dictionary: ELDIT.” International Journal of Lexicography 19 (3). 243-256.
- Haldeman, S. S. 1865. Affixes in their origin and application, exhibiting the etymologic structure of English words. Philadelphia: E. H. Butler.f46dstmte. net/ lgcs101 /readings/hock & joseph borrowing.pdf
- Brinton Laurel J. The structure of modern English A linguistic Introduction. John Benjamins Publishing Company Amsterdam/Philadelphia.
- Drout, Michael D.C. A history of the English language. A course guide Recorded books LLC.2006.
- Dubois, J. Etudes sur la dérivation suffixale en français moderne et contemporain (Introduction), 1962.
- Hysa, E. Formimi i emravenëgjuhënShqipe, Tiranë2004, f. 87; Gramatika e gjuhësShqipe, 1, Tiranë, 1995, f. 145.
- Hysa, E. Disa çështje të Parashtesimit në gjuhën Shqipe f67
- Hysa, E. Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën Shqipe, 2005,f 56
- Jackson, H. (2000). “Lexicography.” In Booij, G.; Lehmann, C.; Mugdan J. (eds.).
- Jackson, H. and E. Amvela 2007. Words, Meaning and Vocabulary. An Introduction to modern English lexicology. London: Continuum.81
- Jackson, H. (2000). ‘Lexicography.’ In Booij, G.; Lehmann, C.; Mugdan J. (eds.).
- Jakobson, R. 2004 ON LINGUISTIC ASPECTS OF TRANSLATION The translation Studies reader Routledge Tailor and Francis Group. London And Neë York f113-118.
- Joos, M. (1962). The Five Clocks. International Journal of American Linguistics, vol28, no 2,
- Katamba, F. 2005. English Words. Structure, history, usage. London: Routledge. f135
- Katamba, F. 2005. English Words. Structure, history, usage. London: Routledge. F 15-44
- Kastovsky D. Conversion and/or zero: word-formation theory, historical linguistics, and typology f 31-49 In: Bauer, Laurie, Valera, Salvador (eds.) Approaches to Conversion/Zero-Derivation. Waxmann Münster, New York, München, Berlin: Waxmann, 31-49.
- Kwon Heok-Seung Negative prefixation from 1300 to 1800: A case study in in-/un-variation* 1997. ICAME Journal no = 21 f 21.

- Kratz, D (1986) "An Interview with Norman Shapiro", Translation Review 19: f27-28.
- Lefe, E. Shqipja standard në vështrim strukturor dhe funksional, Konferenca shkencore "Shqipja standard dhe shoqëria Shqiptare sot", Tiranë, 2003, f. 249 Leech, G.N. 1981. Semantics. Harlow: Penguin.
- Larson, M.L. (1984) Meaning-Based Translation: A Guide to Cross-Language Equivalence. Lanham and New York: University Press of America, Inc. f. 95-6
- Lataiwish, M. & A, Yowelly. (1999). Principles of Translation. Benghazi: Dar Al-Nahda Al- Arabiya.
- Leppihalme, R. Culture bumps: an empirical approach to the translation of allusions. Clevedon: Multilingual Matters 1997. f 79.
- Lenski D. The Status of Etymology in the Synchronic Morphology of English December 7, 2000 [http:// myxo. css. msu. edu/ dlenski/ academic/ pdf](http://myxo.css.msu.edu/dlenski/academic/pdf). (.01/02/ 2013)Lenski D Po aty f 6
- Leonardi, V. (2000). Equivalence in Translation between Myth and Reality. London: Copyright Translation Journal and Auther. [http:// www. accurapid. com/journal/ 14 equiv .htm](http://www.accurapid.com/journal/14equiv.htm)
- Lloshi, Xh, Stilistika e Gjuhës Shqipë dhe Pragmatika, Kreu II "Njësitë dhe Nocionet Fillestare", 2005, Albas, Tiranë
- Lloshi, Xh. Thomai. J. 1969. Leksikologjia e Leksikografia Shqipe paraçlirimit Studia Albanica 1969. No 2: 105—127;
- Lloshi, Xh. 1965. 'Kumtesë mbi parimet e hartimit të Fjalorit të Shqipes bashkëkohore Studia Albanica 1965. No 1: 177—178.
- Lloshi, Xh. 1984. 'Shqipja moderne në kontekste të ndryshme kulturore Studia Albanica 1984. No 2: 165—176.
- Lloshi, Xh. 1975. 'Muzeu i gjallë i gjuhës - fjalori' in Shkence dhe jeta 1975. No 3: 2,26.
- Plag, I. Word Formation in English 2006 Cambridge University press.
- Memushaj, R. Hyrjenë Gjuhësi. Tiranë 2008 f 173-176.
- Memushaj R. Hyrje në Gjuhësi Botimet Toena Tiranë 2008 f 317-318
- Newmark, P. 1995. A Textbook of Translation. Prentice Hall, London.
- Newmark P. 1988. Textbook of Translation. Oxford: Pergamon Press f215 .
- Newmark, P. (1988b). Approaches to Translation. Hertfordshire: Prentice Hall.
- Newmark P. Approaches to Translation, Oxford: Pergamon Press. f 65-67.
- Nida, E. y Taber Ch. 1974. The Theory and Practice of Translating. Brill, Leiden.
- Nida, E.J. & C.R, Taber. (1969). The Theory and Practice of Translation. Leiden: E.J.Brill.
- Nida (1964). Toward a Science of Translating: ith Special Reference to Principles and Procedures Involved in Bible Translating. Leiden: E. J. Brill.
- Stefanllari, I. a Course in English lexicology, Tiranë 2011.
- Sharra Th. Word Formation Supplement to English grammar 1971.
- Memushaj R. Hyrje në Gjuhësi Botimet Toena Tiranë 2008 f 317-318
- Sapir, E. (1921). *Language*. New York: Harcourt, Brace, & World. f.34
- De Sossur, F Kursi i gjuhësisë së përgjithshme, Tiranë, 2002, f 74.
- Edward Sapir, *The Status of Linguistics as a Science*. University of California Press, 1985. f. 209-210.
- January, D., & Kako, E. (2006). Re-evaluating evidence for linguistic relativity. f.104.

- Pinker, S. (2007). *The Language Instinct: How the Mind Creates Language*. New York; f 80.
- Deutscher, G. (2010). *Does Language Shape how you Think?* The New York Times, August 26, 2010
- Tricás, M. 1995. *Manual de traducción francés-castellano*. Gedisa S.A
- Tupe, E. *Këshilla një përkthyesi të ri* 2000 f 8-9 e 14
- Tupe, E. *200 Këshilla një përkthyesi të ri* fq 56
- Tupe, E. (2003) *PRO TRANSLATORE*, Shtjellime Kritike për Përkthyesin dhe Përkthimin Tiranë: OMBRA OVG f. 61, 62
- Tupe, E. *Këshilla një përkthyesi të ri* f. 60
- Wynkyn de Worde *The Beginning of English Lexicography* <http://www.schulz-falster.com/books/book42.pdf>

Fjalorë

- Stefanllari, I. *Fjalor frazeologjik Anglisht – Shqip*, Tiranë, 1999
- Qesku, P. *Fjalor Anglisht - Shqip*, Tiranë, 2002
- Qesku, P. *Fjalor Shqip - Anglisht*, Tiranë, 2002,
- Qesku, P. *Fjalor Anglisht - Shqip*, Tiranë, 2002,
- Qesku, P. *Fjalor Shqip - Anglisht*, Tiranë, 2002,
- Stefanllari, I. *Fjalor Anglisht – Shqip*, Tiranë, 1986
- Qesku, P. *FjalorShqip – Anglisht*, Tiranë, 2002
- *The New Oxford Dictionary of English*, Oxford, 1999
- Qesku, P. *FjalorAnglisht – Shqip*, Tiranë, 2002
- Oxford Advanced Learners Dictionary file: `///C:/ Program % 20 Files /Oxford/ OALD7 / data/Oxford_3000/The_Oxford_3000.htm`
- Webster's new dictionary of synonyms G & C. MERRIAM COMPANY, *Publishers* Springfield, MASSACHUSETTS, USA1968
- *Fjalor anglisht-shqip Ilo Stefanllari Shtëpia botuese enciklopedike*, Tiranë 1996
- Duro, I. Hysa, R. *Fjalorshqip – anglisht*, Tiranë, 1988, f. 3
- *Fjalor i Gjuhës së sotme Shqipe*, 1980, *Fjalor i Shqipësisë së sotme* Toena Tiranë 2007
- *Fjalori i gjuhës Shqipe*, Tiranë, 2006
- *Fjalori Gjuhës së sotme Shqipe* Tiranë 1980. Akademia E Shkencave E RPS Të Shqipërisë Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- *A Dictionary of Prefixes, Suffixes, and Combining Forms from Webster's Third New International Dictionary*, Unabridged 2002.
- *Oxford Advanced Learner's Dictionary*, 2009
- Newmark, L. *FjalorShqip - Anglisht*, Oxford, 2000 etj.,.
- Newmark, L. *FjalorShqip-Anglisht* Oxford University Press 1999
- *Oxford Advanced Learner's Dictionary* 2009
- *Oxford Thesaurus of English*, Oxford, 2004 2006.
- *Oxford Advanced Learner's Dictionary*, 2009.

Burime interneti

<http://www.macmillandictionary.com/thesaurus-category/british/prefixes>

<http://www.oxforddictionaries.com/definition/english/prefix>

<http://www.macmillandictionary.com/>

http://www.etymonline.com/index.php?allowed_in_frame=0&search=searchmode

<http://www.learnenglishlanguage.com/esl/grammar/negative-prefixes.html>

<http://www.linglish.net/2008/09/15/so-many-negative-prefixes/>

<http://listverse.com/2011/07/13/10-hard-to-translate-english-words>.

<http://www.tradulex.org/Actes2000/harvey.pdf>

Fusha e studimit : Gjuhësi

Abstrakt

Ky punim ka për synim të vendosë përballë njëra-tjetrës gjuhën angleze e atë shqipe me qëllim gjetjen e ndikimit të relativizmit gjuhësor në proceset fjalëformuese e sidomos në atë ndajshesor parashtesor. Gjithashtu, kystudim synon trajtimin e problemeve të përkthimit që vijnë si rezultat i dallimeve në përgjithësi e në veçanti probleme të përkthimit të fjalëve të prejardhura me parashtesa. Nëse i referohemi hipotezës së relativizmit gjuhësor në formimet parashtesore në të dyja gjuhët respektive, i cili është edhe objekt i punimit tonë, dallimet gramatikore dhe leksikore janë të tilla që ato që mund të thuhet në gjuhën angleze, nuk mund të përcillen në gjuhën shqipe, ose gjithnjë në përkthimin nga anglishtja në shqipe diçka mbetet pa u përkthyer. Kjo lidhet me variantin e fortë të teorisë së relativizmit gjuhësor, i cili sjell një sërë rrjedhimesh negative jo vetëm në aspektin teorik të problemit, por edhe në atë praktik. Kjo teori na dha shtysë për t'iu drejtuar sistemit të fjalëformimit në të dy gjuhët, veçanërisht tipit të ndajshesimit, parashtesimit. Në punim u jepet përparësi formimeve me parashtesa të të gjitha klasifikimeve në gjuhën angleze dhe shqipe, duke bërë përjasje në të dyja gjuhët, për të gjetur përbashkësitë dhe dallimet në këtë fushë. Fokusi i studimit tonë është të trajtojmë çështjen se si dhe sa mirë shqipja i përgjigjet shumësisë së prefikseve angleze, nën trysinë e parimeve të relativitetit gjuhësor, duke e studiuar atë krahasimisht.

Fjalëkyçe: *relativizmi gjuhësor, fjalëformimi, formime parashtesore, probleme përkthimore, variant i fortë.*

Field of study : Linguistics

Abstract

The object of this study is to make an analytical comparison between the English and Albanian language aiming to find the influence of linguistic relativity in the wordformation processes, especially in the prefixation process. This study also aims to treat some translation problems deriving from the differences both languages have, and more specifically the translation problems of derived words with prefixes. If we refer to the linguistic relativity in the derived words with prefixes in both languages, the grammatical and lexical differences between them lead to the general idea that not everything expressed in the English language can be thoroughly transmitted to the Albanian language, or always something from English to Albanian remains untranslated. This is strongly related to the strong version of linguistic relativity, which leads to a number of negative consequences, not only in the treatment of the theoretical aspect of the issues, but also, in its practical aspect. This theory made us focus on the comparative study of the wordformation systems in both languages, especially the study of prefixation pattern. The study aims to answer the question how does the Albanian language respond to the multiplicity of the English prefixes under the influence of the linguistic relativity.

Key words: *linguistic relativity, wordformation processes, translation problems, strong version.*

